Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
22

QENDRA
JUSUF GËRVALLA



Adem Demaçi **Jusuf Gërvalla** **Metush Krasniqi**

Adem Dema-*Demaçi:* ***"Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."***

Xhafer Durmishi: "*Është meritë e Sabri Novosellës që e organizoi Jusuf Gërvallën në Lëvizje, i cili i vuri aftësitë e tija fizike, mendore dhe intelektuale në shërbim të atdheut, në mënyrë të organizuar."*

Shefik Sadiku: "*Metush Krasniqi ishte përpjekur, me tërë qenien e tij, që energjitë atdhedashëse të të gjithë veprimtarëve, pa dallim ideje, t'i shkrijë në dobi të çështjes kombëtare, për Shqipërinë.*

Se puna e tij ishte në frymën e bashkimit kombëtar, e paraqes një fakt konkret: Metushi organizoi një pritje të ngrohtë në shtëpinë e vet, në Dajkoc të Dardanës, më 2, 3 dhe 4 shtator të vitit 1974, bashkë me Adem Demaçin, Mulla Ramë Govorin, Hyrije Hanën, Ahmet Haxhiun, Selman Ramadanin, Fehmi Bajramin, Sylë Krasniqin (pleqnar), Hazir Krasniqin (kushëri). Në këtë takim ishin edhe Ilmi Ramadani, student, si dhe Emin e Besnik Krasniqi, nxënës.

Nga këto biseda me ndjenja të larta atdhedashurie u arrit marrëveshja e pajtimit në ide e veprime dhe u vendos që të vazhdohet lufta nacionalçlirimtare e Kosovës e viseve tjera në ish-Jugosllavi vetëm me një "Platformë Politike Kombëtare", as në të majtë e as të djathtë, nga i cili takim, në vitin 1974, do të lind "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës" dhe, më vonë, LNÇKVSHJ-ja e viteve 1976/77." (Me rastin e shënimit të 35 vjetorit të Heroit, Metush Krasniqi, kjo kumtesa u lexua ne Tryezën e mbajtur më 15.10.2021 në Prishtinë. E organizuar nga Këshilli Organizativ "Pranvera Shqiptare '81"!)

AMANETI I JUSUF GËRVALLËS

Dallimi në mes të Pavërtetës dhe Gënjeshtrës
Gënjeshtra e vogël, gënjeshtra e pafajshme dhe gënjeshtra komplete
1. UNITETI I BRENDSHËM I FRONTIT TË KUQ
1-1 PROGRAMI I FRONTIT TË KUQ i Ibrahim Kelmendit
1-2 Programi i *Frontit të Kuq* nga libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit
1-3 Programi i *Frontit të Kuq* nga libri LEVIZJA, i Bedri Islamit
Përplasja me Strukturat komuniste
2.UNITETI I BRENDSHËM I KOMUNISTËVE
Sharti i parë i turqnisë
Sharti i parë i shkinisë
2-1. Uniteti i Organizatës Marksist-Leniniste me Partinë komuniste marksist-leniniste
Nuk u për-puthet ideologjia – E kujtoj atë takim
2-2. Një fantazmë sillet nëpër Evropë
2-3. Uniteti i OMLK me Frontin e Kuq
2-4 . KADRIU I PROPOZON ANËTARËSIM IBRAHIM KELMENDIT POR AI NUK PRANOI
2-5 Uniteti i Rexhep Qosjes e Ismail Kadares me Prof. Dr. Abdyl Kadollin
2-6 Uniteti i Prof. Dr. Abdyl Kadollit me Emrush Xhemailin
2-7 Uniteti i Prof. Dr. Abdyl Kadollit me Xhafer Shatrin
2-8 Regjimi socialist po luftohej me socializëm
2-9 Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste
2-10 Nuk janë të afërta as të pranueshme
2-11 DIKTATI I KEQ DHE HEGJEMONIA E MIRÊ
2-12 Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste
2-13 Kurrë nuk kanë qenë komunistë
2-14. Shkenca e Institutit të turqnisë i Prof. Dr. Abdyl Kadollit
3. Uniteti i Jusuf Gërvallës me Ibrahim Kelmendin
3-1 Skema e gënjeshtrave
3-2. Të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin i kam ndërprerë
3-3. Bashkëpunimi me Ibrahim Kelmendin ka shkuar përmes Kadri Zekës
3-4. Mercenari i mercenarit
3-5. Korrigjimi i vockël i gënjeshtrës së madhe të gënjeshtarit të madh
3-6. Jusuf Gërvalla e konsideron Ibrahim Kelmendin të painformuar
3-7 Njerëzit e gënjeshtrave Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi
4. Uniteti i Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën
4-1. Ndihma e njëanshme e Jusuf Gërvallës për Kadri Zekën
4-2. Treshja unike
4-3. DOMINIMI, MEGALOMANIA DHE NDJENJA E EPËRSISË BOSHE
4-4. Ankesa është arma e të mjerit
4-5. Kadri Zeka ka një propozim konkret
4-6. Ambasada turke nuk i jep vizë Jusuf Gërvallës
4-7. Sabri Novosella e autorizon Jusuf Gërvallën të zhvilloj bisedime me Kadri Zekën
4-8. KADRI ZEKA DHE SHOKËT E TIJ NUK DUAN BISEDIME PËR BASHKIM ME JUSUF GËRVALLËN
4-9. NUK I KANË SHTRUAR HOLLËSISHT E ME SHKRIM ATO QË DUAN TË DINË E QË KËRKOJNË
4-10. NJERI I PËRSHTATSHËM, BIE FJALA XHAFER DURMISHI APO BARDHI
4-11. Krijimi i teksteve, përparësia dhe obligimi i interpretimeve

4-12. Metush Krasniqi pranon të dominohet nga komunistët hegjemon
4-13. Metush Krasniqi nuk kundërshton të dominohet nga komunistët hegjemon
4-14. Hydajet Hyseni për Metush Krasniqin-Dajkocin dhe Dajën Sejdë
5. Loja e pahijshme Kadri Zekës dhe shokëve të tij me personin e Jusuf Gërvallës
5-1. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
5-2. ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR
5-3. Epërsia boshe si privilegj ekskluziv i kokave boshe
5-4. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË
5-5. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E KADRI ZEKËS DHE SHOKËVE TË TIJ
5-6. Këtë mendim e kanë plotësisht Xhafer Durmishi dhe Bardhoshi

6 Organizimi i festimit të 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart
6-1. THEMELI ËSHTË VËNË ME GËNJESHTRA
6-2. MOS U HABITNI NËSE NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E GËNJESHTRAVE
7. Dasma e Kadri Zekës me Saime Isufin
7-1. U bë një dasmë e thjeshtë
7-2. Dasma qe tepër modeste
7-3. Gënjeshtra se Jusufi dhe Bardhoshi ishin mysafirët më të nderuar
7-4. Gënjeshtra se Jusufi shkon në dasmën e Kadri Zekës si i paftuar
7-5. Kadriu ishte kujdesur të thërriste dy a tre veta nga secili metropol
7-6. Përfaqësuesit e të gjitha rrymave dhe organizatave të përçara
7-7. Harapi i Shkodrës dhe gënjeshtra për bashkimin në dasmën e Kadri Zekës
7-8. Avokati i Harapit të Shkodrës
8. Udhëtimi i Kadri Zekës nga St. Gallen në Dusseldorf
8-1. Besimi i krijuar në takimin e parë dhe pabesimi i përjetshëm
8-2. Albana Krasniqi i demanton gënjeshtrat se Kadri Zeka udhëton për në Gjermani i ftuar nga vëllezërit Gërvalla
8-3. Kadriu kishte planifikuar ta kalonte 17 janarin1982 në Dusseldorf, 640 km në veri nga vendbanimi i tij në St. Gallen të Zvicrës
8-4.Kadriu duhej që më 17 janar 1982 të ishte në shtëpinë e vetë 640 km në jug të Dusseldorfit.
8-5. Të gjithë do të përfshiheshin në Frontin e OMLK-së
8-6. Askush nuk do të përfshihej në Frontin e OMLK-së
8-7. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë
8-8. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq
8-9. Lojë e pamirë e Kadri Zekës me personin tim dhe organizatën time
8-10. Ti mund dhe besoj se je i painformuar
8-11. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë
8-12. Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar
8-13. Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste
8-14. Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"
8-15. Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta dhe jo njerëzit e gënjeshtrave si Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi
9.Gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla
9-1. Gënjeshtrat e Taip Zekës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

9-2. Gënjeshtrat e Hasan Malës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla
9-3. Gënjeshtra e Saime Isufit për bashkimin-Boll inat më erdhi që doli Jusufi
9-4. Gënjeshtrat e Hydajet Hysenit dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla
9-5. Gënjeshtrat e Berat Luzhës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla
9-6. Gënjeshtrat e Mehmet Hajrizit dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla
9-7. Tri gënjeshtra të Mehmet Hajrizit për natën e 17 janarit 1982
9-8. SIPAS DËSHMISË SË BASHKËVEPRIMTARIT TË TYRE

10. Udhëtimi i Kadri Zekës nga Dusseldorfi në Shtutgart
10-1. Retroaktivteti
10-2. Të udhëtosh 420 km në drejtim të shtëpisë tënde duhet të kesh një shkak të madh
10-3. Skema e gënjeshtrave të Ibrahim Kelmendit prej 12 janarit deri më 17 janar 1982
10-4. Lutja marksiste-leniniste për Allahun
Insha Allah Jusufi do të na thirr mysafir
11. Rëndësia e shtëpisë së Jusuf Gërvallës
12. DISA KURTHA LOGJIKE DHE SKEMA TË GABUARA
12-1. Vërtetimi i teoremave në Matematikë
12-2. Sa kushton një gënjeshtër në vepra historike
12-3. Qeliza e fundit e kancerit një mjekësi
12-4. Shkaku i vrasjes së Kadri Zekës sipas Apostol Dukës
12-5. Tri gënjeshtra historike për Kosovën
12-6. Kadri Zekës i binte barra e realizimit të projektit të Frontit
1. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Ibrahim Kelmendit
2. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Fazli Veliut
3. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Abdullah Prapashticës
4. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Sabri Novosellës
5. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Jusuf Gërvallës
12-7. Shkaku i vrasjes sipas Hasan Malës
12-8. Shkaku i vrasjes sipas Abdullah Prapashticës
12-9. Shkaku i vrasjes sipas Ibrahim Kelmendit në romanin *Atentatet* dhe librin *Lëvizja*
12-10. Lidhja e shkakut të vrasjes së Jusuf Gërvallës me organizata të jashtme
12-11. Paaftësia për punë të pavarur
12-12. *Ftesat* nga pozita superiore, të barabarta apo inferiore
12-13. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij vetëm si pjesë në periferi
12-14. Kurtha e zhurmës për bashkim
12-15. Pse u vra Jusuf Gërvalla?
12-16. Pse UDB-ja e ka rrethua shtëpinë së Jusuf Gërvallës
12-17. Parazitizmi patriotik
12-18. E zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja
12-19. Pasivja dhe aktivja
12-20. Lufta dhe paqja
12-21. E organizuara dhe spontania
12-22. Humbja-Hakmarrja-Fitorja
12-23. Jeta me mision kryer dhe jeta me mision të pakryer
Nisja e një rruge që mbeti në fillimet e saj
12-24. Kurtha logjike - Mendimi i shumicës

12-25. Kurtha logjike - roli i autoriteteve
12-26. Motivi i dashurisë
12-27. Motivi i higjienës gjenetike
12-28. SHPIRTI I VETËMOHIMIT I MEGALOMANËVE
12-29. Fjala e fundit është për idiotët që nuk kanë thënë mjaft
12-30. Kurtha e stilit – *ose je me mua ose je kundër meje*

13. Gjuha e vërtetë e varreve dhe gënjeshtrat e kufomave të gjalla
14. Tërmeti i Berlinit dhe Kështjella e Jusuf Gërvallës
(OMLK-ja e Pararojave-Pllakave dhe Plakave)

15. Çështje të brendshme të Ibrahim Kelmendit dhe Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK)

15-1.Portreti i babait
15-2.Portreti i birit
15-2-1. Ti nuk e ke asnjë anëtar
15-2-2. Besimi dhe mosbesimi për të pabesin
-Të pabesit gjer në fund i besoi qysh në takimin e parë
-Për të pabesin gjer në fund tregoi mosbesim të pafund
15-3.Portreti i Frontit
15-4.Portreti i shokut
15-5. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xh.D.)
15-6. Portreti i gruas
15-7. Portreti i vjehrrës
15-8. Portreti i vëllaut me krejt çka ka
15-9. I nderuari, i përshëndeturi dhe i respektuari Xhafer Durmishi-Skenderi
15-10.Trishtimi i avokatit
15-11.Trishtimi i UDB-ës për fatin e Frontit të Kuq

16. Uniteti i shpëtimtarëve
16-1. Që të plotësoi zbrazësinë e krijuar
16-2. Një kolos i pazëvendësueshëm
16-3. NUK ËSHTË ZHVILLUAR KURRFARË AKTIVITETI
16-4 PAS VRASJES SË TYRE KA NDODHUR AJO QË KA NDODHË PAS VRASJES SË ADEM JASHARIT
17. Miku ynë i përbashkët
18. Portreti i Gruas së Jusuf Gërvallës në romanin *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit
18-1. Jataku ekskluziv i spiunit shumë të rrezikshëm
18-2. Miran, vëllai ynë i dashur
18-3. Shokëve lavdi të përjetshme
18-4. Je në shtëpinë tënde
18-5. Kurse ty po të lutem si vëllait
18-6. Po i jepte forcë morale
18-7. Çka të them unë e shkreta?
18-8. Për Nuriun kam shfaqur dyshim në polici
18-9. Të paça vëlla
18-10. Ne duhet të gjejmë forcë
18-11. Është angazhuar kundër të gjithë neve
18-12. Kurse midis jush nuk kam si hyj
18-13. Miranin e kam në vend të vëllait

19. Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai

20. Portreti i nënës së Jusuf Gërvallës në romanin *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit

20-1. Fjalët prekëse të nënës
20-2. Nëna e neveritur
20-3. Mundimet e të goditurve
20-4. Qarja e halleve
20-5. Besimi e konfidenca
20-6. Duart e nënës
20-7. Kursimi i Miranit
20-8. Prapësitë e inskenuara
20-9. Droja, cfilitja, strukja, tërheqja
20-10. Nuk duhet të më mashtrosh
20-11. Kuvendimi me kopukë
20-12. Mirë qenke përgjigjur
20-13. Sytë me lot
20-14. Shko flij bir i nënës
20-15. Qarja me dënesë
20-16. Mbajtja e nënës për krahu
20-17. Kopukët e hileqarët

Kadri Rexhaj: "*Veprimtari dhe publicisti Xhafer Durmishi, deri më sot, për mendimin tim, është studiuesi më i përkushtuar dhe më objektiv i veprimtarisë atdhetare të Jusuf Gërvallës. Në projektin e tij madhor ai ka punuar me vite të tëra, ka bërë punë me durim, me kujdes, me objektivitet, me dashuri, me shpirt dhe me mendje, sa rezultatin e mirë që ai personalisht e ka arritur me më shumë se 20 veprat e tij kapitale, jam i sigurt, nuk do ta arrinte asnjë institucion shkencor. Nëse në veprat e shkruara të derisotme kushtuar Jusuf Gërvallës (ndër të cilat llogaris edhe librin tim) rrëfejnë autorët e tyre për Jusufin, në veprën e Xhafer Durmishit ndodhë e kundërta: në tryezën e improvizuar të ballafaqimeve për tema të caktuara, flet personalisht Jusuf Gërvalla, i cili me dëshmitë e tij autentike, të lëna me shkrim, qartë dhe kuptueshëm argumenton veprimtarinë e vet, tashmë të vulosur edhe me gjak."*
(Facebook, 17 janar 2023)

Xhemajl Shatri: "*Padyshim Xhafer Durmishi është arkiva më autentike për veprimtarinë kombëtare të Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës, i cili i ka shkrua mbi 20 libra për Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës.*

Për Xhafer Durmishin nuk do të them shumë se nuk jam avokat i tij, por një gjë dua të them, se sa e kam njohur nga afër kam krijue mendimin se është njeri shumë i ngritur kombëtarisht dhe intelektualisht. Xhafer Durmishi është njeri i besës dhe i shkencës, është specialist i librave, dhe është atdhetar i flakt i çështjes kombëtare." (Facebook, 13 shkurt 2023)

Sabri Maxhuni-Novosella*: "Asllan, Ju lutem e përshëndetni Xhaferin në emër timin dhe i thuani: Ju lumtë, librin e keni shkruar shumë mirë dhe keni bërë shumë mirë që ato të vërteta historike i keni qitë në dritë.*" (21 janar 2023)

AMANETI I JUSUF GËRVALLËS

"Suzana: ***A pe ndonjë njeri?***

Jusufi: ***Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse s'ka kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)



Suzana dhe Jusuf Gërvalla

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

Vetëm nëse një tekst historik e përshkruan të vërtetën, ajo e vërtetë mund të bëhet rivale e kohës, dëshmitare e së kaluarës, këshilltare e së tashmes dhe paralajmëruese e së ardhshmes.

Dallimi në mes të Pavërtetës dhe Gënjeshtrës

Kur dikush flet për gjëra e ngjarje për të cilat nuk ka njohuri, **pa qëllim** mund të thotë gjëra **të pavërteta**. Kur dikush e njeh një ngjarje, dhe **me qëllim** e ndryshon, shtrembëron ate me qëllim të përfitimit, ai thotë **GËNJESHTRA**.

Gënjeshtra e vogël, gënjeshtra e pafajshme dhe gënjeshtra komplete

Victor Hugo: *"Petit mensonge, mensonge innocent, est-ce que cela existe? Mentir, c'est l'absolu du mal. Peu mentir n'est pas possible; celui qui ment, ment tout le mensonge; mentir, c'est la face même du démon; Satan a deux noms, il s'appelle Satan et il s'appelle Mensonge."*

1. UNITETI I BRENDSHËM I FRONTIT TË KUQ

1-1. PROGRAMI I FRONTIT TË KUQ i Ibrahim Kelmendit

I. Kelmendi: *"Këto organizime i udhëhiqnin kryesisht njerëz që dikur i kishin shërbyer UDB-së, pasi ishin arratisur nga Republika e Shqipërisë në RSFJ-në,* ***gjithashtu komuniste****. Ata nuk i kishte penguar* ***terrori komunist*** *i serbomadhit* ***Aleksandër Rankoviç*** *mbi shqiptarët e pushtuar, meqë e kishin pasur atë si një lloj punëdhënësi."* (Epoka e Re, 7 janar 2007)

Adem Gashi: *"Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë* ***mistreci komunist****.."* (Dyndalla e mendimeve, Hotel Viktoria, 5 shkurt 2007)

Prend Buzhala: *"...parakalojnë revolucionarë, politikanë kafenesh,.. mashtrues e qelepirxhinj të ndryshëm, ...ambasadorë, diplomatë,* ***komunistë e pseudo-ideologji*** *të të gjitha tarafeve..."* (Hotel Viktoria, 5 shkurt 2007)

Salih Kabashi: *"...Miku im, më një nuhatje fantastike, më pat thënë e më vonë edhe e pat shkruar në shtypin slloven, se lider i ardhshëm i Kosovës se re* ***paskomuniste*** *do të ishte Ibrahim Kelmendi."* (Revista Republika nr.3, 2007)

Mustafë Xhemaili: "*Romani "SY" është një tronditje. Apo më mirë të thuhet një ritronditje. Sepse autori do të sjellë Shqipërinë* ***nën diktaturën komuniste*** *nga një këndvështrim i veçantë.*
...Ai aq larg shkon në ëndërrimin e lirisë nën regjimin ***e diktaturës komuniste*** *sa këmbëngulë vazhdimisht se duhej të gjendje një rrugëdalje, një shteg e të dilet në dritën e lirisë.*" (Vlerësime për romanin "SY" të Ardian Kyçykut, 2004)

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë* ***Komuniste*** *të Kosovës, që udhëhiqej nga* ***Mustafë Xhemaili*** *e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. Një tentim për kontakt kishte edhe me PKMLSHJ, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim*." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

Daut Demaku: "***Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..."***

1-2. Programi i *Frontit të Kuq* nga libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit

Të gjitha citatet nga libri *Atentatet* janë të Ibrahim Kelmendit.

"– Tani po e kuptoj egon tënde. Jusufi është detyruar të arratiset. Tani ai do të angazhohet, mendon ti, bashkë me ju, ***kundër pushtetit komunist*** *jugosllav?*
– Dhe kundër pushtimit të Kosovës! – plotësoi Mirani.
– Po, vetëkuptohet! – u përgjigj Renata, duke u ndjerë paksa e bezdisur, përse po i rrinte kaq gati Mirani, kur ajo harronte të saktësonte, se atij i interesonte po aq çlirimi i Kosovës sa edhe luftimi i ***diktaturës komuniste*** *jugosllave."* (Atentatet, f.11*)*

"Shumicën e nëpunësve shqiptarë në Kosovë e gjetiu në Jugosllavi i njoh si atdhetarë, sado që janë të indoktrinuar nga ideologjia ***komuniste*** *jugosllave, e njohur si "titizëm".* (Atentatet, f.28)

"Kështu na është sajuar një shtresë e privilegjuar, një Lidhje Komuniste e organizuar mirë, që ka bërë monopol vetëqeverisjen, ose vetadministrimin, siç i thonë në fjalorin ideologjik ***ala titist****, por, në fakt, Lidhja e Komunistëve ushtron pushtet monist."* (Atentatet, f.28)

"Mirani kishte marrë fjalën në debatin me Ministrin. Ndër të tjera ai kishte thënë: "Më mirë e kishim ne studentët nën ***diktaturën komuniste*** *në Jugosllavi... Ky, Zotëri Ministër, ndoshta duhet të jetë njëri nga dallimet midis të demokracisë tuaj këtu dhe* ***diktaturës komuniste*** *atje!"* (Atentatet, f.72)

"– Të atyre ***dy komunistëve*** *sllavë nuk i dua, të Shokut Enver po." (*Atentatet*,* f. 149*)*

"– Atëherë po të sqaroj, unë ***nuk i dua komunistët****, për të mos thënë jam kundërkomunist,"* (Atentatet, f. 150)

"– I thua vetes ***komunist*** *dhe betohesh në zot!? – e ndërpreu Mirani."* (Atentatet, f.165)

"Para sa kohe ishte për një blic-vizitë tek unë në Bochum një ilegal, siç po u thuhet, një thatim që me tangarllëk më kritikoi se ***nuk qenkam komunist****, se Fronti nuk ka organizim të rrebtë revolucionar, nuk është konspirativ e të tjera." (*Atentatet*, f.201)*

"Nuk më tregoi se cili ishte, sado thoshte se më njihte, m'i njihte vëllezërit e shokët në Kosovë. Në fund më tha: "Po të vrojtojmë për të ndikuar që të bëhesh ***komunist*** *i disiplinuar. Pastaj do të të pranojmë në radhët e organizimit tonë".*
Pandeha se mos ishte i OMLK–së*." (*Atentatet*, f.201)*

" – Kështu ***flasin komunistët****, – ndërhyri Renata, e pakënaqur me shpjegimet e tij.* (Atentatet, f. 221)

"– Luftë klasash do të bëjmë ne tani? – pyeti Renata me të qeshur. – Ta thashë, kështu ***flasin komunistët****."* (Atentatet, f. 222)

"Sa për gjuhën ***e komunistëve****, sikur kemi biseduar dhe jemi dakorduar se nuk jam i tillë." (Atentatet, f.222)*

"Varfëria dhe papunësia në këto shtete janë të mëdha, sepse borgjezia e kuqe e ***drejtuesve komunistë*** *dhe e pushtetarëve,* ***po ashtu komunistë****, nuk di të menaxhojë prodhimin."* (Atentatet, f. 222)

"*Shefat e kuq të firmave* ***janë komunistë*** *të dëgjueshëm, ndaj janë kaq të prapambetur*." (Atentatet, f.223)

"– Qenkan të vërteta ato që kam dëgjuar për ty, ***se nuk je komunist*** *i disiplinuar,– tha Kadriu, i pakënaqur me këtë shaka të Miranit."* (Atentatet, f.239*)*

"– Më fal! Vërtet nuk jam komunist dhe aq më pak komunist i disiplinuar, siç kërkoni ***ju komunistët****, sepse atë lloj disipline nuk e pëlqej dhe nuk mund t'i përmbahem.*

Këtë përcaktim, siç e kam, e kam me qejf dhe prandaj me qejfi shoqëroj bisedat ndonjëherë me shaka. Them se edhe në front përballë armikut luftëtarët bëjnë ndonjë shaka, prandaj jeta nuk duhet të jetë kaq serioze sa e merrni ***ju marksistë-leninistët****..."* (Atentatet, f. 239)

"– Sa shumë ndryshoni! Ai kishte natyrë fodulle dhe gati sa nuk e pata përzënë nga

banesa. Nga ai qenke informuar se unë ***nuk jam komunist*** *dhe i disiplinuar.*
Miranit kishte merakun të dinte se cili ishte ai njeri që i kishte folur me kompetenca të mëdha, por me fodullëk edhe më të madh duke pozuar klasikun e marksizëm-leninizmit." (Atentatet, f.241)

"– Po, kemi biseduar. Lëvizja dhe Fronti kishin përcaktime ideore e politike pluraliste, duke inkuadruar në radhë të tyre çdo emigrant shqiptar, pavarësisht bindjeve ideore, politike e fetare. Pas demonstratave të marsit e prillit të vitit të kaluar, ne pranuam tkurrjen e përcaktimit tonë politik në kërkesë për Republikë të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. ***OMLK-ja kishte përcaktim komunist****.* ***Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës****, ndërsa sa u përket simpatizantëve, ai ka afruar edhe bashkatdhetarë që nuk kanë qenë komunistë." (Atentatet, f. 330)*

"Sigurisht as ai. Keqkuptimet e rastit dhe ndërprerjet e bashkëpunimit kanë qenë në natyrë të punës, pasi ne nuk kemi pasur mendësi moniste, që njëri-tjetrit vetëm t'ia miratonim mendimet, propozimet e veprimet, siç ndodh në organizimet homogjene, njëmendësore, që është ***karakteristikë e sekteve dhe e partive komuniste****, të cilat ndrydhin pluralizmin e mendimit."* (Atentatet, f.365-366)

"– I tillë është. Na arratisi nga Malësia e Tropojës në Kosovë sepse nuk i pëlqente regjimi komunist shqiptar. I manipuluar, mendonte se ***regjimi komunist serb*** *ishte më i mirë."* (Atentatet, f.406)

"Ai më arsyetohet se ka dalë për të luftuar komunistët e Enver Hoxhës." (Atentatet, f.406)

"Por, kur i kundërvihem se a nuk ishte ***komunist edhe krimineli*** *Rankoviç, atëherë ministër i brendshëm i Jugosllavisë, ai hesht i zënë në faj, duke u arsyetuar se nuk dinte shumëçka në atë kohë." (Atentatet, f. 406)*

"Malësorja e Gostivarit, Hana, me shami të havalesë në kokë, gjatë vitit 1981, mblodhi ndihma simbolike në tubimet e gjermanëve, pasi u kishte folur atyre për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për domosdoshmërinë e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb dhe nga ***diktatura komuniste****."* (Atentatet, f. 410)

"– ***Komunistë*** *janë edhe ..., Xhafari...".* f.449

"– Por, Jusufi nuk ka qenë ***komunist.****"* (Atentatet, f.449)

1-3. Programi i *Frontit të Kuq* nga libri *LEVIZJA*, i Bedri Islamit
Përplasja me Strukturat komuniste

Ibrahim Kelmendi: *"Gjatë përplasjeve me strukturat komuniste dhe me pushtetin, unë dhe Abaz Mustafa, nga Sukobina e Ulqinit, u fajësuam si organizatorë të protestës. Asaj proteste të njëanshmërisht iu dha karakter politik, nacionalist e armiqësor, siç ishte gjuha e atëhershme zyrtare komuniste. Gjatë hetimeve u fajësova unë si organizatori kryesor.*

Ky ishte ballafaqimi i parë serioz me pushtetin komunist dhe e pashë se mund të ishte një rrugëtim i vështirë.

Praktikë e atëhershme ishte që strukturat komuniste, lidhja e rinisë socialiste dhe lidhja komuniste në fakultet merrnin qëndrim politik, pastaj i kalohej rasti policisë hetimore. Paralelisht angazhohej UDB-ja si hetuese dhe si koordinatore e vendimeve politike të strukturave komuniste." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f. 18)

Ibrahim Kelmendi: "*Ndonjëherë disa pseudoanalistë fajësonin përcaktimin tonë majtist, si shkak të mospërkrahjes nga Perëndimi. Kjo nuk qëndronte. Së pari, sepse në thelbin dhe në programin e saj Lëvizja nuk kishte asgjë të përbashkët me konceptet marksiste, aq më pak komuniste. ...*

Këtë politikë të Perëndimit, pra, nuk e pengonte fare sistemi socialist-komunist dhe monist i Jugosllavisë, sepse përparësi kishin interesat e tyre shtetërore." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f. 172-173)

Një njeri që gënjen për veten e vetë dhe të kaluarën e vetë, vetëm sa mund të merret me mend se çfarë gënjeshtrash mund të thotë për të tjerët.

2. UNITETI I BRENDSHËM I KOMUNISTËVE

Ekzistojnë dy sharte themelore në të cilat bazohet uniteti i organizatave komuniste.

I

Sharti i parë i turqnisë

Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!

II

Sharti i parë i shkinisë

Proletarë të të gjitha vendeve, maskohuni me etiketa komuniste për me i luftua idetë socialiste e komuniste!

2-1. Uniteti i Organizatës Marksist-Leniniste me Partinë komuniste marksist-leniniste Nuk u për-puthet ideologjia – E kujtoj atë takim

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. **Një tentim për kontakt kishte edhe me (Partinë Komuniste - shën im) PKMLSHJ**, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

Leonid Brezhnjev dhe Erich Honecker

Pse nuk i ka dal në takim Abdullah Prapashtica, Berat Luzhës?

Sepse *"Martin Quni (...) Prej Hamzë Morinës e ka marrë 'Liria nr.1' të cilën ia ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon materiale të tilla, ngase siç deklaron ky i akuzuar, **nuk u për-puthet ideologjia**."* (Aktgjykimi i PKMLSHJ, P-K nr. 167/72; Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 678)

2-2. Një fantazmë sillet nëpër Evropë

Xhafer Shatri: *"Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhëtuam me mija kilometra për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasoja të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të udhëtojmë **5000 kilometra**, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative."* (Qarkore, qershor 1983)

Vlen të theksohet se distanca Gjenevë-Moskë është 2843 km. Xhafer Shatri tregohet i gatshëm ti bëjë edhe 2157 km përtej Moskës vetëm për ta arritur një për-puthje.

Nga fryma e fjalëve të Mehmet Hajrizit dhe mënyra se si ai ***e kujton atë takim***, duket se është hidhëruar për shkakun se Abdullah Prapashtica nuk i ka dalë në takim Berat Luzhës, ku qëllimi ka qenë krijimi i një takami komunist. Mendimi im prej një vrojtuesi të jashtëm është se komunisti Mehmet edhe përkundër hidhërimit, megjithatë duhet ta ndiej veten të ngushëlluar. Dihet se klouni komunist, Abdullah Prapashtica e ka thirrur në takim për bisedime nga pozita të barabarta edhe Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë dhe as atyre nuk u ka dalë në takim. Përderisa Lidhja Komuniste e Jugosllavisë nuk është ankuar deri më sot për atë se pse klouni komunist i ka ikur takimit të propozuar nga ai vetë, shtrohet pyetja se prej nga i vjen e drejta Mehmet Hajrizit të ndihet keq, t'i fajësoj të tjerët në mënyrë kaq të pamëshirshme e ta ***kujtoj atë takim*** në mënyrën si e ka shtruar më lartë. Çështje tjetër që flet kundër Mehmet Hajrizit është fakti se komunisti Abdullah Prapashtica i ka dalë në takim, në minutën e caktuar, nën dritën e hanës apo për të qenë më ekzakt nën dritën e gjysmëhanës, Sabri Novosellës, armikut më të madh të sllavo-komunistëve dhe bizantinëve.

Mustafë Xhemaili: "*Romani "SY" është një tronditje. Apo më mirë të thuhet një ritronditje. Sepse autori do të sjellë Shqipërinë nën diktaturën komuniste nga një këndvështrim i veçantë.*

...Ai aq larg shkon në ëndërrimin e lirisë nën regjimin e diktaturës komuniste sa këmbëngulë vazhdimisht se duhej të gjendje një rrugëdalje, një shteg e të dilet në dritën e lirisë." (Sytë e jetës, vlerësime për romanin "SY" të Ardian Kyçykut, 2004, www.mustafe-xhemaili.com)

Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare "LIRIA", organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndri mi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale,si dhe nga gju ha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndersh të autorëve të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta gjejnë e ta lexojnë me kujdes "Lirinë".
Po këtë porosi kemi edhe kur është fjala për revistën "Bashkimi", organ i Frontit të Kuq, me të cilin, besojmë,lexuesit ta në të ndershëm kanë pasur rast të njihen edhe më herët.

Jusuf Gërvalla: "*Edhe publiku ynë, kemi përshtypjen, ka zënë të lidhet me ndonjë këngëtar a kompozitor të caktuar, prej të cilit nuk po do të ndahet dot, pa marrë parasysh kualitetin që i ofron këngëtari a kompozitori që e ka zgjedhur për vete. Kështu, simpatitë e veta edhe sivjet (në mbrëmjen popullore), publiku ia fali kompozitores Pranvera Badivuku (për melodinë e saj "E kujtoj atë takim")"* (Rreth Akordeve të Kosovës '74, Vepra, vëllimi 3, Prishtinë 2010, f. 255)

2-3. Uniteti i OMLK me Frontin e Kuq

(Ilustrimi majtas është nga Lajmëtari i lirisë, tetor-nëntor 1980)

Deri më 3 prill 1981 nuk kisha dëgjuar për emrin "Zeqa" as organin "Liria"

Ibrahim Kelmendi: *”Në ndërkohë, në fillim të prillit 1981, u ndiem të thirrur për ta përshkallëzuar veprimtarinë në Emigracion, në organizim të demonstratave. Kjo mundësoi që unë të njihesha edhe me Kadri Zekën, azilant në Zvicër.* ***Deri më 3 prill 1981 nuk kisha dëgjuar për emrin “Zeqa” as organin “Liria”.*** *I ngarkuar nga Jusufi, udhëtova për në Zvicër të premtën e 3 prillit 1981 që ta takoja Kadriun. Jusufi ma dha adresën dhe pseudonimin e tij*.” (Seri shkrimesh në Facebook, janar 2024-pjesa 6, www.drini.us, 24 prill 2024)

BASHKIMI 8

ASNJË MASË E REVIZIONISTËVE NUK MUND TA MPOSHTË POPULLIN TONË HEROIK

Pushtuesit revizionistë jugosllavë e shërbëtorët e tyre shqiptarë, kohëve të fundit ka-në ndërmarrë kundër popullit tonë një varg masash të dhunës e të demagogjisë. Këto masa të revizionistëve nuk janë të panjohura për popullin tonë dhe nuk e çudisin atë. Gjatë gjithë sundimit të tyre të egër, revizionistët jugosllavë nuk kanë lënë metodë e mjet pa përdorur me qëllim që ta shtypin e shfrytëzojnë sa më egërsisht popullin tonë dhe të shuajnë çdo aspiratë e përpjekje të tij për çlirim kombëtar e shoqëror.

Menjëherë pas luftës klika gjakatare e Tito-Rankoviçit ndërmori masa të papara për ta shfarosur, dëbuar e shkombëtarizuar popullin tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe për të realizuar në këtë mënyrë ëndrrat e çmendura të paraardhësve të tyre shovinistë. Zhdukja mizore e dhjetëra mija shqiptarëve gjatë dhe pas luftës, dëbimi me dhunë për në Turqi e vende të tjera i qindra mija të tjerëve, rrahja e poshtërimi i pothuajse të gjithë burrave kosovarë gjatë aksionit famëkeq të armëve, plaçkitja e pamëshirshme e pasurive tona natyrore, grabitja e dhunshme e tokës dhe e bereqetit, janë vetëm disa nga masat që xhelatët titistë ushtruan mbi kurrizin e popullit tonë. Por, megjithë këto masa të përbindshme, ata nuk ia arritën qëllimit të tyre. Populli ynë trim e patriot nuk u shfaros, nuk e lëshoi tokën e tij të dashur, nuk e harroi gjuhën e tij të ëmbël, zakonet e traditat e lashta shqiptare. Ai nuk u frikësua e nënshtrua para dhunës e terrorit fashist të revizionistëve, por, përkundrazi, urrejtja dhe pezmi i tij u shtuan edhe më shumë.

Propaganda revizioniste ngriti në qiell disa reforma që klika e Titos u detyrua t' i bënte pas vitit 1967 dhe u përpoq ta bindë popullin tonë se tani e tutje do të ndryshonte politika titiste ndaj shqiptarëve, se tani atyre do t'u sigurohej liria e barazia e vërtetë etj.,etj. Krimet e pashembullta që klika titiste kishte kryer kundër popullit tonë, u quajtën "deformime", "shtrembërime" e "gabime", që qenkan bërë "pa dijeninë e Titos" dhe në "kundërshtim me politikën e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë"! Të gjitha fajet për ato që u ishin bërë shqiptarëve iu ngarkuan njërit nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Titos, xhelatit Rankoviq, të cilin klika e Titos e rrëzoi për hesapet e veta dhe aspak për krimet ndaj popullit shqiptar, që kishte kryer së bashku me të sa e sa vite më parë.

Kishte edhe nga ata që u gënjyen nga kjo demagogji dhe menduan se, duke ndërruar qimen ujku po harronte edhe zakonin. Por, populli ynë që në shekuj është mësuar me manovra të ndryshme të armiqve të tij, nuk u mashtrua nga "reformat" dhe propaganda e revizionistëve. Ai e kuptoi se ishin të njëjtat qëllime të të njëjtit armik, se ato që po ndryshonin ishin vetëm format e mjetet e shtypjes dhe shfrytëzimit. Masat e reja të revizionistëve jo vetëm që nuk e gënjyen popullin tonë, por përkundrazi, bënë që të shtohet edhe më shumë urrejtja ndaj shtypësve e shfrytëzuesve dhe lufta e tij për të drejta e liri.

Viteve të fundit, kur kjo luftë, si rezultat i shtimit të pakënaqësisë e urrejtjes së masave dhe ngritjes së ndërgjegjes së tyre kombëtare e klasore, po bëhet gjithnjë e më e vendosur, më e organizuar dhe po merr përmasa gjithnjë e më shqetësuese për regjimin, klika titiste dhe zagarët e saj shqiptar kanë hequr maskën dhe janë hedhur mbi popullin tonë me të gjitha mjetet dhe forcat e tyre. Periudhën pas Rankoviqit, gjatë së cilës populli ynë fitoi disa të drejta, revizionistët tani po e denojnë si "periudhë të liberalizmit", duke arsyetuar kështu hapur vënien përsëri në plan të parë të politikës së tyre të dhunës. Si rezultat, numri i policëve, agjentëve e spiunëve po shtohet pa ndërprerje. Bastisjet dhe arrestimet janë bërë të zakonshme dhe shtohen nga viti në vit. Populli ynë po sheh të ringjallen përsëri veprimet gjakatare të kohës së Rankoviqit.

Revizionistët jugosllavë asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga politika e shkombëtarizimit të viseve të pushtuara shqiptare dhe sllavizimit të tyre. Këtë politikë të poshtër ata po e ndjekin edhe sot me mjete e forma të ndryshme. Më tepër se 130 mijë shqiptarë kanë lënë shtëpitë e tyre dhe, për të siguruar kafshatën e gojës, derdhin djersën nëpër viset e ndryshme të Jugosllavisë dhe jashtë saj. Sa familje shqiptare nga Kosova, Maqedonia, e tani, pas termetit të 15 prillit, sidomos nga Mali i Zi, braktisin përgjithmonë vatrat e tyre e vendosen nëpër republikat jugosllave apo vende të ndryshme të botës. Nga ana tjetër, tokat shqiptare popullohen vazhdimisht me popull -si sllave. Në mënyrë të veçantë, shovinistët maqedonas po përpiqen me çdo kusht të grumbullojnë gjithë diasporën maqedonase dhe ta vendosin atë nëpër viset shqiptare. Në këtë mënyrë shovinistët jugosllavë synojnë të ndryshojnë strukturën nacionale të popullsisë së tokave shqiptare dhe t'i shpallin pastaj tokat tona si toka serbe, malazeze apo maqedonase. Aq larg kanë shkuar ata në këto përpjekje, sa që në emër të planifikimit të familjes etj. të përpiqen që me masa masive mjekësore të pengojnë edhe shtimin natyror të shqiptarëve! Vallë a s'janë këto vazhdim i planeve dhe masave të egra të Qubrilloviqit, Rankoviqit e xhelatëve të tjerë si këta?

Gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë, ashtu si edhe gjatë vizitave të tij të mëparshme, kryerevizionisti Tito i ndërseu disa herë kundër popullit tonë këlyshët e tij në Kosovë, të cilët, ende pa u larguar ai, filluan një fushatë të paparë ndjekjesh, bastisjesh e arrestimesh. Mijëra bij e bija të popullit nga më të mirët u rrahën e u torturuan në mënyrë shtazarake, të denjë vetëm për "udbashët" e Rankoviqit. Dhjetëra bij të popullit u nxorën para gjyqeve revizioniste dhe iu dhanë denime të rënda, të shumtën në mungesë të plotë të fakteve. Të gjitha proceset gjyqësore u mbajtën me dyer të mbyllura, sigurisht jo nga frika se mos populli do t'i sulmonte bijtë e tij, siç përralliste "Politika", por nga frika e madhe që ka regjimi titist nga populli i mbushur plot pezm e urrejtje.

Pushtuesit revizionistë dhe hyzmeqarët e tyre shqiptarë shpresuan se me këto masa do ta frikësonin popullin tonë, por, siç detyrohen të pranojnë edhe vetë, u gabuan keq. Populli ynë jo vetëm nuk u frikësua, por e shtoi edhe më shumë urrejtjen dhe luftën e tij kundër regjimit titist, kurse bijtë e tij me qendresën dhe luftën heroike në gjyqet dhe burgjet anekënd Jugosllavisë, po u kallin tmerrin armiqve e tradhtarëve, edhe duke qenë të lidhur me pranga e zinxhirë.

Me anë të këtyre masave, armiku synon të zbulojë e të zhdukë në radhë të parë patriotët dhe komunistët e vërtetë, tek të cilët ai, me të drejtë, sheh edhe rrezikun më të madh. Me qëllim që t'i diskreditojë ata dhe t'i izolojë nga populli, nga nëna që i ka lindur, ai ka ndërmarrë kundër tyre një fushatë të gjerë shpifjesh e trillimesh. Për këtë qëllim, armiku mundohet t'i futë ata në një thes me gjith farë elementësh, t'i akuzojë ata si "nacionalistë", "irredentistë", "reaksionarë", "armiq të popullit" etj.,etj. Por, populli ynë nuk ma shtrohet. Ai i njeh mirë dhe di t' i dallojë bijtë e tij të vërtetë dhe armiqtë e tij të vërtetë.

Krahas masave të egra të dhunës, revizionistët jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre kanë vënë në veprim një makinë të tërë propagandistike me qëllim që t'i mashtrojnë, çorodisin e e degjenerojnë masat popullore dhe, në këtë mënyrë, t'i largojnë ato nga hallet dhe problemet e shumëta që i preokupojnë, nga lufta e tyre për të drejta e liri.

Mjetet e propagandës revizioniste, shtypi, radioja, televizioni etj., po mundohen me të gjitha mënyrat t'ia mbushin mendjen popullit tonë se Jugosllavia na qenka atdheu ynë, se sistemi i saj "vetadministrues" na qenka "sistem i vërtetë socialist, sistemi "më human" e "demokratik", sistem që u siguroka masave "liri", "mirëqenie" e "begati", se politika e "mosangazhimit" na qenka "e vetmja politikë e jashtme e drejtë" etj., etj. Por, populli ynë nuk mashtrohet nga këto profka. Ai e ka të qartë dhe po e kupton gjithnjë më mirë se Jugosllavia e revizionistëve është atdheu ynë aq sa ishte (dikur) Turqia e sulltanëve, Jugosllavia e kralëve apo Italia fashiste, se Jugosllavia e Titos është socialiste, humane e demokratike aq sa është Spanja e Karllosit apo Kili i Pinoçetit. Populli ynë po e kupton gjithnjë e më mirë se "liria", "barazia", "mirëqenia" e "begatia" revizioniste s'janë gjë tjetër pos shtypje e shfrytëzim i egër kolonial e kapitalist, pos krizë e inflacion i papërmbajtur, ngritje e përditshme e çmimeve, papunësi, skamje, kurbet e mjerim. Ai po e kupton, gjithashtu, se politika e jashtme e revizionistëve jugosllavë s'është gjë tjetër pos një politikë antimarksiste e kundërrevolucionare, politikë e shitjes së interesave dhe sovranitetit të popujve të Jugosllavisë tek superfuqitë e vendet e tjera imperialiste.

Qysh kur ishte gjallë Titoja dhe sidomos pas vdekjes së tij, propaganda revizioniste në Jugosllavi dhe Kosovë, duke fryrë deri në absurd kultin e Titos, u mundua ta nxirte atë si "njeriun më të madh të shekullit" (më i madh edhe se Lenini!), si "birin më të dashur të kombeve e kombësive të Jugosllavisë" etj.

Në mënyrë të veçantë krerët sahanlëpirës të Kosovës dhe disa kalemxhinj të shitur u munduan ta nxjerrin Titon edhe si "mikun më të madh" dhe "njeriun më të dashur të shqiptarëve"... Por, populli ynë i njeh mirë "meritat" e revizionistit Tito, i njeh mirë krimet dhe mizoritë e pashembullta që janë kryer mbi kurrizin e tij nga ky tiran dhe antishqiptar i tërbuar, dhe nuk gënjehet dot.

Rëndësi të veçantë, në përpjekjet e tyre për ta mbajtur popullin tonë në robëri, revizionistët jugosllavë dhe tradhtarët shqiptarë po i kushtojnë shthurrjes dhe degjenerimit të masave popullore dhe, sidomos, të rinisë, si mjet të preferuar për t'i trullosur e çorodítur ato dhe për t'ua shuar kështu çdo ndjenjë patriotike e revolucionare. Për këtë qëllim, ata po përhapin me të gjitha mjetet e tyre edhe kulturën dekadente, religjionin, modën borgjeze e mënyrën amerikane të jetesës, alkoolizmin, pornografinë, prostitucionin etj. Por, a do të lejojë vallë rinia jonë e pastër dhe e zjarrtë që të bjerë në batakun ku duan ta hedhin armiqtë e saj? Jo. Ajo po kupton se rruga e saj nuk është rruga e jetës së shthurrur boshe e pa ideale, të cilën ia tregojnë revizionistët, por rruga që ua tregon atyre Avni Rrustemi, Qemal Stafa e Emin Duraku, rruga që ua tregon marksizëm-leninizmi, rruga e luftës për liri e socializëm. Këtë dhe vetëm këtë rrugë do ta ndjekë rinia jonë revolucionare.

Një propagandë të poshtër po bëjnë pushtuesit revizionistë dhe zagarët e tyre shqiptarë edhe kundër Atdheut tonë të dashur, Shqipërisë socialiste. Ata, për demagogji, herë pas here deklarojnë se janë shumë të interesuar për marrëdhënie "të mira" e "miqësore" me Shqipërinë, kurse në mbledhjet e shumëta që organizojnë në popull fabrikojnë kundër saj trillime e shpifje nga më të poshtrat. Në këtë mënyrë ata përpiqen, përveç tjerash, edhe të armiqësojnë popullin tonë të robëruar në Kosovë Maqedoni e Mal të Zi me vëllezërit tanë të lirë në Shqipëri, me Partinë e lavdishme të Punës dhe udhëheqjen e saj marksiste-leniniste. Por, siç e ka bërë të qartë shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë, këto përpjekje janë krejt të kota dhe do të dështojnë me turp. Populli ynë po i sheh sukseset madhështore që po korr Atdheu i tij në të gjitha fushat, po e sheh në praktikë drejtësinë e politikës së kristaltë marksiste-leniniste të Partisë së Punës dhe nuk po u beson më të lehurave të armiqve dhe tradhtarëve. Dashuria e tij ndaj Shqipërisë socialiste, Partisë së saj dhe udhëheqësit tonë të madh, shokut Enver Hoxha, është aq e madhe sa që nuk mund ta shuajë e lëkundë dot asnjë forcë në botë.

Populli ynë heroik, që kurrë në historinë e tij të lavdishme nuk është nënshtruar e përulur para armiqve të tij të shumtë e të egër, nuk bie në gjunjë as para kralëve revizionistë të Beogradit dhe një grushti shqiptarësh të shitur. Ai nuk frikësohet nga dhuna e egër e regjimit titist dhe as mashtrohet nga propaganda e tij e poshtër, por, ashtu si të gjith armiqve të tjerë, do t'i tregojë edhe atij grushtin e tij dërrmues. I bashkuar si një trup i vetëm, populli ynë do të vazhdojë luftën e tij deri në fitoren e plotë dhe do të çojë në vend amanetin e shenjtë të Isa Boletinit, Bajram Currit e Shotë Galicës, të Ali Kelmendit, Asim Vokshit, Emin Durakut e mijëra dëshmorëve të ndritur, që jetën e tyre ia falën lirisë së shtrenjtë.

»LIRIA« Nr. 1

Ne e ndjekim me indinjatë të thellë bllo- tar me të cilin i kishim çliruar tokat tona;

Artikull i huazuar nga numri i parë i revistës Liria, tetor 1980, i ribotuar e përgatitur nga Jusuf Gërvalla në gaztën Bashkimi, janar 1981, faqe 8. (Artikulli lexohet me lehtësi nëse i rrisni germat)

Ibrahim Kelmendi: *”Në ndërkohë, në fillim të prillit 1981, u ndiem të thirrur për ta përshkallëzuar veprimtarinë në Emigracion, në organizim të demonstratave. Kjo mundësoi që unë të njihesha edhe me Kadri Zekën, azilant në Zvicër.* ***Deri më 3 prill 1981 nuk kisha dëgjuar për emrin “Zeqa” as organin “Liria”.*** *I ngarkuar nga Jusufi, udhëtova për në Zvicër të premtën e 3 prillit 1981 që ta takoja Kadriun. Jusufi ma dha adresën dhe pseudonimin e tij*.” (Seri shkrimesh në Facebook-janar 2024, pjesa 6 - me titull: SABRI NOVOSELLA – TERRORIZUES PSIQIK I JUSUF GËRVALLËS, www.drini.us, 24 prill 2024)

2-4. KADRIU I PROPOZON ANËTARËSIM IBRAHIM KELMENDIT POR AI NUK PRANOI

Dëshmitari i komunistëve të OMLK-së, Ibrahim Kelmendi nuk pranon të bëhet shok organizate me Kadri Zekën.

Ibrahim Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin,* ***por Mirani nuk pranoi*** *me arsyetimin se dëshironte të priste edhe ca, pasi bisedimet duhet të rindodhnin shpejt dhe ato do të sillnin bashkimin."*(Atentatet, f. 306)

Ibrahim Kelmendi: *"Unë nuk kisha kaluar në ndonjë organizim me vete të Kadri Zekës. As ai nuk e ka kërkuar këtë nga unë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 85)

*"Ky dokument ishte një bazë e mirë për t'u zhvilluar bisedime për themelimin e një fronti popullor, bashkim e centralizim të lëvizjes patriotike e komuniste të Kosovës. Për këto qëllime, në tetor të vitit 1981 Kadri Zeka me Bardhosh Gërvallën udhëtojnë në Turqi për bisedime që mundësisht të arrihej bashkimi në baza të "****Tezave****..." në mes OMLK-së dhe LNÇKVSHJ,* ***pasi <u>më parë</u> ky bashkim ishte arritur me FKP*** *(Frontin e Kuq Popullor-shën. ynë)."* (Kadri Zeka, Vepra, Biblioteka "Liria", Buchhandlung Badhausstr. 35, 2503 Biel-Bienne, Zvicër, korrik 1986, faqe 18)



ntit Popullor për Republikën e Kosovës» për shqyrtim. Ky dokument ishte një bazë e mirë për t'u zhvilluar bisedime për themelimin e një fronti popullor, bashkim e centralizim të lëvizjes patriotike e komuniste të Kosovës. Për këto qëllime, në tetor të vitit 1981 Kadri Zeka me Bardhosh Gërvallën udhëtojnë në Turqi për bisedime që mundësisht të arrihej bashkimi në baza të «Tezave...» në mes OMLK-së dhe LNÇKVSHJ, pasi më parë ky bashkim ishte arritur me FKP. Biseda e parë nuk çoi deri te qëllimi. Si zakonisht derisa zgjasin diskutime për ndonjë bashkim puna vazhdon e veçuar. Dhe Kadriu detyrohet që me forcat e OMLK-së jashtë të përgatisë teknikisht numrin 6-të të «Lirisë».

Më 2 janar '82 martohet. Në këtë gëzim familjar thirri shumë shokë. Krushq ishin luftëtarët e lirisë. Në dasmë ishin edhe shokët Jusuf e Bardhosh Gërvalla, me të cilët bisedoi rreth disa përçarjeve që kishte filluar t'i nxisë armiku.

Katër ditët e fundit të jetës - siç shkruan një shok, i kaloi në RFGJ. Më 13 janar udhëtoi në RFGJ. Atje do të takohej me shokët PKGJ (Partia Komuniste Gjermane), për të biseduar në lidhje me bashkëpunimin internacionalist të OMLK-së me PKGJ. Me atë rast shokëve gjermanë u sqaroi shumëçka rreth situatës në Kosovë dhe sidomos rreth gjendjes së klasës punëtore të Kosovës dhe pararojës së saj — OMLK-së. Gjatë bisedimeve u arrit mirëkuptim. Mbeti që bisedimet të vazhdonin kurse nga ana e shokëve gjermanë u sigurua se do të përkrahej populli ynë, sidomos do të përkraheshin demosntratat që bëheshin në RFGJ.

18

Kadri Zeka, Vepra, Biblioteka "Liria", Buchhandlung Badhausstr. 35, 2503 Biel-Bienne, Zvicër, korrik 1986, faqe 18

Jusuf Gërvalla*: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to**, tani që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Dëshmitari i komunistëve të OMLK-së, Ibrahim Kelmendi nuk pranon të bëhet shok organizate me Kadri Zekën.

Ibrahim Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi** me arsyetimin se dëshironte të priste edhe ca, pasi bisedimet duhet të rindodhnin shpejt dhe ato do të sillnin bashkimin."*(Atentatet, f. 306)

Ibrahim Kelmendi: *"Unë nuk kisha kaluar në ndonjë organizim me vete të Kadri Zekës. As ai nuk e ka kërkuar këtë nga unë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 85)

Kush e di këtë punë më së miri pos I. Kelmendit? Se si nuk pranon Ibrahim Kelmendi të bëhet shok në një organizatë me Kadri Zekën, përveç Jusufit, në mënyrë të mrekullueshme

-e dëshmon Faridin Tafallari:

Faridin Tafallari*: "Për herë të parë u prezantova me të në Shtutgart; ai ishte me Ibrahim Kelmendin që kishte telefonuar të vija në takim. M'u afrua dhe më tha: "Ti Faridin me të vërtetë je luftëtar i lirisë. Të kam veçuar nga të tjerët. Duhet të bisedojmë bashkë shtruar e gjerësisht.*

Po i thash - jam i lumtur dhe me dëshirë pres atë çast. Që aty u nisëm për në banesën time. Kadriu me Ibrahimin e kishin vendosur që më parë të më takonin dhe prandaj më kishin telefonuar... Kadriu më foli për Organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK). Më pyeti se a isha i organizuar diku dhe unë iu përgjigja se për këtë kam biseduar me Jusufin. ...

Çështjen e organizatave si e shikoni shoku Zekë, fjalën e kam për bashkimin e tyre se Jusufi më ka folur për bashkimin e të gjitha organizatave që veprojnë.

***-Po Faridin tha Kadriu**, - nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.*

***Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar** dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)." (*Terror, Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 37-38)

- e dëshmon Hasan Mala, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë:

Hasan Mala*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f. 382)

- e dëshmon Xhafer Shatri, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë.

Xhafer Shatri: *"Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës..."*. (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, f. 382)

Për sqarim në këtë rast dua të them se vlerësimet e mrekullueshme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit për librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë (1997) gjenden të botuara në librin vijues të F. Tafallarit, Dhimbje Krenare (Tiranë, 1998).

Dëshmia e Faridin Tafallarit, Hasan Malës dhe Xhafer Shatrit për bashkimin e Kadri Zekës me Frontin e Kuq Popullor përputhet tërësisht me faktin që na e ka lënë Jusufi me shkrim.

Jusuf Gërvalla: *"Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to**, tani që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Jusufi e di dhe na e jep faktin më të fuqishëm e të padiskutueshëm se **ku bënë pjesë** dhe cilët janë **shokët e rinj** të Ibrahim Kelmendit, të cilët ky far Ibrahim Kelmendi, i cili është person "*që i respekton vendimet*", e demonstron besnikërinë për shokun e vetë të vrarë në këtë formë:

"*Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi"***,
e mohon me sa fuqi që ka. Por nuk është vetëm Ibrahim Kelmendi që e mohon Kadri Zekën e gurin e varrit të tij. Ky farë Ibrahim Kelmendi, ky farë shoku i Kadri Zekës është dëshmitari i besueshëm i vëllezërve të Kadriut, Saime Isufit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës e Mehmet Hajrizit.

Suzana Gërvalla: "*Më vonë ka pasë probleme me marksist-leninistët. U bënë bashkë Ibrahim Kelmendi me Kadri Zekën kundër Jusufit."* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016; YouTube-3 gusht 2017, koha në film 5:24-5:57)

Ibrahim Kelmendi së bashku me rrethin e vetë, nga viti 1985, i kanë dënuar bashkimet e 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, me shpresën se vetë do të krijojnë ndonjë datë më të rëndësishme, e kanë riorganizuar OMLK-në e Kadri Zekës, me qëllim të **DOMINIMIT ME ÇDO KUSHT** mbi të tjerët dhe e kanë udhëhequr deri në shembjen e Murit të Berlinit. Vetëm pas shembjes së Murit të Berlinit, falimentimit të etiketave marksiste-leniniste, pas 30 vitesh, riorganizuesit marksist-leninistë riorientohen e mundohen të tregojnë rëndësinë e shtëpisë së Jusuf Gërvallës dhe Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

2-5. Uniteti i Rexhep Qosjes e Ismail Kadares me Prof. Dr. Abdyl Kadollin

Rexhep Qosja: "*Kam pasur fatin e kam pasur nderin gjatë disa dhjetëra viteve të bashkëpunoj me te dhe ashtu më është dhënë rasti që ta njoh më mirë e më thellësisht natyrën e tij të pasur me shumë e shumë virtyte.*

Abdyl Kadolli ishte intelektual që jetonte ngadalë. Dhe kjo ngadalësi jetësore i bënte të mundshme ta njihte më mirë e më thellësisht njëmendësinë shoqërore, politike, kulturore, kombëtare në përgjithësi. Dhe kjo ngadalësi jetësore i bënte të mundshme që të gjitha punët me të cilat merrej t'i bënte e t'i kryente më mirë e më sigurt e më vlefshëm se gjithë ata që jetojnë e punojnë nxitueshëm.

Abdyl Kadolli ishte intelektual me përgjegjshmëri gjithnjë të zgjuar, gjithnjë të përkushtuar ndaj gjithë atyre me të cilët punonte e bashkëpunonte dhe ndaj të gjitha punëve që bënte. Kjo përgjegjshmëri, kjo dhuratë e madhe natyrore e tij, e kishte bërë shumë të përkushtuar ndaj të drejtës, shumë të përkushtuar ndaj të vërtetës, shumë të përkushtuar ndaj të gjitha vlerave që jetës i japin kuptim." (gazetaeprizrenit.net, 20 prill 2019)

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Ismail Kadare: "*Terrori i përditshëm, sistematik, monoton ishte shumë më i keq se dhuna spektakolare. Ishte dispozita e veçantë e komunizmit. I krahasuar, për shembull, me terrorin fashist, terrori komunist ishte shumë më diskret, i fshehtë, i heshtur dhe i maskuar".*

"Nëse dënimi ishte kërkuar nga lart dhe nëse mbledhja ishte publike, mbrojtja ishte e pamundur, ndoshta fatale për viktimën. Mbrojtja haptazi merrej si sfidë haptazi ndaj partisë". ("La Republica", www.balkanforum.info, nëntor 2009)

Ismail Kadare: "*Është hipokrizi, është dyfytyrësi të thuash se ne jemi evropianë, por mos na pyesni më shumë për të kaluarën. Prandaj diskutimi duhet të bëhet. Nëse kemi këtë dilemë, ne e vëmë veten në skizofreni morale, që është gjëja më e pamoralshme e një kombi" -ka thënë ai. "Ka gjëra që për arsye të ndryshme munden që për një kohë t'i refuzohen publikut, çdo shoqëri e ka këtë, ka arkiva që nuk hapen për vjet të caktuara për arsye të ndryshme, por shoqëritë demokratike duhet të shpjegojnë ato që ndodhin në strategji të zhvillimit të shtetit, në politikë, në ekonomi, në të gjitha."* (http://lajme.dervina.com, nëntor 2009)

2-6. Uniteti i Prof. Dr. Abdyl Kadollit me Emrush Xhemailin

Emrush Xhemaili: "*Abdyl Kadolli do të mbetet shembull i intelektualit të përkushtuar ndaj profesionit dhe ndaj vendit tonë, gjithherë i gatshëm të shërbej për kauzën e lirisë, çlirimin e bashkimin kombëtar. Në fushën e ideve ai ishte nga ata intelektual që e thotë të vërtetën edhe kur ka pasoja personale*." (Fjalë në mbledhjen përkujtimore në Institutin Albanologjik në Prishtinë, me rastin e vdekjes së Prof. Abdyl Kadollit, yotube.com, 18 prill 2019)

2-7. Uniteti i Prof. Dr. Abdyl Kadollit me Xhafer Shatrin

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'd**o** të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!"** Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE DHE POPUJ TË SHTYPUR , BASHKOHUNI!

LIRIA

ORGAN I MARKSISTË-LENINISTËVE TË KOSOVËS TETOR 1980 Nr.1

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'd**o** të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!"** Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)



Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!"** Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!**" Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që **përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste**."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Lart dhe poshtë; koka e numrit 6 (Dhjetor 1981) të revistës Liria. Lart-gabimi teknik është ndrequr me dorë. Gabimi teknik poshtë nuk është ndrequr.

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

Gusht 1981 Nr. 4-5

DENIMET E RENDA NUK MUND TA FRIKSOJNE POPULLIN TONE

Saime Isufi: "***Më 12 janar 1982, Kadriu u nis në*** *Gjermani për të kontaktuar me veprimtarë. Ndër ta edhe me Vëllezërit Gërvalla****. Me vete mori edhe materialet e numrit 6-të të 'Lirisë' për t'i botuar*** *si dhe 'Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës'. Tezat do t'i konsultonte edhe me vëllezërit Gërvalla.* ***Numri i 6-të i 'Lirisë' doli pas rënies së Kadriut****. Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Numri 6 i revista Liria sipas Taip Zekës e Saime Isufit ka dalë pas vrasjes. Kjo nuk është e vërtetë. Jusufi, përjetësisht e ka ndërpre çdo angazhim të vetin me revistën Liria, pas zbulimit të qëndrimeve të OMLK-së - Kadri Zekës para Sabri Novosellës në Stamboll në mesin e tetorit 1981. Numri 6 i revistës Liria ka dalë në dhjetor 1981.

Dihet se revista Liria asnjëherë nuk e përmend organizatën e Jusuf Gërvallës me asnjë fjalë të vetme. Këtë nuk e bënë as numri 6 i Lirisë i dhjetorit 1981. Se numri 6 i cili paska dalë pas vrasjes dhe nuk e thotë asnjë fjalë për vrasjen Jusuf e Bardhoshit është krejtësisht në rregull me frymën dhe politikën e Lirisë, por mbulimi i rrenës e kërkon arsyetimin, zbulimin se pse ky numër i dalë "pas vrasjes", së 17 janarit 1982, nga 300 anëtarët dhe 300 simpatizantët e OMLK-së nuk e thotë asnjë fjalë për vrasjen e Kadri Zekës. Pas vrasjes, unë, Skenderi i Shtutgartit, jam i vetmi person që kam shkruar, dhe atë në mënyrë të barabartë, për Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën.

Xhafer Shatri: *"Ta thjeshtësosh në një individ pa asnjë peshë, vrasjen e tyre, mua më duket absolutisht e pafalshme, dhe realisht kjo punë bëhet edhe nga njerëz të cilët në vitet 1980-të kanë arritur që lëvizjen kombëtare ta përçajnë keqas dhe ta zëmë citatin e Jusuf Gërvallës të cilin ne e venim në ballë të Zërit të Kosovës e i cili ishte një citat kushtrimtar i cili thoshte: "Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme." Do me thënë dhe në vend të tij ta nxjerrësh pastaj "****Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!"*** *Njeriu nëqoftëse i shikon këto gjëra do me thënë e sheh që* ***përpiqen ta mbrojnë Jusuf Gërvallën njerëzit që janë përpjekur ta vrasin për së gjalli, t'i vrasin idetë e tij, idetë e tij nacionaliste****."* (Intervistë dhënë Agron Bajramit, www.koha.net, 27 korrik 2012, Press-ing, program televiziv, minutat 25-28)

Adem Gashi: *"Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë* ***mistreci komunist...***" (Dyndalla e mendimeve, Hotel Viktoria, 5 shkurt 2007)

I. Kelmendi*: "Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende* ***nuk ke anëtarësuar njeri*** *vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni." (Atentatet, f.293)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

I. Kelmendi***: "OMLK-ja kishte përcaktim komunist. Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës (****Atentatet, f. 330)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

2-8. Regjimi socialist po luftohej me socializëm

*"**Apostol Duka**: Thatë se e ndërruat emrin e Grupit tuaj Revolucionar. Më lejoni t'ju pyes: E ndërruat sepse bindjet tuaja ideologjike ishin marksiste-leniniste, e ndërruat sepse duhej ndërruar, apo e bëtë këtë gjë për të qenë të ngjashëm me veprimtarinë politike e ideologjike të shtetit-amë?*

Mehmet Hajrizi*: E kuptoj këtë pyetje me ngut. Sot, pas kaq vitesh, duhen sqaruar këto emërtime të Organizatës, që për brezin* ***aktual duken demode*** *dhe të largëta, edhe pse nuk e cënojnë aspak karakterin nacionalçlirimtar dhe rëndësinë historike të saj... Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste* ***që ishte në modë atëherë****, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim.*

...Po të shikohen dokumentet e Organizatës, bëhet e qartë si drita e diellit se veprimtarët e Lëvizjes së Kosovës, pavarësisht emërtimeve dhe literaturës që lexonin, luftonin për të drejtat dhe çlirimin e popullit shqiptar dhe jo për triumfin e ndonjë ideologjie në atdheun e tyre apo në botë.

*...**M. Hajrizi**: Ndikimi nuk mund të mohohet, por ne fokusoheshim tek shkelja nga udhëheqja jugosllave e parimit të vetëvendosjes së popujve, e cila ishte pjesë përbërëse e doktrinës lenineste dhe premtim demagogjik i Titos e partisë së tij komuniste.*

...Së katërti regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm edhe për një arsye që e diktonin rrethanat historike.

...Apostol Duka: Ky është trajtimi dhe shpjegimi më i plotë që kam dëgjuar deri tani dhe juve jo më kot paskeni qenë udhëheqësi i asaj organizate. (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, f.163-167)

2-9. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste

Mehmet Hajrizi: *"Sabile Keçmezi-Basha ka shkruar; "Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-socialiste në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e 'Grupit Revolucionar" që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës."" (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 316)

2-10. Nuk janë të afërta as të pranueshme

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"
"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto* ***emërtime*** *të Organizatës, që për brezin aktual* ***nuk janë të afërta as të pranueshme****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

Mehmet Hajrizi: *"Filozofia politike, mendimi i ri politik, analizat e thella të gjendjes dhe të situatave,* ***qartësia e perspektivës****, ndërtimi i strategjisë dhe taktikave në shërbim të saj, ishin shprehje e një pjekurie dhe kulture të lartë politike e kombëtare të radhëve të Organizatës (Marksiste Leniniste të Kosovës -shën. ynë)."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 318)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

2-11. DIKTATI I KEQ DHE HEGJEMONIA E MIRÊ

Mehmet Hajrizi: "*Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste, që ishte në* ***modë*** *atëherë, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim, prandaj pjesëtarët e saj nuk duhen ngatërruar me pushtetarët që e përdornin apo keqpërdornin për diktat dhe sundim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 98)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***ruante rolin hegjemon****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

"Qamil Beu - *Para se ta filloj ketë gjykim të ndritshëm në emër të Padishahut, nurit të Perëndisë, do të parafrazoj një ajet nga Kurani kerim i cili thotë se: Dielli nuk ka nevojë kurrë ta zej hënën, as nata ta kaloj ditën, çdo gjë në gjithësi noton. Edhe këtë gjyq unë kështu e kuptoj. Të kërkosh që nata ta kaloj ditën do të thotë të mohosh ligjet e Perëndisë. Të ngresh dorë kundër Padishahut, nurit të Perëndisë, do të thotë që të jesh i padijshëm e të mohosh ligjet e gjithësisë që paraqesin vullnetin e Perëndisë. Dihet fare mirë i pandehur (Abdyl Frashëri) se nata është natë, dita është ditë, dielli është diell e hëna hënë*." (Ekrem Kryeziu, Epoka para gjyqit, 1978)

Ankesa është arma e të mjerit.

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

2-12. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik ...Përmes ***ngjyrimit ideologjik****, kemi tentuar t'i* ***kundërvihemi ideologjisë komuniste*** *titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Saime Isufi*: "OMLK është cilësuar si "Organizata që pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-socialiste në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e Grupit Revolucionar që më vonë u shndërrua në OMLK". (Sabile Keçmezi-Basha)." (*VLERAT HISTORIKE, STUDIMORE E SHKENCORE TË LIBRIT "HISTORI E NJË ORANIZATE POLITIKE DHE DEMONSTRATAT E VITIT 1981", pashtriku.org, 2 qershor 2009)

Simpoziumi shkencor kushtuar Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, 17 janar 2017 në Institutin e turqnisë të Prof. Dr. Abdyl Kadollit

Xhevat Bislimi: *"Viti, 17. 02. 2015 - Data e 17 Shkurtit shënon një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së re shqiptare. Më 17 Shkurt të vitit 1982, një muaj pas vrasjes mizore të atdhetarëve dhe ideologëve shqiptarë, Vëllezërve Gërvalla dhe të Kadri Zekës, u themelua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës - LPRK." (*17 SHKURTI I THEMELIMIT TË ORGANIZATËS KOMBËTARE NACIONAL'ÇLIRIMTARE – LPRK, 17 shkurt 2015; pashtriku.org; albaniapress.com)

Bedri Islami: "*Është zgjedhur qëllimisht data 17 shkurt, sepse më 17 shkurt është krijuar Lëvizja Popullore e Kosovës dhe Thaçi tha do se ta shpallim pavarësinë në një ditë të shënuar për Kosovën. Dhe meqenëse ka qenë për shumë vite një nga drejtuesit e LPK zgjodhi këtë datë. Ndoshta bëjë gabim që e shpalosi për herë të parë këtë ide sepse tjerëve nuk u ka rënë në mend por fakti kështu është*" (Bedri Islami i ftuar në emisionin "Arnautistan" të drejtuar nga Mustafa Nano, MCN TV, Youtube 16 shkurt 2022, koha në film 11:35-12:16)

2-13. Kurrë nuk kanë qenë komunistë

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë*." (Bota Sot, 14 shtator 2009)

Kosovapress: "*Në punimet e sotme të Konventës së VI-të të PDK-së është diskutuar edhe rreth profilit të partisë, me ç'rast delegatët janë përcaktuar për profilizimin si parti e qendrës së djathtë*." (PDK profilizohet si parti e qendrës së djathtë, wwww.kosovapress.com, 27 janar 2013)

2-14. Shkenca e Institutit të turqnisë i Prof. Dr. Abdyl Kadollit

Prof. Dr. Abdyl Kadolli: "*Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. ...Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave. Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës... Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët."* (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Emrush Xhemaili: "*Abdyl Kadolli do të mbetet shembull i intelektualit të përkushtuar ndaj profesionit dhe ndaj vendit tonë, gjithherë i gatshëm të shërbej për kauzën e lirisë, çlirimin e bashkimin kombëtar. Në fushën e ideve ai ishte nga ata intelektual që e thotë të vërtetën edhe kur ka pasoja personale*." (Fjalë në mbledhjen përkujtimore në Institutin Albanologjik në Prishtinë, me rastin e vdekjes së Prof. Abdyl Kadollit, yotube.com, 18 prill 2019)

3. Uniteti i Jusuf Gërvallës me Ibrahim Kelmendin

3-1. Skema e gënjeshtrave

Victor Hugo: "*Little lie, innocent lie—does such a thing exist? To lie is the absolute form of evil. To lie a little is not possible: he who lies, lies the whole lie. To lie is the very face of the demon. Satan has two names; he is called Satan and Lying."*

Për raportin e Jusuf Gërvallës me Ibrahim Kelmendin kam shkruar më gjerësisht në librin tim *Lëvizja e Jusuf Gërvallës*.

Në janar 1980 Ibrahim Kelmendi i lutet Jusufit t'i ndihmoj në revistën Bashkimi. Duke e parë gjendjen e keqe të Bashkimit, Jusufi e sheh të udhës dhe të lejueshme t'i ndihmoj dhe i përgatitë tre numra të Bashkimit. Në janar 1981 del numri i fundit i Bashkimit. Shkaku vendimtar me i ndërpre të gjitha marrëdhëniet përjetësisht me Ibrahim

Kelmendin, pos tjerash, është roli i Ibrahim Kelmendit në dërgimin e Hysen Gegës në Kosovë me Sadik Blakajn, në dhjetor 1980.

Të gjitha ato që ka shkruar Ibrahim Kelmendi në librat *Atentatet, Lëvizja* dhe shkrime në mediume sociale, për Jusuf Gërvallën janë gënjeshtra, të cilat lehtë vërtetohen me shkrimet dhe letrat e Jusuf Gërvallës, në letrat e Ibrahim Kelmendit dhe dëshmi të tjera.

Thelbi i gënjeshtrave të Ibrahim Kelmendit është se:

-Në vitin historik 1981 Ibrahim Kelmendi është shoku më i afërt i Jusuf Gërvallës,

-Jusuf Gërvalla me Ibrahim Kelmendin i diskuton të gjitha imtësitë private të familjes së vetë dhe e pranon si ortak në edukimin e fëmijëve të vet,

-Jusuf Gërvalla i diskuton me Ibrahim Kelmendin të gjitha imtësitë e organizatës së vetë, dhe për personat e ndryshëm të saj, sidomos rreth Sabri Novosellës dhe Xhafer Durmishit,

-Jusuf Gërvalla diskuton e ka biseda pune me Ibrahim Kelmendin në shtëpinë e tij se si është gjendja e aktiviteteve në rrethin e Shtutgartit,

-Jusuf Gërvalla në kërkesën për strehim politik në Gjermani të bërë në fillim të vitit 1980, nuk merr përgjigje nga organet gjermane deri në fund të vitit 1981, vetëm në fund të vitit 1981 i jepet pasaporta, dhe rruga e tij e parë jashtë Gjermanisë prej daljes në Gjermani është udhëtimi në Zvicer në dasmën e Kadri Zekës e Saime Isufit, më 2 janar 1982.

-Çka do të thotë kjo?

-Se Jusufi gjatë dy viteve në Gjermani ka qenë i izoluar e nuk ka dalë prej derës së shtëpisë, por kur e ke një shok si Ibrahim Kelmendin kjo nuk do të thotë kurrfarë mangësie. Për këtë arsye Jusufi, pas shpërthimit të demonstratave të Kosovës në Pranverën 1981, e dërgon Ibrahim Kelmendin në Zvicër të merr kontakt me Kadri Zekën, të bisedoj me te dhe para Kadriut, Ibrahimi e përfaqëson veten dhe Jusufin. Në mënyrë analoge Jusufi e dërgon Ibrahim Kelmendin me punë në Austri në Ambasadën shqiptare të Vjenës për ta marrë mendimin e qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj demonstratave që do të organizoheshin në Evropë. Në mënyrë të ngjashme e ka ndërmend që bashkë me Kadri Zekën ta dërgoj Ibrahim Kelmendin me mision në Turqi që të bisedoj me Sabri Novosellën e Kadri Zekën për bashkimin e organizatave. Në atë rast para Sabriut, Kadriu do ta përfaqësonte OMLK-në, ndërsa Ibrahim Kelmendi veten dhe Jusufin e Bardhoshin.

-Për shkak të të gjitha këtyre detyrave, obligimeve e udhëtimeve, Jusufi, pasi më herët e ka bërë ortak Ibrahim Kelmendin në çështjen e edukimit të fëmijëve, e bënë atë hisedar në shtëpinë e vetë, ia ndanë një dhomë në të cilën nuk guxon të hyj askush pos Ibrahim Kelmendit.

-Se gjatë demonstratave Jusufi, Kadriu e Ibrahim Kelmendi bashkarisht i koordinojnë të gjitha punët dhe përbëjnë një trekëndësh barabrinjës.

-Ibrahim Kelmendi e Jusuf Gërvalla njihen me Tezat e OMLK-së në qershor 1981, por nuk kanë kohë me u marrë me to në kulmin e organizimit të demonstratave,

-Se Ibrahim Kelmendi është i njoftuar për të gjitha punët që Jusufi i bënë për OMLK,

-Se Ibrahim Kelmendi, Jusufi e Kadriu, në gusht të vitit 1981, janë për bashkim në të gjitha detajet, por është insistimi i Jusufit që çështja e bashkimit të bëhet përmes Sabri Novosellës në Turqi,

-Pas prishjes së raporteve të Lëvizjes së Jusufit me OMLK-së në mesin e tetorit 1981, që zgjatë, sipas I. Kelmendit deri në dasmën e Kadri Zekës, Ibrahim Kelmendi është neutral, është në qendër, në mes Jusufit e Kadriut, në pritje të bashkimit të të gjithëve, i pajton Jusufin e Kadriun në dasmë dhe në dasmën e Kadri Zekës e Saime Isufit, Jusufi distancohet përfundimisht nga Sabri Novosella.

Këto gënjeshtra i kam zbërthyer e demaskuar në librin tim Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe libra tjerë.

Jusufi Gërvalla merr vendimin për njohjen e azilit politik në Gjermani më 13 prill 1981, do të thotë prej 13 prillit 1981 ka të drejtë të ketë pasaportë udhëtimi.

Jusufi nuk ka kurrfarë marrëdhëniesh me Ibrahim Kelmendin, pas daljes së numrit të fundit të Bashkimit, të janarit 1981. Nuk shkëmben asnjë letër të vetme me Ibrahim Kelmendin gjatë vitit 1981. Nuk e *fton* asnjëherë në shtëpi të vetë as kur e ka Kadri Zekën mysafir e as kur nuk e ka, dhe nuk ia thotë asnjë fjalë të vetme rreth angazhimit të tij në revistën Liria. Të gjitha rrethanat rreth Jusufit, pas janarit 1981, janë rrethana që i ka mësua në atë formë që mund t'ia ketë përcjellë Kadri Zeka, janë rrethana që i ka mësuar nga Faridin Tafallari, dhe nga një shkrim i imi i botuar në librin e parë të Faridin Tafallarit. Të vërtetat që i mëson nga librat e Faridinit, i vjedhë, i kopjon, i ndryshon dhe si gënjeshtra mundohet sendet e vjedhura, të shndërruara në gënjeshtra me i shitë si origjinale, si rrethana që i ka ditë më 1981 falë "faktit se ka qenë shoku më i ngushtë" i Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla, gjatë vitit 1981, nuk diskuton kurrë me Ibrahim Kelmendin, si person **jashtë** Lëvizjes së tij për Sabri Novosellën. Por, me Sabri Novosellën, si person **brenda** Lëvizjes së tij, i diskuton në hollësi raportet që i ka pas me Ibrahim Kelmendin, prej njohjes (janar 1980) e deri në ndërprerjen e gjitha marrëdhënieve (janar 1981). Kjo do të thotë se e vërteta e raporteve të Jusufit me Ibrahim Kelmendin, e vërteta e *unitetit* të tyre mund të mësohet vetëm nga letrat që Jusufi ia dërgon Sabri Novosellës.

Ibrahim Kelmendi, pas 30 apo 35 vitesh, ulëron e mallkon rreth përmbajtjes së letrave, *e raporteve të stilit policor* të Jusufit dërguar Sabriut. Jusufi nuk bën kurrfarë gabimi në letrat e tij për Sabriun. Ai nuk ka qenë në organizatë me Ibrahim Kelmendin, nuk ka pasur kurrfarë kontrate, marrëveshje me te, për me i marrë leje se kujt me i shkrua e kujt mos me i shkrua, kujt çka me i shkrua e kujt çka mos me i shkrua.

3-2. Të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin i kam ndërprerë

Jusuf Gërvalla: "*Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."*(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

3-3. Bashkëpunimi me Ibrahim Kelmendin ka shkuar përmes Kadri Zekës

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem*

pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...

Shokët e Vjenës (të Ambasadës Shqiptare -shën i Xh. D.) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

*Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (*Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

Marrëdhëniet e ndërprera të Jusufit me Ibrahim Kelmendin, që përmenden në letrën e 13 majit 1981, ripërsëriten në raportin e 31 korrikut.

Çka do të thotë kjo? Se marrëdhëniet e ndërprera pas numrit të fundit të Bashkimit (janar 1981) vazhdojnë të jenë të ndërprera deri në fund të korrikut 1981 pa shenjën të vogël se ka gjasa të ndryshojnë. Fjalët ”*Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë",* janë shumë informative.

Gjatë organizimit të demonstratave bashkëpunimi i Jusufit me Ibrahim Kelmendin ka shkuar përmes Kadri Zekës. Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjmë me ndonjë trekëndësh barabrinjës, por vetëm me një segment, me një vijë të drejtë, në dy skajet e së cilës janë Jusuf Gërvalla dhe Ibrahim Kelmendi, ndërsa në qendër është Kadri Zeka. Pra Jusufi, bashkëpunon e komunikon me Ibrahim Kelmendin vetëm e vetëm përmes Kadri Zekës. Nga kjo rrjedh se Jusufi ia jep Kadri Zekës rolin e qendrës, ndërmjetësuesit, dhe këtë rol që ia jep Jusufi - Kadriut, Kadri Zeka e pranon, dhe këtu nuk ka asgjë të keqe. Ky ka qenë realiteti. Por Jusufit nuk i intereson aspak raporti i Kadri Zekës me Ibrahim Kelmendin dhe kurrë një jetën e vetë nuk i kërkon ndihmë Kadri Zekës për me i ndihmua me e pajtua apo me i evitua “keqkuptimet” e tij me Ibrahim Kelmendin.

3-4. Mercenari i mercenarit

Edhe letra e mëposhtme dhe shprehjet e saj tregojnë se nuk ka kurrfarë ndryshimesh të Jusufit ndaj Ibrahim Kelmendit gjatë muajit gusht 1981.

Jusuf Gërvalla: "*Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t’i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre,* ***pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

3-5. Korrigjimi i vockël i gënjeshtrës së madhe të gënjeshtarit të madh

Xhafer Durmishi: ”*Shtator 1981: Dalin Tezat rreth Frontit për Republikë, të OMLK-së.*” (Kronologji, maj 1992, 1997)

Ibrahim Kelmendi: ”*Shfrytëzoj rastin ta falënderoj Z. Durmishi për këtë kronologji. Një korrigjim i vockël: **Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës, të hartuara nga OMLK, na janë ofruar nga Kadri Zeka qysh gjatë gershorit 1981**, me shpjegim se bisedimet në Kosovë janë pamundësuar për shkak të burgosjeve të mëdha dhe gjendjes se jashtëzakonshme.*” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 317)





TAKIMI I FUNDIT ME VËLLANË - DËSHMORIN REXHEP MALA

Në shtator të vitit 1981, me vendim të Kadri Zekës, Hasan Mala ishte nisur për në Kosovë, ilegalisht, për ta dërguar gazetën "Liria", përmbledhjen e njohur "Këngët e lirisë" dhe literaturë

71

tjetër të ndaluar. Paraprakisht me Kadri Zekën kishin shkuar në Munih për t'u takuar me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, të cilët si bashkudhëtar ia caktojnë veprimtarin Haxhi Berisha. "Deri në kufirin ish-jugosllav na kanë përcjellë Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Pastaj unë dhe Haxhiu kemi vazhduar rrugën me tren nga Lubjana, nëpër Mal të Zi dhe kemi dalë te Kulla e Zhlebit. Me vete kishim 1400 copë të gazetës "Liria", "Këngët e lirisë" dhe shumë libra. Aty kanë dalë shokët me veturë, e kanë marrë materialin dhe ne e kemi vazhduar rrugën, ashtu siç kemi mundur e ditur. Më vonë kam mësuar se ata tre shokë, që kishin dalë për të na pritur, ishin: Nezir Myrtaj, Naim Salihu dhe Selim Selimi. Pas këtij aksioni, që u krye me sukses, më thirri Hydajet Hyseni, i cili ma kishte përgatitur një valixhe, ku i kishte futur Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Po këtë ditë kisha vendosur ta vizitoja vëllanë, Rexhepin, në Burgun e Zenicës, e pastaj ta vazhdoja rrugën për mërgim. Nuk ishte e lehtë, por vendimi i shokëve duhej të zbatohej. U bë si u bë, u nisa dhe shkova te Rexha për vizitë në burg. Ky ishte takimi i fundit me të. E shikova në sy dhe zemra ma ndjeu se nuk do ta shija më. U ndamë me zemër të pikëlluar. Shkova, e mora valixhen ku e kisha lënë dhe u ktheva në Zvicër bashkë me "Tezat e Frontit Popullor". Kur shkova te Kadriu, në St. Gallen, aty kishte qenë edhe Jusuf Gërvalla", - tregon për herë të parë Hasani.

Teksti nga libri i Ismet Rashitit (faqe 71-72) lexohet me lehtësi nëse i rrisni germat

Ismet Rashiti: ”***Në shtator të vitit 1981**, me vendim të Kadri Zekës, Hasan Mala ishte nisur për në Kosovë, ilegalisht, për ta dërguar gazetë ”Liria”, përmbledhjen e njohur ”Këngët e lirisë” dhe literaturë tjetër të ndaluar. Paraprakisht me Kadri Zekën kishin për t’u takuar me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, të cilët si bashkudhëtar ia caktojnë veprimtarin Haxhi Berisha. ”Deri në kufirin ish-jugosllav na kanë përcjellë Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Pastaj unë dhe Haxhiu kemi vazhduar rrugën me tren nga Lubjana, nëpër Mal të Zi dhe kemi dalë te Kulla e Zhlebit. Me vete kishim 1400 copë të gazetës ”Liria”, ”Këngët e lirisë” dhe shumë libra. Aty na kanë dalë shokët me veturë, e kanë marrë materialin dhe ne e kemi vazhduar rrugën, ashtu siç kemi mundur e ditur. Më vonë kam mësuar se ata tre shokë, që kishin dalë për të na pritur, ishin: Nezir Myrtaj, Naim Salihu dhe Selim Hyseni. Pas këtij aksioni, që u krye me sukses, më thirri Hydajet Hyseni, i cili ma kishte përgatitur një valixhe, ku i kishte futur Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Po këtë ditë kisha vendosur ta vizitoja vëllanë, Rexhepin, në Burgun e Zenicës, e pastaj ta vazhdoja rrugën për mërgim. U bë si u bë, u nisa dhe shkova te Rexha për vizitë në burg. Ky ishte takimi i fundit me të. E shikova në sy dhe zemra ma ndjeu se nuk do ta shihja më. U ndamë me zemër të pikëlluar. Shkova, e mora valixhen ku e kisha lënë dhe u ktheva në Zvicër bashkë me ”Tezat e Frontit Popullor”. Kur shkova te Kadriu, në St. Gallen, aty kishte qenë edhe Jusuf Gërvalla” – tregon për herë të parë Hasani.”* (Rrëfanë lirie, Prishtinë 2010, faqe 71-72)

3-6. Jusuf Gërvalla e konsideronn Ibrahim Kelmendin të painformuar

Letra e parë dhe e vetme që Jusufi ia dërgon Ibrahim Kelmendit, pas bashkëpunimit të tij me te gjatë vitit 1980, është letra e 15 janarit 1982.

Çdo fjali e letrës është tejet e rëndësishme.

Jusufi në dasmën e Kadri Zekës e Saime Isufit është gjaknxehtë, për shkak të gjesteve e veprimeve të Kadri Zekës. Shumë sende që ka meritua me ia thënë Kadriut, me gjaknxehtësi, Jusufi, pa të drejtë ia thotë Ibrahim Kelmendit.

Pastaj vazhdohet me fjalët "*Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave."*

Pse Ibrahim Kelmendi është i painformuar **më 15 janar 1982**, për diskutimet rreth bashkimit që janë bërë në muajt gusht, shtator e tetor 1981. Ekzistojnë disa shkaqe.

1. Përgjigja është, sa i përket anës së Jusufit, e dhënë në hollësi në letrat që ia dërgon Sabri Novosellës gjatë vitit 1981. Jusufi nuk ka marrëdhënie me Ibrahim Kelmendin pas numrit të fundit të Bashkimit. Bashkëpunimi i Jusufit me Ibrahim Kelmendin, prej organizimit të demonstratave në Perëndim, ka shkuar përmes Kadri Zekës, dhe kjo formë zgjatë jo vetëm deri në korrik1981, por gjer në vdekje.
2. Gjatë pranverës dhe verës së vitit 1981, Jusufi i jep bindjet e tij të bazuara se në Qendër të Frontit të Kuq mund të qëndroj UDB-a, dhe nuk e merr mundin më të vogël me e bashkua Lëvizjen e vetë me Frontin e Kuq.

3. Iniciativa për bashkim, me shkrim, në bazë të Tezave të OMLK-së, në shtator 1981, ka ardhë prej OMLK-së, prej Kadri Zekës, me të cilin Ibrahim Kelmendi ka qenë në kontakt, pa kurrfarë ndërmjetësimi të Jusufit. Jusufi nuk është përzier në punët e brendshme të Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit dhe relacionit të tyre. Qëndrimi i Jusufit ka qenë se është punë vetëm dhe vetëm e Kadri Zekës t'ia komunikoj Tezat dhe të diskutoj për to me Ibrahim Kelmendin dhe me të gjithë aktivistët tjerë në kontakt. Edhe Kadri Zeka kur ia jep Tezat Jusufit, dhe kur i ka bërë diskutimet për bashkim, nuk e ka përzie Ibrahim Kelmendin. Jusufi është marrë vetëm me Kadri Zekën dhe OMLK-në, dhe ka pritë prej Kadri Zekës interpretimin e Tezave, punë të cilën ai para Jusufit nuk ka guxuar ta bëjë.
4. Jusufi nuk i ka shtrua kurrfarë kushtesh Kadri Zekës sa i përket Ibrahim Kelmendit: As nuk i ka thënë: pa Ibrahimin e Frontin e Kuq nuk ka bashkim, as nuk ia ka thënë të kundërtën, nëse është i përfshirë Ibrahim Kelmendi në këtë punë, nuk ka bashkim me mua. Pasi iniciativa ka qenë prej OMLK-së qëndrimi i Jusufit ka qenë që negociatat me të gjithë të tjerët, e jo vetëm me Ibrahim Kelmendin, fillimisht, duhet t'i zhvilloj vetëm OMLK si inciatore, ta bëjë prezantimin e ideve të veta para të gjitha organizatave me të cilat do të vendoseshin kontakte. Puna e Jusufit ka qenë të përgjigjet vetëm e vetëm për një raport, vetëm për një lidhje, atë LNÇKVSHJ - OMLK, dhe jo për lidhjet tjera të OMLK-së. Ky ka qenë principi fillestar i Jusufit. Në mvarshmëri të suksesit të hapit të parë do të analizoheshin e bëheshin hapat tjera nga organizata e bashkuar. Por siç dihet, gjithçka ka dështuar, sa i përket Lëvizjes së Jusufit e OMLK-së në hapin e parë.
5. Jusufi e nis vëllaun e tij Bardhosh Gërvallën në udhëtim në Turqi në mesin e tetorit 1981 për çështje të bashkimit të organizatave pa e informua dhe pa i marrë leje Ibrahim Kelmendit, dhe ka shpresua për një bashkim, pa i marrë leje Ibrahim Kelmendit, ndaj të cilit nuk ka pasur asnjë detyrim e asnjë obligim.
6. Nuk ekziston asnjë fakt se Kadri Zeka i ka marrë leje Ibrahim Kelmendit për me shkua me Bardhosh Gërvallën në Turqi. A e ka informua se do të shkoj apo jo, nuk e di. Ajo

ka qenë punë vetëm e vetëm për te dhe jo për mua apo Jusufin. Por kur u kthye Kadri Zeka nga Stambolli, nuk është kthye në Zvicër por ka shkua në Gjermani tek Ibrahim Kelmendi. Kadri Zeka, në kundërshtim me të gjitha rregullat etike dhe konventat ndërkombëtare, nuk ka mbajt zi (për një afat sa e parasheh ligji) për dështimin e bisedimeve me Lëvizjen e Jusuf Gërvallës, dhe ditën e nesërme pas kthimit nga Stambolli, më 17 tetor 1981, në panairin e librit në Frankfurt, ai (Kadriu) gojarisht i ka tregua Jusufit se është bashkuar me Ibrahim Kelmendin.

7. Jusufi nuk është mërzit aspak për bashkimin e Kadri Zekës me Ibrahim Kelmendin, pasi vetë Lëvizja e tij ka zhvillua bisedime me OMLK-në pa Ibrahim Kelmendin. Nëse për Jusufin ka qenë e lejueshme të bashkohet me Kadri Zekën pa lejen e Ibrahim Kelmendit atëherë duhet të jetë e lejueshme edhe për Ibrahim Kelmendin të bashkohet me Kadri Zekën pa lejen e Jusufit. Por Jusufi është revoltuar nga fushata e shpifjeve dhe gënjeshtrave kundër tij, nga ana e Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit.
8. Jusufi nuk është marrë me interpretimin e Tezave para Ibrahim Kelmendit dhe Kadri Zekës, si gënjen Ibrahim Kelmendi. Pas interpretimit të tyre të parë dhe të fundit nga ana e Kadri Zekës para Sabri Novosellës e Bardhosh Gërvallës në Stamboll, në mesin e tetorit 1981, këto Teza, në shtëpinë e Jusufit përfundimisht e përjetësisht kanë përfundua në shportën e mbeturinave.

Në dasmë nga biseda në gjaknxehtësi me Ibrahimin Jusufi e kupton se Ibrahim Kelmendi për shumë gjëra është i painformuar prandaj edhe i shkruan: ”*Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë.”*

3-7. Njerëzit e gënjeshtrave Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi

Më poshtë është letra e plotë e Jusufit për Ibrahim Kelmendin.

I dashur shok Ibrahim! *15 janar 1982*

Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejt ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë, mbase nuk kam pasur. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një shoku, që, të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizata revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë.

Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s’më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij.

Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S’ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin ”antikomunist” të atij shokut të

Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z.

Tani po e kupton se unë hyra shumë thellë në punë që s'janë të miat, në punë tuaja të brendshme. Prandaj, nuk shkoj dot më tej. Dëshiroj që ana jonë këndej të jetë e gabuar dhe juve t'ju shkojë puna për së mbari deri në arritjen e fitores. Ne s'ndiejmë frikë as kemi dëm nga cilado forcë me të vërtetë patriotike e revolucionare e popullit tonë. Përkundrazi, atë kërkojmë si qorri sytë dhe ajo na bënë të mburremi. Por kemi një çikë ndruajtje se punës i është zënë jo fort mirë peta.

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta.

Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu. Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë. Me këtë rrugë, për të njejtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z., megjithqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon.

Të fala vëllazërore e revolucionare
J.G.

Pse i përdorë Jusufi fjalët e mëposhtme:

"Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, ***njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta****."*

I përdorë për të treguar, dy ditë para vrasjes, se Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi janë njerëz të punëve të pavërteta. Njerëzit e punëve të pavërteta janë gënjeshtarë.

Ky ishte pra *uniteti* i Jusuf Gërvallës me Ibrahim Kelmendin prej njohjes e gjerë në vdekje.

4. Uniteti i Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën

4-1. Ndihma e njëanshme e Jusuf Gërvallës për Kadri Zekën

Jusuf Gërvalla ka bashkëpunuar me Kadri Zekën për organizimin e demonstratave në Perëndim në pranverën e verën 1981. Puna e Jusuf Gërvallës për revistën Liria nuk është bashkëpunim, pasi bashkëpunimi nënkupton punën për diçka që është e përbashkët. Revista Liria ka qenë e Kadri Zekës-OMLK-së dhe kurrë e Jusuf Gërvallës. Në librat e mi Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe Jusuf Gërvalla dhe Liria është dhënë në mënyrë të zgjeruar ndihma e Jusuf Gërvallës për Kadri Zekën dhe OMLK-në.

Sa i ka ndihmuar Jusufi – Kadri Zekës për botimin dhe shpërndarjen e Lirisë në Kosovë, marrëdhëniet e tyre kanë qenë të shkëlqyeshme. Çudi e madhe!! Pas ndërprerjes së kësaj ndihme, relacioni prishet. Çudi e madhe!!

Në revistën Liria askund nuk përmendet organizata e Jusuf Gërvallës LNÇKVSHJ dhe asnjë organizatë tjetër pos të vetes, pra OMLK-së. Do të mjaftonte vetëm ky fakt për të treguar se sa shanse për sukses ka pasur iniciativa e OMLK-së për bashkim me të tjerët.

OMLK nuk ka kërkuar bashkim konkret me organizata konkrete. OMLK ka kërkuar vetëm e vetëm bashkimin abstrakt, bashkimin e të gjithëve në Frontin e OMLK-së. Në mesin e fjalisë "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", në këtë përfshirje, të të gjithëve, një "vend nderi" e ka pasë të planifikuar Lëvizja e Jusuf Gërvallës.

Nuk jeni aq budallenj siç paraqiteni sa herë t'ua kërkoj nevoja.

Periudhën e ndihmës së njëanshme të Jusufit për Kadri Zekën e kam shqyrtuar në hollësi në librat e lartpërmendur dhe nuk do ta shtjelloj këtu. Këtu do të merrem vetëm me diskutimet rreth bashkimit.

4-2. Treshja unike

Një ide në godinën e rrenave është se Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka kanë përbër një Treshe të cilët çdo gjë e kanë bërë në marrëveshje me njëri tjetrin, se këta janë një Treshe e rëndësishme "unike" e Lëvizjes Kaçake të Kosovës.

Vrasja e tyre e përbashkët është një rastësi. Nga kjo rastësi gënjeshtarët mundohen të nxjerrin përfundimin logjik se nga rastësia, nga qëllime të papajtueshme, duhet të kalohet në domosdoshmëri "unike" të pastruar nga divergjencat. Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka u kanë takuar organizatave të ndryshme politike. Këtë dallim e ka potencuar Kadri Zeka për së gjalli dhe shokët komunist-hegjemon të Kadri Zekës deri në ditët e sotme. Vëllezërit Gërvalla kurrë nuk kanë qenë anëtarë të Lëvizjes Kaçake të Kosovës. Ata kanë qenë anëtarë të LNÇKVSHJ. Ekziston një garë se pranë kësaj "Treshje unike" cili ka qenë i katërti. Pra nga "Treshja unike" me e ndërtua një Katërshe edhe më "unike".

4-3. DOMINIMI, MEGALOMANIA DHE NDJENJA E EPËRSISË BOSHE

Jusuf Gërvalla: *"Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Ekzistojnë pesë rrugë të ndryshme me të cilët bëhet përpjekja të dëshmohet se Kadri Zeka ka pasur sukses ta ***dominoj me çdo kusht*** Jusuf Gërvallën.

Rruga e parë: Lufta **për ta dominuar** Jusuf Gërvallën direkt nga Kadri Zeka për së gjalli. Ndihmën superiore nga Jusuf Gërvalla, duke e ngritë në nivele më të larta revistën Liria, nga Kadri Zeka, sa ka qenë gjallë, dhe nga shokët e tij atëherë e deri më sot e kanë konsideruar si vepër e një personi inferior, që ka dëshirë të dominohet, të nënshtrohet nga të tjerët. Kjo përpjekje ka pësuar disfatë katastrofale, dhe Kadri Zeka për së gjalli ka pasur rastin ta përjetoj.

Rruga e dytë: Lufta **për ta dominuar** Jusuf Gërvallën si ideolog, përmes Sabri Novosellës. Kadri Zeka nuk pranon bisedime për bashkim me Jusuf Gërvallën edhe pse Sabriu i jep të drejtë Jusufit të zhvilloj bisedime rreth bashkimit, dhe udhëton në Turqi me Bardhoshin, me shpresën se Sabri Novosella nuk do ta kuptoj lojën e OMLK me Frontin. Kur të përkulet e dominohet Sabriu "i paditur", është i obliguar të përkulet e dominohet edhe Jusufi i ditur. Kjo taktikë për **dominim me çdo kusht** dështon përjetësisht.

Rruga e tretë: Lufta **për ta dominuar** Jusuf Gërvallën përmes "dëshmive" gënjeshtrave të shokut të organizatës së Kadri Zekës dhe komunistëve hegjemon - Ibrahim Kelmendit, të shprehura në librin *Atentatet*, librin *Lëvizja* dhe gënjeshtra të shumta në shkrime të shkurta sipas rastit, se gjoja Jusufi i ka thirr Kadri Zekën dhe shokun e tij organizativ

Ibrahim Kelmendin të bisedojnë për bashkimin duke u bazuar në Tezat e OMLK-së. Letrat e Jusufit, fjalët e incizuara të Ibrahim Kelmendit dhe fjalët e Suzana Gërvallës demaskojnë gënjeshtrat se Jusufi i ka thirrë Kadri Zekën e Ibrahim Kelmendin në Shtutgart. Jusufi nuk e ka thirrë as Kadriun e as Ibrahim Kelmendin të vijnë nga Dusseldorfi në Bernhausen e as nga Dusseldorfi në Untergrupenbach, për asnjë punë, për asnjë shkak.

Rruga e katërt: Lufta për ta paraqitur Jusuf Gërvallën **të dominuar** prej Kadri Zekës dhe shokëve të tij përmes Metush Krasniqit, me gënjeshtrat e Selatin Novosellës dhe Hydajet Hysenit. Teknika e kësaj loje në emër të Metush Krasniqit të vdekur, i cili nuk mund të flas nga varri, sa është djallëzore është aq edhe e tejdukshme. Përmes kësaj loje bëhet skema se Jusuf Gërvalla, në pikëpamje hierarkie ka qëndruar në mvarshmëri të Metush Krasniqit dhe ka qenë dora e tij e tahretit politik. Këto ide janë të shtruara në një libër të Selatin Novosellës për Metush Krasniqin (Prishtinë 2011). Në këtë libër në mënyrë direkte aludohet se Metush Krasniqi ka qenë dora e tahretit politik të Hydajet Hysenit dhe shokëve të tij. Duke e vendosur në pozitë inferiore, të përkulur dhe të kërrusur Metush Krasniqin para Hydajet Hysenit, qëllimi është të vazhdohet analogjia se ashtu siç është përkulur Metush Krasniqi para Hydajet Hysenit, në mënyrë edhe më të shprehur është përkulur e kërrusur, i mvaruri nga Metushi - Jusuf Gërvalla para Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla nuk ka pas rol inferior as ndaj Sabri Novosellës, as ndaj Metush Krasniqit, dhe nga as një shoku brenda organizatës së tij, dhe prej asnjë anëtari e provokatori prej organizatave të tjera, anëtarë i të cilave nuk ka qenë kurrë.

Rruga e pestë: Përpjekja e shokëve të Kadri Zekës, pas 20 e 30 vitesh duke i mvesh dialogje e gënjeshtra në gojën e Kadri Zekës për superioritetin e tij të madh, dhe se si ky superioritet, ky dominim, është aprovuar nga i "përkuluri" Jusuf Gërvalla. Me thënë gënjeshtra të panumërta në emër të Kadri Zekës që nuk ka lënë asgjë me shkrim sa i përket çështjeve të bashkimit është punë aq e thjeshtë sa të thuash çfarëdo gënjeshtrash edhe për Metush Krasniqin. Në këtë turr i mvishen gënjeshtra edhe Jusufit se sa i është gëzuar ai rolit inferior, e sa dëshirë të madhe ka pasë që të dominohet nga Kadri Zeka. Jusufi ka vdekur por janë gjallë fjalët e shkruara të tij që e vërtetojnë çdo hap të veprimtarisë së tij, fjalë të cilat gënjeshtarët i dinë përmendsh por asnjëherë në ”simpoziumet shkencore” në Institutin e Prof. Dr. Abdyl Kadollit nuk iu referohen. Jusufi me veprën e shkruar nga dora e tij, me portretet e bëra nga dora e tij do të jet gjallë gjersa të ekzistoj populli shqiptar, do të jetoj deri sa të ka njerëz në këtë botë që luftojnë për liri, dhe lirinë e tjetrit e çmojnë po aq sa edhe lirinë e vetë.

4-4. Ankesa është arma e të mjerit

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë “bashkime” me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

4-5. Kadri Zeka ka një propozim konkret

Jusuf Gërvalla: *"Lidhur me këtë, ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) ka një propozim konkret, të cilin ia kam aprovuar edhe unë, nëse pranon ti: të vijmë së bashku ai e unë te ti dhe ta ndriçojmë po qe e mundur këtë çështje. Fitimi, besoj, do të kish qenë i madh. Ai është një shok i mirë dhe mjaft i pjekur. Por, në qoftë se ti ngul këmbë që nuk duhet t’i hymë fare kësaj pune,*

atëherë ashtu edhe do të bëhet." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

Kjo letër dëshmon se më 16 qershor 1981 Jusufi ka pasaportë udhëtimi, pasi njohja e strehimit politik i ka ardhë më 13 prill 1981. Ideja e kësaj pjese nuk ka nevojë për shumë koment.

4-6. Ambasada turke nuk i jep vizë Jusuf Gërvallës

Jusuf Gërvalla: "*Më lejo tani të informoj për disa çështje tash për tash të rëndësishme.*

Lidhur me takimin tonë doli një pengesë tash për tash e pakapërcyeshme: ambasada turke nuk më jep kurrsesi vizë hyrjeje në Turqi. Me gjasë nuk i japin as atij shokut tjetër, se edhe ai e ka punën si unë. Ne do të provojmë ndonjë lloj intervenimi, por sa duket është e kotë. Prandaj, nga ju andej presim ndonjë propozim se si dhe përmes kujt të organizohet ndonjë kontakt, që do të shpiente kah bashkimi." (Letër Sabri Novosellës, 21 korrik 1981)

Jusufi bënë përgatitje për udhëtim në Turqi por ambasada turke nuk i jep vizë.

4-7. Sabri Novosella e autorizon Jusuf Gërvallën të zhvilloj bisedime me Kadri Zekën

Jusuf Gërvalla: *"Kësaj radhe e kam fjalën konkretisht te autorizimi që më ke dhënë për punë me shokun e „Lirisë“, e veçanërisht të bisedohet me të lidhur me bashkimin e dy organizatave tona. Siç e di, përvoja ime në punë të organizuar ishte e shkurtër dhe unë nuk i di ato hollësi për organizatën tonë, lidhur me të cilat kërkon të informohet shoku i „Lirisë“.*(Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Sabri Novosella i jep autorizim dhe të drejtë Jusufit që të zhvilloj diskutimet rreth bashkimit të LNÇKVSHJ me OMLK-në. Kadri Zeka në fillim të qershorit 1981 ka gatishmëri të udhëtoj me Jusufin në Turqi për t'u takuar me Sabri Novosellën për çështje të bashkimit. Në fund të korrikut 1981, Kadri Zeka nuk ka dëshirë të zhvilloj bisedime me Jusuf Gërvallën por vetëm me Sabri Novosellën.

4-8. KADRI ZEKA DHE SHOKËT E TIJ NUK DUAN BISEDIME PËR BASHKIM ME JUSUF GËRVALLËN

Berat Luzha: "*Edhe pse Jusufi e Kadriu ishin në lidhje të ngushta organizuese dhe në pajtueshmëri të plotë me Tezat dhe për bashkimin e dy organizatave Jusufit i duhej të merrte edhe mendimin e pëlqimin e Sabri Novosellës i cili jetonte në Stamboll. Kështu në Stamboll për t'u takuar me Sabriun në tetor të vitit 1981 kanë udhëtuar Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla."* (Konferencë shkencore për GRK, 8 qershor 2023; youtube 2023)

Komunisti Kadri Zeka dhe shokët e tij komunist nuk dëshirojnë të zhvillojnë diskutime rreth bashkimit me *intelektualin* Jusuf Gërvalla, por vetëm me *proletarin* Sabri Novosella.

Donika Gërvalla: "*Qëllimi i Babit në Gjermani ishte të bashkonte diasporën shqiptare. Këtë qëllim e ndiqte me shumë ngulm, pasion dhe mençuri*." (Duhet thyer heshtjen)

Jusuf Gërvalla: "*Me një fjalë unë shoh një disponim të tij (besoj edhe të shokëve të tij) që kjo punë të mos bëhet përmes meje. Dhe u jap të drejtë."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Donika Gërvalla: "*Babai ka qenë shumë i interesuar që të bashkoj të gjitha rrymat shqiptare që ekzistonin në atë kohë në emigracion*." (Intervistë për Agron Bajramin, maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "*Me një fjalë unë shoh një disponim të tij (besoj edhe të shokëve të tij) që kjo punë të mos bëhet përmes meje. Dhe u jap të drejtë."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Donika Gërvalla: ”*Babai ka ardhur në Gjermani pasi u detyrua të lëshonte Kosovën, pasi u detyrua t'i ikte burgimit. Ka ardhë ne Gjermani me një qëllim, që gjithë organizimin shqiptar për Kosovën ta ngrejë në një nivel tjetër. Ai kishte potencialin, si intelektual ashtu edhe njerëzor që t'i bashkonte njerëzit.*” (Intervista e Donika Gërvallës në Koha TV, dhënë Agron Bajramit, 18 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "*Me një fjalë unë shoh një disponim të tij (besoj edhe të shokëve të tij) që kjo punë të mos bëhet përmes meje. Dhe u jap të drejtë."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

4-9. NUK I KANË SHTRUAR HOLLËSISHT E ME SHKRIM ATO QË DUAN TË DINË E QË KËRKOJNË

Jusuf Gërvalla: "*Nga ana tjetër, ata ende nuk i kanë shtruar hollësisht e me shkrim ato që duan të dinë e që kërkojnë. Mendimi i tyre, për sa e shoh unë, është se do të duhej të takoheshe ti, ose ndonjë shok tjetër nga më të rëndësishmit e Lëvizjes në atdhe, me ndonjë shok të njëjtit nivel, po në atdhe, nga ata të „Lirisë“. Kjo më duket edhe mua e drejtë. Dhe ndoshta vetëm në këtë drejtim do të mund të kontribuonim në këtë moment unë dhe ai shoku i „Lirisë“.* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Çka mund të kuptohet më tepër nga kjo pjesë e letrës? Mund të kuptohet, se, edhe pse *TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS* të OMLK-së, të hartuara në maj 1981, në fund të korrikut 1981 Jusufi nuk din për ekzistencën e tyre. Pse Jusufi nuk din për ekzistencën e tyre? Sepse në këtë kohë ai është i angazhuar me tërë energjinë në përgatitjen e revistës Liria dhe shpërndarjes së saj. Pra punët për OMLK shkojnë shumë mirë dhe atyre nuk u ngutet në asnjë pikë me ia tregua *Tezat* Jusufit. Sikur Jusufi t’i kishte parë Tezat në këtë kohë, ai nuk do ta përdorte fjalinë: *Nga ana tjetër, ata ende nuk i kanë shtruar hollësisht e me shkrim ato që duan të dinë e që kërkojnë.*

Vetëm pas njoftimit me Tezat në shtator 1981, Jusufi konsideron se ato janë një bazë e mjaftueshme për fillimin e bisedimeve, të cilat zhvillohen në mesin e tetorit në Stamboll dhe përfundojnë brenda disa minutash.

4-10. NJERI I PËRSHTATSHËM, BIE FJALA XHAFER DURMISHI APO BARDHI

Jusuf Gërvalla*: "Sa për udhëtim deri te ti (se kështu me korrespondencë është e rrezikshme të thuhen hollësitë) do të gjendej ndonjë njeri i përshtatshëm, bie fjala Shpendi (Xhafer Durmishi-shën. im) a Bardhi."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

4-11. Krijimi i teksteve, përparësia dhe obligimi i interpretimeve

Dokumentin *TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS* e ka krijuar OMLK-ja në maj 1981. (Këtë fakt e kam mësuar nga një libër i Mehmet Hajrizit për historinë e OMLK-së). Në shtator 1981 Hasan Mala i sjell nga Kosova këto Teza dhe ia jep Kadri Zekës në banesën e tij në St. Gallen, e ku është i pranishëm edhe Jusuf Gërvalla. Jusufi merr një kopje për të bërë radhitjen-daktilografimin e tyre me makinën e tij. Jusuf Gërvalla i ka radhitur dhe i ka aprovuar në atë mënyrë si i ka interpretuar për vete dhe për mua e Bardhoshin. Por ai ato Teza nuk ia ka interpretuar askujt jashtë Shtutgarti, pasi

puna e interpretimit të tyre ka qenë punë vetëm dhe vetëm e autorëve të tyre, në këtë rast e Kadri Zekës. Tezat nuk janë vepër letrare që t'i jepet mundësia dhe liria që secili t'i interpreton nga shija dhe aftësia e vetë. Ato janë dokument politik dhe ka qenë obligim i OMLK-së, Kadri Zekës që i pari me i interpretua.

Çështja e interpretimit të teksteve dhe kush ka të drejtë të interpretoj tekste është shumë me rëndësi, dhe për të cilën janë zhvilluar lufta në të kaluarën dhe janë baza prej nga burojnë konflikte të përmasave botërore në kohën tonë. Në çështjet kishtare katolike interpretimi i teksteve bëhet nga priftërinjtë dhe në instancën e fundit nga Papa, në bazë të dogmës se Papa është i pagabueshëm. Në rrethanat shoqërore politike edhe pse bëhet përpjekja që tekstet juridike të jenë sa më të qarta dhe pasojat sa më lehtë të parashikueshme, interpretimi i tyre vendimtar bëhet nga gjykatat.

Kadri Zeka nuk ka guxua me i interpretua Tezat, me e interpretua qëllimin e vërtetë të tyre, para Jusufit si ideolog i Lëvizjes Nacionalçlirimtare në shtator 1981. Këto Teza Kadri Zeka i ka interpretuar vetëm para Sabri Novosellës, në Stamboll, në mesin e tetorit 1981, me shpresën se ai si rrobaqepës nuk e kupton përrallën e komunistëve hegjemon dhe pasi nuk e kupton, i përgjumur nga efekti i përrallës, edhe i pranon Tezat duke mos ditur se çka po pranon, dhe vetëm pas përkuljes së Sabriut ta shtroj çështjen e përrallës rreth Tezave me Jusufin si një akt të kryer me arsyetimin: Jusuf, shoku yt udhëheqës i ka pranuar Tezat dhe përrallën e Tezave, prandaj duhet t'i pranosh edhe ti. Thelbi i përrallës së Kadri Zekës rreth interpretimit të Tezave ishte: komunistët duhet të udhëheqin, komunist në Kosovë jashtë OMLK-së nuk ka, komunist në Kosovë jashtë OMLK-së nuk guxojnë të ekzistojnë, prandaj i vetmi shpëtim për çdo aktivist është inkuadrimi në Frontin e OMLK-së.

Këtë përrallë, pas parashtrimit nga Kadriu në disa minuta, Sabriu e zbërthen brenda disa sekondash dhe biseda prishet menjëherë. Këtë përrallë, të cilët komunistët hegjemonë nuk kanë guxua me ia tregua Jusufit, e hedh poshtë edhe Jusufi duke i hedhur *Tezat* në shportën e mbeturinave, pasi kthehet nga panairi i librit në Frankfurt, në tetor 1981, dhe i jep mendimet e tij në një letër që ia dërgon Sabri Novosellës më 5 nëntor 1981.

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

4-12. Metush Krasniqi pranon të dominohet nga komunistët hegjemon

Selatin Novosella: *"Metush Krasniqi pajtohet me Tezat rreth Frontit për Republikën e Kosovës."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 179)

Sabri Novosella: *"Tani lexojmë shkrime nga Hydajet Hyseni, Selatin Novosella etj. Gënjeshtra të turpshme që e fyejnë rëndë Metush Krasniqin se gjoja i paska pranuar tezat komuniste të organizatës Marksiste-Leniniste të ashtuquajturat "Tezat e frontit popullor" që do të udhëhiqej nga komunistët – OMLK."* (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 189-190)

4-13. Metush Krasniqi nuk kundërshton të dominohet nga komunistët hegjemon

Hydajet Hyseni: *"Baca Metush nuk i kishte kundërshtuar Tezat rreth Frontit për Republikën e Kosovës."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 294)

Sabri Novosella: *"Tani lexojmë shkrime nga Hydajet Hyseni, Selatin Novosella etj. Gënjeshtra të turpshme që e fyejnë rëndë Metush Krasniqin se gjoja i paska pranuar tezat komuniste të organizatës Marksiste-Leniniste të ashtuquajturat "Tezat e frontit popullor" që do të udhëhiqej nga komunistët – OMLK."* (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2012, faqe 189-190)

4-14. Hydajet Hyseni për Metush Krasniqin-Dajkocin dhe Dajën Sejdë

Hydajet Hyseni: *"Daja Sejdë dhe Metush Krasniqi ishin shokë të ngushtë. Ishin shokë të rinisë, shokë të punës dhe shokë të idealit. Dhe jo vetëm kaq. Pas vdekjes së gruas së parë (mbesës së Lotë Vakut, Pashies), dhe pas lirimit nga burgu i parë, Daja Sejdë ishte martuar me motrën e Metush Krasniqit, Izushen, një grua shumë e pashme dhe jashtëzakonisht e njerëzishme e bujare*." (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 281)

Hydajet Hyseni: *"Metush Krasniqi ishte njeriu më i nevojshëm dhe më i përshtatshëm i një bashkimi të gjerë."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 292)

Hydajet Hyseni*: "Me atdhetar kolos si Baca Metush, do ta bashkonim Lëvizjen Çlirimtare Kombëtare."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 298)

Hydajet Hyseni: "*Emri dhe vepra e Metush Krasniqit janë gur i rëndësishëm në themel të të arriturave të realizuara deri më tash dhe do të jenë edhe në themelin e realizimeve tjera që do të sjellë e ardhmja."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, faqe 301)

5. Loja e pahijshme Kadri Zekës dhe shokëve të tij me personin e Jusuf Gërvallës

5-1. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
5-2 ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR
5-3. Epërsia boshe si privilegj ekskluziv i kokave boshe
5-4. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË
5-5. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E KADRI ZEKËS DHE SHOKËVE TË TIJ
5-6. Këtë mendim e kanë plotësisht Xhafer Durmishi dhe Bardhoshi

5-1. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit

Selatin Novosella: *"Duke qenë ndër udhëheqësit e nivelit më të lartë të LNÇKVSHJ-së, duke mbajtur lidhjet me Metush Krasniqin në Kosovë e Sabri Novosellën në Turqi, nga njëra anë: duke qenë mik i afërm me Hydajet Hysenin në Kosovë dhe Kadri Zekën në diasporë, si udhëheqësit më të lartë të OMLK-së, nga ana e dytë ... Jusuf Gërvalla, kështu do të shndërrohet në faktor koheziv dhe të pazëvendësueshëm."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 147-148)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk kam çfarë të komentoj këtu. Vazhdoj të kem keqardhje për "shoqërimin" e JG me SN, rrjedhimisht për raportet: epror (SN), vartës (JG)."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 260)

Jusuf Gërvalla: ***"Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.***

Ka disa muaj që unë po fluturoja nga gëzimi, në pritje të bashkimit të forcave tona revolucionare, që isha bërë gati ta quaja bashkim historik. Më herët të kisha dërguar një letër

dhe të kisha thënë se këtë bashkim unë vetë nuk e shoh çështje aq të thjeshtë. ***Ka probleme parimore për të cilat duhen marrëveshje serioze, siç është ai se a duhet të kemi fare parti k.m.- l., (komuniste marksiste-leniniste - shën i Xh. D.) apo ajo parti është e domosdoshme për t'i dalë në ballë popullit tonë në drejtim të luftës dhe të fitores. Ky ishte për mendimin tim problemi kyç.*** *Meqë me Organizatën e shokëve të "Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare dhe të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka. Për veten time, në shërbim të kësaj çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e shokut me shokun, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa besë dhe me grushtin të bashkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-274)

5-2. ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR

Hydajet Hyseni: *"Atëherë e quanim edhe një organizim pararojë dhe një lloj armature e bashkimi gjithëpopullor. Synohej kështu një ndërlidhje e brendshme strukturale dhe funksionale dhe jo farë hierarkie organizimesh, siç ishte kuptuar e interpretuar aty-këtu dhe kjo i kishte krijuar vështirësi Jusufit me shokë. Jusufi dhe Bardhoshi e kishin përqafuar këtë skemë organizimi dhe sipas asaj që na kishte thënë Kadriu, ishte pikërisht Jusufi që kishte insistuar që Kadriu të shkonte dhe të punonte, së paku një kohë, me bërthamën prej pesë anëtarësh që kishte krijuar Jusufi sipas këtij koncepti të organizmit."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Thelbi i përrallës së Kadri Zekës rreth interpretimit të Tezave ishte: komunistët duhet të udhëheqin, komunist në Kosovë jashtë OMLK-së nuk ka, komunist në Kosovë jashtë OMLK-së nuk guxojnë të ekzistojnë, prandaj i vetmi shpëtim për çdo aktivist është inkuadrimi në Frontin e OMLK-së.

Jusuf Gërvalla*: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.*

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka-shën im)" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

5-3. Epërsia boshe si privilegj ekskluziv i kokave boshe

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët****. Kam dëshirë të*

madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.

***Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim**. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim e satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

5-4. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË

Jusuf Gërvalla: ***"**Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën. **Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

5-5. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E KADRI ZEKËS DHE SHOKËVE TË TIJ!

Berat Luzha: *"Megjithatë ishte mendimi i Kadri Zekës se ky bashkim do të arrihej në të ardhmen, duke pasur parasysh se Jusuf Gërvalla ishte pajtuar me përmbajtjen e Tezave për Republikën e Kosovës, dhe bisedat në mes të Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës, do të rezultonin me bashkimin që ishte imperativ i kohës."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 190)

Jusuf Gërvalla*: "(**Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre**, kur nuk dhanë asnjë shenjë! Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)*

*Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. **Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

5-6. Këtë mendim e kanë plotësisht Xhafer Durmishi dhe Bardhoshi

Jusuf Gërvalla*: "Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi (Xhafer Durmishi - shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla - shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 275)

6. Organizimi i festimit të 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart

Ibrahim Kelmendi: *"Sa për Kadriun, Jusufi nuk do të merrte pjesë (në dasmë-shën. i Xh. D.). Me të ishte hidhëruar që nga tetori."* (Atentatet, f.308)

Jusuf Gërvalla: "*Tani të njoftoj se bashkë me shokun e „Bashkimit" dhe të „Lirisë" kemi vendosur të organizojmë një manifestim qendror për kremtimin e festës kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit në Shtutgart. Do të mblidhemi nja 300-400 veta nga Gjermania, Zvicra e Belgjika. Një pjesë e shokëve do të shkojnë për festë në Vjenë.*" (Letër Sabri Novosellës, 16 nëntor 1981; Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 1 tetor 2013)

Ibrahim Kelmendi: *"Informim për një bashkëveprimtari rutinë, do të thosha. Por, e solla si shembull për të plotësuar mozaikun kohor, se nuk kemi qenë të armiqësuar ndonjëherë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 58)

Raportet e kësaj kohe shihen mirë në letrën e 5 nëntorit 1981, pa përjashtuar këtë të 16 nëntorit, të dyja dërguar Sabri Novosellës, dhe raportet vulosen me letrën që Jusufi ia dërgon Kadri Zekës më 7 dhjetor 1981.

Ideja që festa 28 Nëntorit i vitit 1981 të organizohet në Shtutgart, së bashku me aktivistët Zvicrës, Gjermanisë e Belgjikës, ka qenë e Kadri Zekës. Poashtu në bazë të planit të Kadri Zekës bëhet ndryshimi. Vetëm aktivistët e Zvicrës vijnë Shtutgart, kurse atyre në Dusseldorf u thuhet ta bëjnë organizimin ata vetë.

Pse Kadri Zeka merrë iniciativën dhe bënë marrëveshje me Jusufin për festimin e 28 Nëntorit në Shtutgart? Ai e bënë këtë me të vetmin qëllim, për ta përgatitë terrenin për një dokument me titull "Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!" të OMLK-së sipas të cilit të gjitha organizatat janë bashkuar në Frontin e OMLK-së. Me këtë organizim Kadri Zeka mendon t'i thotë Jusufit: bashkatdhetarët na kanë pa bashkë në festën e 28 Nëntorit. Nga kjo rrjedhë, vërtetohet se është bërë bashkimi i të gjithëve në Frontin e OMLK-së.

Jusuf Gërvalla: "*Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike e revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e "politikës së madhe", lojën e arrivizmit revolucionar,* ***të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë****, dhe ato që janë organizuar prej elementësh të dyshimtë e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit, i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar."* (T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS, fjalim i lexuar në mbrëmjen festive të 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart)

6-1. THEMELI ËSHTË VËNË ME GËNJESHTRA

Ankesa është arma e të mjerit.

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Berat Luzha: **"***Për t'u njoftuar me përfundimet e takimit të Stambollit Komiteti Drejtues i OMLK në tetor të vitit 1981 më ka dërguar mua në Zvicër te Kadri Zeka. Kadriu ka shpjeguar hollësisht për takimin dhe bisedën në Stamboll, posaqërisht për mosarritjen e pëlqimit për bashkimin e organizatave. Kadriu ka shpjeguar edhe për qëndrimet personale të Jusuf Gërvallës i cili nuk kishte asnjë kundërshtim me Tezat as për bashkimin e organizatave. Gjithashtu ai ka theksuar se pavarësisht takimit të Stambollit, Jusufi i kishte premtuar Kadriut se bashkimi i organizatave do të vazhdoj deri në fund."* (Konferencë shkencore për GRK, 8 qershor 2023; youtube 2023)

Më 7 dhjetor 1981, me postë, paradite, ka ardhur tek Jusufi një zarf postal me dy dokumente në te. Njëri ka qenë ftesa personale (me sa më kujtohet), individuale apo familjare për Jusufin, për dasmë dhe tjetri ka qenë një dokument me titull "**Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!",** që në bazë kishte të pavërtetën, pra ishte një lloj testimi se mos këtë të pavërtetë e këtë manovrim po e përbinë edhe Jusufi. Jusufi po atë ditë, në praninë time i shkruan këtë përgjigje Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla: "*Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

6-2. MOS U HABITNI NËSE NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E GËNJESHTRAVE

Ankesa është arma e të mjerit.

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Jusuf Gërvalla: *"Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se* ***keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha, me manovrime nga ana juaj.***

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave. (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

7. Dasma e Kadri Zekës me Saime Isufin

7-1. U bë një dasmë e thjeshtë

Saime Isufi*: "Pasi mora këtë vendim, Kadriu në konsultim me shokët, filloi të organizonte një dasmë. U bë një dasmë e thjeshtë, me 'dasmorët' e republikës së Kosovës."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 99)

7-2. Dasma qe tepër modeste

Albana Krasniqi: *(Kadri Zeka) "Më 2 janar 1982 martohet me Saime Isufin, apo Bule Zekën, siç e njohin punëtorët bashkëluftëtaren e tij. Dasma qe tepër modeste. Krushq qenë mërgimtarët me mallin e pashuar për vendlindjen. Ishin mes shokëve dhe idealit të luftës edhe Jusufi e Bardhoshi, Hasani, Fahredini e shumë të tjerë. Disa ditë më pas udhëton për në Gjermani të takohet me vëllezërit Gërvalla. Kishte ardhur koha që grupet në mërgim të bashkohen në një, dhe vetëm ashtu të bashkuar mund t'i prinin luftës bijtë e Kastriotit."* (Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002, faqe 36)

7-3. Gënjeshtra se Jusufi dhe Bardhoshi ishin mysafirët më të nderuar

Hydajet Hyseni*: "E tillë ishte miqësia e tyre gjer në fund. Në dasmën e Kadriut, Jusufi dhe Bardhoshi ishin mysafirët më të nderuar."* (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 118)

Mysafiri më i nderuar nga Gjermania dhe ndoshta në gjithë dasmën ka qenë Ibrahim Kelmendi, me të cilin Kadri Zeka ishte bashkuar në një organizatë, në tetor 1981. Mysafiri më i nderuar prej Kadri Zekës nga rrethi i Shtutgartit ka qenë Faridin Tafallari dhe jo Jusufi dhe Bardhoshi. Kadri Zeka ia jep detyrë Faridin Tafallarit, përmes dy letrave, ta organizoj se kush duhet të shkoj në dasmë nga rrethi i Shtutgartit. Faridin Tafallari nuk e pranon rolin që mundohet me ia dhënë Kadri Zeka dhe shkruan më vonë se organizimi i shkuarjes në dasmë nga rrethi i Shtutgartit është bërë nga Jusufi.

7-4. Gënjeshtra se Jusufi shkon në dasmën e Kadri Zekës si i paftuar

Në gënjeshtrën e mëposhtme, përmbajtja e qartë. Jusufi shkon në dasmë për hatër të dasmorëve dhe jo pse është i ftuar.

I. Kelmendi*: "Viti i Ri 1982 do t'i gjejë të gëzuar Jusufin, Kadriun, Bardhin, Miranin dhe shumë të tjerë. Kadriun sepse ishte bashkuar me Bulen. Të tjerët sepse po u martohej bashkëveprimtari dhe ishin ftuar në dasmën e tyre që do ta bënin, më 2 janar në Zvicër.* ***Por, gëzimi i Jusufit kufizohej pothuajse vetëm në faktin se një shqiptar, i njohur i tij, po martohej, ndërsa ishte në dilemë nëse do të merrte pjesë në dasmë****. Më në fund gjykoi se duhej të merrte pjesë, më shumë për hatër të dasmorëve që ishin kryesisht aktivistë të të njëjtave radhë. Ata dëshironin t'i shihnin udhëheqësit e tyre të bashkuar. Sa për Kadriun, Jusufi nuk do të merrte pjesë. Me të ishte hidhëruar që nga tetori." (Atentatet, f.308)*

Ibrahim Kelmendi: "*Thënë, ndoshta naivisht, unë ndihesha më i çliruar për të nxitur biseda, sepse kohëve të fundit, sidomos në dasmën e Kadriut e Saimës, ushtroja rolin nga pozita e neutralit, ndërmjetësuesit, në mes të Jusufit dhe Kadriut."* (Lëvizja, f.58)

Me pasë dëshirë me u bërë arbitër e refer, ndërmjetës është vetëm pjesa e parë e problemit. Kryesorja është a të pranojnë palët si refer e ndërmjetës. Jusuf Gërvalla kurrë në jetë nuk e ka pranuar shpifësin Ibrahim Kelmendi për ndërmjetës me Kadri Zekën dhe me askend tjetër. E vërteta është se Kadri Zeka ka qenë personi në qendër në mes Jusufit e Ibrahimit.

7-5. Kadriu ishte kujdesur të thërriste dy a tre veta nga secili metropol

Ibrahim Kelmendi*: "Dasmorët vinin nga metropole të ndryshme evropiane. Kadriu ishte kujdesur të thërriste* ***dy a tre veta nga secili metropol*** *ku kishte shqiptarë të angazhuar për veprimtari çlirimtare.* ***Vetëm nga Dusseldorfi ai kishte ftuar më së shumti, gjashtë veta, me Miranin shtatë."*** (Atentatet, f. 308)

Pjesëmarrës të organizuar nga Jusuf Gërvalla nga rrethi i Shtutgartit për në dasmën e Kadri Zekës kanë qenë 17 (shtatëmbëdhjetë) veta (burra, gra e fëmijë).

Çka është e vërteta është pikëpyetje se a ka pas më shumë dasmor vetëm nga nga rrethi i Shtutgarti apo nga krejt Zvicra të marrë së bashku. Ibrahim Kelmendi, ashtu si e redukton numrin e dasmorëve të Shtutgartit nga 17 në 2-3, në të njejtën mënyrë e rritë numrin e dasmorëve nga Dusseldorfi dhe shpikë dasmorë nga metropolet e Evropës, prej të cilave nuk ka qenë asnjë pjesëmarrës.

Gënjeshtrat e Ibrahim Kelmendit për dasmën dhe rolin e Ibrahim Kelmendit në dasmë e vërteton më së miri filmi i dasmës.

Lidhur me dasmën Ibrahim Kelmendi gënjen çdo fjalë që e thotë. Atmosfera në dasmë ka qenë e pakëndshme, për shkak të gënjeshtrës së Kadri Zekës dhe OMLK-së, të shprehur në dokumentin me titull: "Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!" ku thuhej se të gjitha organizatat janë bashkuar në Frontin e OMLK. Atë çka e ka bërë të gjitha organizatat duhet ta bëjnë edhe të gjithë individët – të bashkohen në Front.

Jusufi nuk e pranon këtë gënjeshtër dhe i përgjigjet rreth 7 dhjetorit 1981.

Në nëntor 1981 ka dalë Zëri i Kosovës. Në gepekun e kerrit të Bardhoshit kanë qenë disa ekzemplarë të numrit të parë të *Zërit të Kosovës*. Jusufi ia shprehë idenë Kadri Zekës për t'ua treguar dasmorëve *Zërin e Kosovës*, me arsyetimin se shikimi i *Zërit të Kosovës*, në një dasmë politike të Kosovës është më i arsyeshëm se sa brohoritjet "*Parti Enver jemi gati kurdoherë!"* Kadri Zeka e kundërshton atë ide.. Kadri nuk e ka shpërnda revistën e Jusufit në Zvicër, e ka ndaluar përmendjen, tregimin e ekzistencës së Zërit të Kosovës në dasmë, më 2 janar 1982, ua ka ndaluar shokëve të vetë ta shpërndajnë deri në vdekje.

Përkundër këtyre fakteve, Jusufi kurrë në jetën e tij nuk e ka pranuar Ibrahim Kelmendin (dhe askend tjetër) si ndërmjetës, si refer, si arbitër, si pajtues apo si gjykatës, në punët e raportet e tij me Kadri Zekën, as në momentet kur ato raporte kanë qenë më të mirat e as në ato momente kur ato kanë qenë më të këqijat.

Jusuf Gërvalla kurrë në jetën e tij, do me thënë as në dasmë, e as më 17 janar 1982 në shtëpinë e vetë, nuk e ka pranuar si ndërmjetës, refer, pajtues, avokatë apo gjykatës as Ibrahim Kelmendin e as Kadri Zekën për raportet e tija me Sabri Novosellën, dhe për asnjë punë tjetër të brendshme të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi.

7-6. Përfaqësuesit e të gjitha rrymave dhe organizatave të përçara

"*Më 2 janar 1982 Kadri Zeka u martua me Saime Zekën. Në dasmë ftoi të gjithë shokët dhe miqtë e tij e ndër ta edhe Jusufin e Bardhoshin dhe dasma e tij u bë një lloj kuvendi në të cilin*

u takuan përfaqësuesit e të gjitha rrymave dhe organizatave që deri diku ishin të përçara dhe pritej të shkriheshin në një." (Filmi dokumentar; Ç'ke bërë sot për Kosovën?, janar 1997, minuta 35.00-36.00, 1997)

Hydajet Hyseni*: "Shprehje e frymës gjithnjë e më të fortë të bashkimit dhe në funksion të këtij bashkimi ishte edhe dasma e Kadri Zekës me shoqen e punës dhe luftës ilegale, Saime Isufin, 'Bulen'. Quhej Bule në shembullin e antifashistes Bule Naipit."* (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 141)

Hydajet Hyseni ka aq të drejtë sa asnjë lexues i jashtëm nuk mund ta merr me mend. Së bashku me ftesën për dasmë, ku Jusufi ftohet si individ, Kadri Zeka, ia dërgon një ftesë shumë më interesante, me titullin "Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!" Pra në këtë rast ndodh ajo që quhet; *Një udhë e dy punë*. Jusufi me të njëjtën dërgesë postale, me të njëjtin zarf, ftohet në dasmë si individ dhe bëhet manovrimi që Lëvizja e tij të vihet para aktit të kryer e të futet në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës. Këtë farë "Thirrje për hyrje në Frontin e madh", Kadriu ka dëshirë që vetë Jusufi ta shtyp, radhisë e shpërndaj në rrethin e vetë si postier i tij, të veprojë me te në të njëjtën formë siç kishte vepruar në shtator me Tezat, pra ta bëjë një reprizim të ngjarjeve, sikur takimi i Stambollit të mos kishte ekzistue. Kësaj *Thirrje* Jusufi i përgjigjet: "*Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta."*

7-7. Harapi i Shkodrës dhe *bashkimi* në dasmën e Kadri Zekës

Harapi e injoron avokatin dhe e merr rolin e pajtuesit e referit mbi vete

Fazli Veliu: "*E shoh të arsyeshme të sqaroj se, ky bashkim është arritur më 1 e 2 janar të vitit 1982, në dasmën e Kadri Zekës, në Zvicër, kur të gjithë pjesëmarrësit, krushqit e dasmës ose të lirisë, pas fjalimit të Kadri Zekës, dhanë betimin për bashkim të radhëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo ngjarje e bashkimit shënohet pas rënies së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Badhosh Gërvallës, nga veprimtarët e të gjitha viseve të cilët çonin në vend mesazhet e të rënëve për liri, duke u betuar në veprën e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, në vazhdimin e luftës deri në fitore për çlirim e bashkim kombëtar. Për këto që përmendëm, kemi fakte, shënime drejtpërsëdrejti, incizime dhe filma, të cilët do t'i dorëzojmë te shtypshkronja, kur të botohet libri për këto.*

Autori i këtij punimi pati një bisedë të gjatë, kokë më kokë më shumë se katër orë, me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, më shumë se një orë me Bardhosh Gërvallën poashtu." (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f.199-200)

Fazli Veliu, me banim në Zvicër, dhe shok i Kadri Zekës, ka qenë i ftuar në dasmën e Kadriut dhe Saime Isufit. Jusuf Gërvalla nuk e ka njohur në kurrfarë mënyre Fazli Veliun. Megjithate Fazli Veliu, shok i Kadri Zekës, mundohet ta plasoj veten në qendër, me rolin e pajtuesit, të jetë neutral dhe se gjoja fletë nga pozita të njejta neutrale si me Jusufin si me Kadriun dhe Bardhoshin.

Shokët e Kadri Zekës në Zvicër Fazli Veliun e kanë quajtur Harapi i Shkodrës, me emrin e një personazhi nga drama "Baca i Gjetajve". Në dramën Baca i Gjetajve, Harapi i Shkodrës është këshilltari kryesor i bajraktar Kadrisë. Ka mundësi që Fazli Veliu, si shok i komunistit Kadri Zeka dhe këshilltar i Bajraktar Kadrisë, të ketë kontribuar në unitetin e

bashkimin e tyre, në bashkimin e bajraktar Kadrisë dhe komunist Kadrisë, si në një trup të vetëm.

Nga kjo rrjedh se Fazli Veliu ka mundur ta luaj rolin e qendrës, referit, pajtuesit, vetëm në mes bajraktar Kadrisë dhe komunist Kadrisë, por kurrë në mes Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës. Këtë e tregon më së miri filmi i dasmës.

Rolin e referit, arbitrit, pajtuesit, gjyqtarit në mes Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës përveç Fazli Veliut është munduar ta luaj edhe Ibrahim Kelmendi dhe Abdullah Prapashtica. Suksesi i Fazli Veliut dhe e vërteta e Fazli Veliut është i barabartë me suksesin dhe të vërtetën e Ibrahim Kelmendit dhe Abdullah Prapashticës.

Fazli Veliu (Veliu) e Mustafë Xhemaili (Gjoni): ”*Veprimi i juaj i këtillë, po të mendohet gjakftohtë, do të kuptohet lehtë nga të gjithë se do të sjellë thyerje të unitetit, përçarje dhe ndarje forcash në përmasa të mëdha në popullin tonë dhe LPRK-në, përçarje jashtë dhe brenda. Kjo do të ishte e pashmangshme pasi ne ishim në nivel të punëve në KP dhe LPRK dhe veprimet që u morën ndaj nesh nuk lidhen me punën në KP të LPRK-së,* ***por këto veprime u ndërmorën për përkatësinë tonë në OMLK***. ***Siç dihet, kaherë, OMLK ruan pavarësinë organizative, politike, ideologjike, të agjitacionit dhe të propagandës*** *dhe vepron në kuadër të LPRK-së dhe nuk shkel, por mbron parimet të përcaktuara në tetor të vitit 1985 në Njoftimin Intern të LPRK-së.” (*PËRJASHTIMI I FAZLI VELIUT DHE MUSTAFË XHEMAJLIT NGA KP I LPRK-ës, MË 3 maj1986; pashtriku.org, 21 mars 2025; Faridin Tafallari: Terror, dhimbje, qëndresë 1997, faqet 258 – 259)

(Shënim: Përjashtimi i Fazli Veliut e Mustafë Xhemailit është bërë më 3 maj 1986. Letra e tyre prej nga është marrë citati i mësipërm është e datës 4 maj 1986.)

Fazli Veliu së bashku me rrethin e vetë, nga viti 1985, i kanë dënuar bashkimet e 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, me shpresën se vetë do të krijojnë ndonjë datë më të rëndësishme, e kanë riogranizuar OMLK-në e Kadri Zekës, me qëllim të **DOMINIMIT ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT** dhe e kanë udhëhequr deri në shembjen e Murit të Berlinit. Vetëm pas shembjes së Murit të Berlinit, falimentimit të etiketave marksiste-leniniste, pas 30 vitesh, riorganizuesit marksist-leninistë riorientohen e mundohen të tregojnë rëndësinë e shtëpisë së Jusuf Gërvallës dhe Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

7-8. Avokati i Harapit të Shkodrës

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*

Shokët e Vjenës (të Ambasadës Shqiptare -shën i Xh. D.) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

*Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (*Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

Ibrahim Kelmendi: *"Kohë më parë, në Maqedoni, më ka rastisur të ballafaqohem me materiale të falsifikuara, që ca kriminelë i shpërndanin për "dosje". Ishin sajuar për të diskreditur Ali Ahmetin, Fazli Veliun, Musa Xhaferin, bashkëveprimtarët tanë shumëvjeçarë. Edhe ky "raport" më ngjan me ato falsifikime."* (Bedri Islami, Lëvizja f. 115)

8. Udhëtimi i Kadri Zekës nga St. Gallen në Dusseldorf

8-1. Besimi i krijuar në takimin e parë dhe pabesimi i përjetshëm

Ibrahim Kelmendi: *"– Unë t'u prezantova në prani të Benediktit me emrin Zeqë, por unë në të vërtetë e kam emrin e mbiemrin Kadri Zeka. Jam nga Gjilani, i strehuar politik këtu në Zvicër. Je ndër pak veta që po ta tregoj emrin e vërtetë, por të lutem mos më dekonspiro!"* (Atentatet, f.238)

Ibrahim Kelmendi gënjen se e ka dërgua në Zvicër Jusuf Gërvalla për kontakt me OMLK-në. Gënjeshtra e tij vazhdon me tregimin se Kadriu qysh takimin e parë pasi i prezentohet me emrin Zeqë, brenda bisedës pa u vonuar i tregon emrin e tij të vërtetë, duke iu lutur Ibrahim Kelmendit që të mos e dekonspiroj. Në librin Lëvizja gënjeshtrën e vetë e ndryshon dhe deklaron se edhe pse Kadri Zeka e ka pas shokun më të ngushtë, shumë më të afërm se Hasan Malën e të tjerë në Zvicër, më 17 janar nuk i ka besuar që për së gjalli me ia tregua Ibrahim Kelmendit emrin e tij të vërtetë.

Ibrahim Kelmendi: "*Pastaj i dhashë të drejtë vetes të informoja Jusufin për bisedat që kishim pasur dy ditët e fundit me bashkatdhetarë në Duzeldorf e rrethina, - se ju ka folur kryesisht shoku* ***Zeqë - (meqë emrin e vërtetë, Kadri, nuk ia dija)****"* (Lëvizja, f. 58)

8-2. Albana Krasniqi i demanton gënjeshtrat se Kadri Zeka udhëton për në Gjermani i ftuar nga vëllezërit Gërvalla

Albana Krasniqi: *(Kadri Zeka) "Më 2 janar 1982 martohet me Saime Isufin, apo Bule Zekën, siç e njohin punëtorët bashkëluftëtaren e tij. Dasma qe tepër modeste. Krushq qenë mërgimtarët me mallin e pashuar për vendlindjen. Ishin mes shokëve dhe idealit të luftës edhe Jusufi e Bardhoshi, Hasani,* ***Fahredini*** *e shumë të tjerë. Disa ditë më pas udhëton për në Gjermani të takohet me vëllezërit Gërvalla. Kishte ardhur koha që grupet në mërgim të bashkohen në një, dhe vetëm ashtu të bashkuar mund t'i prinin luftës bijtë e Kastriotit."* (Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002, faqe 36)

Albana Krasniqi, reja e Hasan Malës, shkruan se qëllimi i udhëtimit të Kadri Zekës në Gjermani është takimi me vëllezërit Gërvalla, me qëllim të bashkimit. Ajo e injoron Ibrahim Kelmendin tërësisht dhe nuk ia përmend emrin. Pasi Kadri Zeka nga Zvicra qenka nisur tek vëllezërit Gërvalla me iniciativën e tij, kjo do të thotë se vëllezërit Gërvalla nuk e kanë ftuar Kadri Zekën të vijë as nga Zvicra në Shtutgart dhe as nga Dusseldorfi në Shtutgart. Albana e përmend vetëm një shkak të udhëtimit të Kadri Zekës tek vëllezërit Gërvalla – çështjen e bashkimit.

Saime Isufi*: "****Më 12 janar 1982, Kadriu u nis në*** *Gjermani për të kontaktuar me veprimtarë. Ndër ta edhe me Vëllezërit Gërvalla****.*** *Me vete mori edhe materialet e numrit 6-të të 'Lirisë' për t'i botuar si dhe 'Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës'. Tezat do t'i*

konsultonte edhe me vëllezërit Gërvalla. Numri i 6-të i 'Lirisë' doli pas rënies së Kadriut. Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Edhe Saime Isufi, të vetmit veprimtarë në Gjermani i përmend Vëllezërit Gërvalla dhe e injoron dhe nuk ia përmend emrin Ibrahim Kelmendit, tek i cili Kadri Zeka qëndron 5 ditë. Në citatin e mësipërm ka dy gënjeshtra. Numri 6 i Lirisë ka dalë në dhjetor 1981. Jusufi nuk është marrë me asnjë punë të OMLK-së, në ketë kuptim as edhe me revistën Liria, pas 17 tetorit 1981, e gjer në vdekje. Pas 17 tetorit 1981 e gjer në vdekje Jusufi është marrë vetëm me punët e Lëvizjes së vetë. Edhe Kadri Zeka, në Dusseldorf ka qëndruar tek Ibrahim Kelmendi për organizimin e aktivistëve në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës. Konsultimi i Tezave me vëllezërit Gërvalla ka marrë fund më 15 tetor 1981 në Stamboll dhe 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt, kur Kadri Zeka, qëndrimet e mbajtura në Stamboll para Sabri Novosellës i vërteton edhe para Jusufit.

Citati i mësipërm edhe pse me gënjeshtra i vërteton fjalët e Albana Krasniqit. Pasi Kadri Zeka nga Zvicra qenka nisur tek vëllezërit Gërvalla me iniciativën e tij, kjo do të thotë se vëllezërit Gërvalla nuk e kanë ftuar Kadri Zekën të vijë as nga Zvicra në Shtutgart dhe as nga Dusseldorfi në Shtutgart.

Fjalët e Albanës dhe Saimes e demantojnë gënjeshtrën e Ibrahim Kelmendit se Jusufi i ka lutur Kadri Zekën dhe Ibrahim Kelmendin të vijnë nga Dusseldorfi në Shtutgart.

Xh. D. "Edhe Saime Isufi, të vetmit veprimtarë në Gjermani i përmend Vëllezërit Gërvalla dhe e injoron dhe nuk ia përmend emrin Ibrahim Kelmendit, tek i cili Kadri Zeka qëndron 5 ditë."

Ibrahim Kelmendi: ""*Ja edhe një gënjeshtër ordinere! Vetëm të premten pasdite jam takuar me Kadriun në Dyseldorf dhe atë natë e kemi kaluar se bashku me shoqëri të Klubit "Emin Duraku" (dhe kemi fjetur në banesë të Sylë e Vezire Nuhajt), si përherë, por pa konkretizime të reja organizative."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 88)

8-3. Kadriu kishte planifikuar ta kalonte 17 janarin1982 në Dusseldorf, 640 km në veri nga vendbanimi i tij në St. Gallen të Zvicrës

Ibrahim Kelmendi: "*Të enjten e 14 janarit të vitit 1982 Kadri Zeka erdhi për vizitë në Gjermani, më konkretisht në rrethinë të Dyzeldorfit. Erdhi aty, sepse në këtë krahinë të zhvilluar industriale kishte shumë emigrantë shqiptarë. Por, nuk duhet të ketë qenë ky fakt shtysa kryesore që ai të vinte. Më shumë rol në ardhjen e tij duhet të ketë luajtur gjallërimi i veprimtarisë patriotike dhe çlirimtare, që ishte më e avancuar se në krahina të tjera gjermane dhe në shtete të tjera të Evropës Perëndimore. Ai erdhi edhe sepse donte të më takonte dhe, së bashku, të takonim patriotët e angazhuar të asaj ane.*

Nuk e pyeta se nga erdhi dhe si erdhi, sepse ai praktikonte konspiracion të thellë, i cili ndonjëherë më bezdiste. Natën ndërmjet të enjtes e të premtes e kaluam në Mylhajm/Rur (Mülheim a.d. Ruhr), në familjen e vëllait tim, Mustafës, kurse ditën e premte e kaluam në Dyzeldorf. Edhe emigrantët e angazhuar të Mylheimit dhe të shumë qyteteve përreth Dyzeldorfit, si qendër të angazhimeve patriotike kishin Klubin "Emin Duraku", në Dyzeldorf. Ky klub tashmë ishte afirmuar si vatër kryesore e angazhimeve patriotike të shqiptare në Evropën Perëndimore.

Në Dyzeldorf zumë vend në banesën e Sylë dhe Vezire Nuhajt, nga Malësia e Jezercit të Ferizajt. Aty dhe në vizita të tjera takonim bashkatdhetarë veprimtarë. ***Kadriu kishte planifikuar ta kalonte atë fundjavë në Dyzeldorf****. Aty kaluam natën ndërmjet të premtes e të shtunës së 16 janarit."* (Lëvizja 25-26)

8-4.Kadriu duhej që më 17 janar 1982 të ishte në shtëpinë e vetë 640 km në jug të Dusseldorfit.

Saime Isufi: *"Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Albana Krasniqi e Saime Isufi thonë se Kadriu është nisur tek Vëllezërit Gërvalla me tri detyra: për diskutimin e Tezave, për punën e numrit 6 të Lirisë dhe për çështje të bashkimit. Kadri Zeka prej nisjes nga Zvicra më 12 janar deri më 15 janar nuk shkon tek Vëllezërit Gërvalla. Ibrahim Kelmendi gënjen se me Kadriun është takuar (një herë më 14 janar, herën tjetër me 15 janar 1982). Qëllimi i Kadriut është ta kaloj fundjavën (16 e 17 janar) në Dusseldorf. Nga kjo gënjeshtër rrjedhë se Kadri Zeka me udhëtimin në Gjermani nuk ka pasur kurrfarë plani e as dëshire të takohet me Vëllezërit Gërvalla por vetëm me aktivistët e Dusseldorfit, prej të 12 janarit deri më 16 janar, dhe me Faridin Tafallarin në rrethin e Shtutgartit, sipas fjalëve të incizuara të Ibrahim Kelmendit.

8-5. Të gjithë do të përfshiheshin në Frontin e OMLK-së

I. Kelmendi*: "**Ditën e enjte të 14 janarit**, Kadriu udhëtoi në Krahinë të Ruhrit në Gjermani. **Tani ai po merrej me propagandimin e Tezave të Frontit** për Republikën e Kosovës, meqë mendonte se **të gjithë aktivistët** patriotë se shpejti duhej të përfshiheshin në këtë Front."* (Atentatet, f.315)

Ibrahim Kelmendi dhe Kadri Zeka nga 12-16 janar nuk bisedojnë për çështje organizative. Pa konkretizime të reja organizative.

Ibrahim Kelmendi: ""*Ja edhe një gënjeshtër ordinere! Vetëm të premten pasdite jam takuar me Kadriun në Dyseldorf dhe atë natë e kemi kaluar se bashku me shoqëri të Klubit "Emin Duraku" (dhe kemi fjetur në banesë të Sylë e Vezire Nuhajt), si përherë, por pa konkretizime të reja organizative."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 88)

Sipas Ibrahim Kelmendit, figurës së Frontit të Kuq, emri Fronti i OMLK-së nuk qenka emër konkret.

8-6. Askush nuk do të përfshihej në Frontin e OMLK-së

Ibrahim Kelmendi: *"Emërtimi bazë i organizatës së re qe vendosur të ishte LËVIZJA, edhe për shkak se emërtimin FRONT e kishim konsumuar ne të Frontit të Kuq Popullor."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 183-184)

8-7. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe letrën që ma ka shkruar Jusufi dy ditë para vrasjes, "tra-shëgimtari" Durmishi do me çdo kusht ta zhvlerësojë. Janë shpifje ordinere që i sajonin qysh atëherë zagarët që i vinin vërdallë Jusufit me dezinformime e shpifje të kësaj natyre, e njëri nga ata ishte edhe Xhafer Durmishi.*" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 84 e 85)

Ibrahim Kelmendi: "*Po të ishte në dorën time, asnjëherë nuk do t'i publikoja letrat e raportimet që Jusufi ia ka dërguar Sabri Novosellës në Turqi*." (FaceBook tetor 2017

Ibrahim Kelmendi: ”*Të jam shumë mirënjohës që nuk e pate zhduk atë letër! E pate mundësinë. Jusufi e kishte dërguar si letër rekomandë (të mos ndodhte ta humbisnin postjerët). Pak ditë pas tragjedisë, meqë nuk kam qenë në Bochum, - siç ndodh rëndom me letra rekomandë, - ajo letër është kthye në adresën Tuaj. Atë ditë kur e pranove nga postieri, ju gëzove dhe pate mirësinë të më luteshe për leje që ta hapje e ta lexoje. Po e potencoj edhe njëherë: ke pas mundësinë ta zhdukje, që të mos e kishte mundësinë as* ***Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante.*** *Fatmirësisht ishe e mirësjellshme dhe prandaj nuk e pate zhdukur. Të jam mirënjohës deri përtej Dielli, meqë nuk ka asnjë dëshmi më autentike se kjo letër, që dëshmon marrëdhëniet që kishim mes nesh.”* (Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

Çështjet të cilat shqyrtohen në këtë pjesë (pikat 6-13) i referohen letrës së Jusuf Gërvallës dërguar Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982. Kjo letër është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Jusuf Gërvalla: "*Me bisedën që patëm* ***në dasmë****, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që* ***gjaknxehtësinë*** *time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq* ***gjaknxehtë*** *mbase nuk kam pasur."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufi i thotë I. Kelmendit se në dasmën e Kadri Zekës më 2 janar 1982, është treguar i padrejtë ndaj tij. Pse i padrejtë? Sepse shumë gjëra që Jusufi ia thotë Ibrahim Kelmendit, në të vërtetë i ka merituar dhe kanë qenë të adresuara për Kadriun, por pasi ka qenë dasmë Jusufi nuk mund t'ia thotë atij direkt por ia thotë shokut të tij të organizatës, Ibrahim Kelmendit.
Por, duhet ta kesh kuptuar që ***gjaknxehtësinë*** *time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin* ***nuk kemi pasur*** *kufij.* Në bazë të rregullave gramatikore fjalët ***nuk kemi pasur*** paraqesin një kohë kaluar dhe jo të tashmen. Pra Jusufi mendon në një kohë të kaluar e që nuk kthehet më, që ka perënduar dhe jo për kohën e tashme (pra jo për janarin 1982). Me këtë fjali Jusufi ka parasysh dy periudha nga viti 1980; Shkurt - prill 1980 dhe kohën nga 28 Nëntori 1980 deri më 18 dhjetor 1980, kur Jusufi pa kurrfarë kufizimesh e ndihmon dhe mundëson botimin e gazetës "Bashkimi".

Pse Jusufi është gjaknxehtë? Sepse në këtë kohë Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi zhvillojnë fushatë, nëpër Zvicër e Gjermani kundër Lëvizjes dhe vet Jusufit. Si mund të përmblidhet përmbajtja e kësaj fushate?

- Në përputhje me TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS, është formuar FRONTI POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.
- Të gjitha organizatat në Kosovë i janë bashkuar FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.
- OMLK-ja për këtë qëllim e ka përpiluar dokumentin "THIRRJE - TË GJITHË NË FRONT! TË GJITHË PËR FRONTIN!
- Vetëm Lëvizja e Jusuf Gërvallës nuk po donë me iu bashkua Frontit!
- Vetëm Jusuf Gërvalla ka dalë kundër bashkimit! Pra të gjithë janë për bashkim, vetëm ai është kundër!
- Kjo do të thotë se në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës ka njerëz antikomunist që nuk pranojnë të udhëhiqen nga komunistët!
- Në një organizatë që nuk pranon të udhëhiqet nga komunistët punët qëndrojnë shumë keq!

8-8. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq

Si përgjigje në fushatën e Kadri Zekës, në të cilën është i involvuar edhe Ibrahim Kelmendi Jusufi përgjigjet me fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla: *"Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon **aspak keq**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

8-9. Lojë e pamirë e Kadri Zekës me personin tim dhe organizatën time

Jusuf Gërvalla*: "Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime **të një shoku**, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin **një lojë e pamirë**, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me ***gjeste e veprime të një shoku*** Jusufi ka parasysh Kadri Zekën. Gjestet e tilla Jusufi i konsideron ***lojë e pamirë*** edhe me atë si person e gjithashtu edhe me Lëvizjen e Jusufit (LNÇKVSHJ).

8-10. Ti mund dhe besoj se je i painformuar

Shefqet Cakiqi - Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981."* (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 21:22)

Ibrahim Kelmendi: "*Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë **kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime**. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë." (www.kosova.de,* Afishuar me: 23.03.2007 22:57)

Jusuf Gërvalla*:" Ti mund dhe besoj se **je i painformuar** lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë **kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Letra e Jusufit e 15 janarit 1982 është letra e parë që Jusufi ia dërgon Ibrahim Kelmendit, pas një letre në nëntor 1980.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i ***përfshirë, inkuadruar*** *apo* ***informuar*** prej anës së Jusufit gjendet i sqaruar në tërësi në dy letra të Jusufit të dërguara Sabri Novosellës; më 13 maj dhe 20 gusht 1981. Këto dy letra unë i kam shtjelluar në kapitujt "Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore" dhe "Në Kalanë e Jusuf Gërvallës" andaj nuk është nevoja të zgjerohem këtu më shumë.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i ***përfshirë, inkuadruar*** *apo* ***informuar*** në bisedimet rreth bashkimit prej anës së Kadri Zekës nuk është çështje me të cilën ka pasur nevojë të merret Jusufi dhe rrjedhimisht nuk është çështje me të cilën kam nevojë të merrem unë. Jusufi i përgjigjet shumë mirë Ibrahim Kelmendit:

*Por, unë **kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë.***

Çka dinë Jusufi? Ku bënë tani pjesë (më 15 dhjetor 1982) Ibrahim Kelmendi?

Jusufi e din se Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi janë në të njëjtën organizatë.

Kush i tregoi Jusufit këtë fakt? - Kadri Zeka!

Ku dhe kur? - Në panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

8-11. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë

Jusuf Gërvalla*: "Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufin nuk e lejon edukata e tij të përzihet në punët e brendshme të Kadri Zekës e Ibrahim Kelmendit. Jusufi i thotë I. Kelmendit se shokët e tu të rinj (Kadri Zeka etj.) e kanë me borxh me të përfshi, me të inkuadrua e me të informua.

8-12. Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar

Jusuf Gërvalla*: "Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin,* ***do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme.*** *Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Të gjitha thëniet e këtij citati janë aq të qarta sa është vështirë, ndoshta edhe mëkat me u mundua e me i thënë më mirë.

8-13. Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste

Jusuf Gërvalla*: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty.* ***S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne****. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "****antikomunist****" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me **njeriun antikomunist të Lëvizjes** mendohet Sabri Novosella. Pra, Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi mendojnë se Sabri Novosella mundet me u ndie i ofenduar nëse ata e shpallin si antikomunist. Këtu shtrohet prapë një çështje delikate. Pasi Kadri Zeka dhe OMLK-ja e konsiderojnë vetëm veten komunist të formuar dhe askënd tjetër, kjo domethënë se e meta dhe gjynahu i Sabriut nuk qëndron në atë se pse ai nuk është komunist, por pse është **antikomunist** e kundërshtar i partisë iluzioniste.

8-14. Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"

Jusuf Gërvalla: *"Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në* ***thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"****, të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z (Kadri Zeka - shën i Xh. D.).*

Tani po e kupton se unë hyra shumë thellë në punë që s'janë të miat, ***në punë tuaja të brendshme.*** *Prandaj, nuk shkoj dot më tej. Dëshiroj që ana jonë këndej të jetë e gabuar dhe juve t'ju shkojë puna për së mbari deri në arritjen e fitores. Ne s'ndiejmë frikë as kemi dëm nga cilado forcë me të vërtetë patriotike e revolucionare e popullit tonë. Përkundrazi, atë kërkojmë si qorri sytë dhe ajo na bënë të mburremi. Por kemi një çikë ndruajtje se punës i është zënë jo fort mirë peta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

8-15. Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta dhe jo njerëzit e gënjeshtrave si Kadri Zeka e Ibrahim Kelmendi

Hydajet Hyseni: *"Ata dy, Jusufi e Kadriu, madje, kishin biseduar dhe ishin pajtuar edhe për ndonjë kompromis e për ndonjë tërheqje taktike, për të evituar këto keqkuptime me shpresë se në këtë mënyrë do ta lehtësonin realizimin e synimit madhor të bashkimit të ri të lëvizjes."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Hasan Mala*: "Isufi i ka thënë (Kadri Zekës - shën i Xh. D.) se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Jusufi e ka pritë me rezervë, domethënë ai e ka pritë me rezervë që pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë."* (Nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1997)

Jusuf Gërvalla*: "Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e **bashkimit**. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, **do ta bëjnë** kur të vijë koha, **njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

9.Gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

9-1. Gënjeshtrat e Taip Zekës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Mendime e deklarime lidhur me rrugën e Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit në Shtutgart (në Bernhausen) në mbrëmjen e 16 janarit dhe shkuarjen në shtëpi të Jusufit në Untergruppenbach, në ora 03.00 të 17 janarit 1982.

Taip Zeka: *"...Jo Jusuf, siç na kanë thanë neve këtu, po Isuf e ka pasë emnin. E ka qitë edhe ai gazetën 'Lajmëtari i lirisë' dhe kanë hy edhe në Kosovë ç'ato tri gazeta. Por u bënë shumë gazeta, duheshin shumë para. Atëherë janë marrë vesh mes veti për me ba një gazetë të vetme.*

*Për këtë punë Kadriu kalon prej Zvicre dhe del në Gjermani dhe janë takua në banesë të Isufit. Aty janë kanë Isufi, Kadriu, Ibrahim Kelmendi, po edhe shokë të tjerë ka pasë. **Të gjithë kanë qenë të një mendimi**: me ba një gazetë të vetme dhe atë me e quajtë 'Liria'. Pra e kanë ba bashkimin, mirëpo nuk është mbërri gazeta me dalë, se ata janë vra atë natë, më 17 janar 1982." (*Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 23-24)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as **ORGANIN TONË, GAZETËN** (Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.) **PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM** e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. **Kjo nuk do të ndodhë KURRË**."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Ibrahim Kelmendi: " *Mirani... e **vuante përgjegjësinë për botim të Bashkimit**, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 288)

Muharrem Blakaj: *"Virtytet e një burri të **papërkulshëm**, siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë në **bashkëpunim të barabartë** me të ... Sesa kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla që bëri një përzgjedhje të tillë, flet vetë Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, të përjetuara nga një **inferioritet vandal**..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 7-8)

Fjalë të Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit të vendosura në gojën e Nuhi Sylejmanit.

"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Taipi vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, nuk është cicijash sikur Taipi, Mirani dhe Mirjana. Pse AP nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare. **Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."(***Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982*)*

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi: **Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot**."(*Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Jusuf Gërvalla: *"Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot **shpresën e bashkimit**. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e **aq të shenjtë për ne**, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu **deri në çastin e vdekjes**."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-2. Gënjeshtrat e Hasan Malës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

"Apostol Duka: -U arritë ky bashkim, ose shkrirja e ***dy organizatave*** *në një të vetme, nëse mund të shprehemi kështu?*

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të* ***dyja organizatat*** *të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej 'Liria'. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e Frontit, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Saime Isufi: ”*Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.”* (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

Ibrahim Kelmendi: *”Hasan Mala. Edhe ai do të faktorizohet, meqë edhe atij, (ish-traktoristit dhe gjysmanalfabetit), i rastisi të gjendej emigrant në Zvicër. Atje Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e ndonjë tjetër e kishin afruar që të kishin tek ai bazë strehuese dhe mundësi të transportit me makinë. Për këtë gatishmëri e angazhim udhëheqësit e OMLK-së e kishin shpërblyer me dhënie të statusit të “kandidatit” të OMLK-së. Ai dhe, në këtë rast, edhe vëllai i Kadri Zekës, rrëfejnë, por duke mos u mbështetur në dëshmitarin e Bashkimit (që kishte rastisur të isha unë), siç u ka treguar, por “filozofojnë”, sikur janë dëshmitarë.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 302)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hasani vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, nuk është cicijash sikur Hasani, Mirani dhe Mirjana. Pse AP nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-3. Gënjeshtra e Saime Isufit për bashkimin-Boll inatë më erdhi që doli Jusufi

Saime Isufi*: "Pikërisht në natën e kobshme* ***ku ai ishte bashkuar*** *me vëllezërit Gërvalla, kishte dalë për të më telefonuar se atë natë nuk mund të kthehej."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 102)

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

Suzana Gërvalla: "*Nga ora 22,00 (Jusufi dhe Kadriu) zbritën (nga dhoma e punës në katin e tretë në dhomën e ditës në katin e parë-shën i Xh. D.). Unë e kisha bërë darkën. Kadriu ishte martuar dy javë përpara. (Kadriu tha) Unë duhet patjetër me e lajmërua gruan se nuk kthehem sonte. Jusufi i tha le o burr se jemi në luftë, mos e mëso gruan ashtu e mos na nxirr natën me dalë veç për telefon. Ne nuk kishim telefon të shtëpisë. Na thirshin e (provokonin UDB-ja), se shumë na thirrshin. Bardhi i tha ani se po të çoj. Sa dolën te dera Jusufi tha hajt se po vi edhe unë. Se Jusufin nuk e lenin fortë natën me u endë. Shokët e ruanin shumë. Kanë dalë te dera. Kur dolën* ***boll inat më erdhi që doli Jusufi****.* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016; YouTube-3 gusht 2017, koha në film 8:30-10:00)

Faridin Tafallari: *"Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* *(*Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Bedri Islami: *"...Jusufi, Kadriu dhe Bardhi, duke pasur mirëkuptimin dhe gatishmërinë edhe të drejtuesve dhe grupacioneve tjera politike ilegale,* ***vendosën të bënin bashkimin dhe shkrirjen e të gjitha lëvizjeve politike*** *atdhetare, në një organizatë të vetme politike. Realizimi i saj më 17 janar 1982 ishin fryti më i madh i bashkëpunimit dhe i qartësisë së mendimit politik. Ata kishin realizuar një ëndërr të madhe."* (Nga shkrimi 'Merrni nga unë atë që nuk është ndarje')

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e ***aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër shokut të Organizatës së Kadri Zekës, Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

9-4. Gënjeshtrat e Hydajet Hysenit dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Hydajet Hyseni*: "Ngjarjet e vitit 1981, krijuan jo vetëm nevojën, por edhe kushtet për një bashkim të gjerë të të gjitha forcave patriotike në një front të përbashkët të luftës për Republikën. ... Po për këtë formë organizimi ishte edhe Jusuf Gërvalla dhe ishte pikërisht ai që kishte këmbëngulur që Kadriu, për shkak të përvojës dhe përgatitjes që kishte të shkonte e punonte së bashku me Jusufin në bërthamën pesëanëtarëshe që kishin krijuar në Gjermani. Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët. Madje edhe pasi qe imponuar nxjerrja e dy botimeve "Liria dhe Zëri i Kosovës", për të evituar përçarjet dhe keqkuptimet, Kadriu dhe Jusufi vazhdojnë të punojnë së bashku, gjë që dëshmohet më së miri me materialet e përziera, të botuara në të dy botimet."* (Kadri Zeka - Në 50 vjetorin e lindjes; Marrë nga përmbledhja e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, faqe 140-141)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Jusuf Gërvalla*: "Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSH MBI TË TJERËT****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla***: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim****."*

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla: ***"****Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."*

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "****Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre****, kur nuk dhanë asnjë shenjë!"*

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."*

Hydajet Hyseni: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin. ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT."***

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Hydajeti vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica nuk është cicijash sikur Hydajeti, Mirani dhe Mirjana. Pse AP nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* – vazhdoi Troshi pa vullnet*. – S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)*

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e ***aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-5. Gënjeshtrat e Berat Luzhës dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Brat Berat Luzha*: "Në vitin 1980 në Zvicër filloi të dilte edhe një gazetë tjetër, organi "Liria" nga Kadri Zeka me shokë, të cilën Jusufi e Bardhoshi e përfaqësojnë* (nëse është gabim shtypi mund të themi se e përqafojnë pasi Jusufi as nuk ka pas kurrë leje e as nuk i ka dhënë vetes të drejtë të përfaqësojë gazeta e organizata në të cilat nuk ka qenë anëtarë-shën ynë*) si të veten. Kjo u bë edhe rast për t'u njohur, për të vënë kontakte edhe për të vendosur bashkëpunim të ngushtë. Jusufi ndërpret botimin e 'Lajmëtarit të lirisë', ndikon edhe për ndërprerjen e 'Bashkimit', me qëllim që 'Liria' të mbahej një artikullues i fuqishëm atdhetarie, sepse sipas tij 'Kosova nuk kishte nevojë për disa zëra të mekur, por për një zë të vetëm dhe të fuqishëm'. (*Si u krijua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, 'Zëri', 18 janar 1992, Prishtinë)

Brat Berat Luzha*: "Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi u vranë natën e 17 janarit 1982 në një fshat afër Shtutgartit, ku ata ishin në krye të detyrës së madhe për t'i bashkuar dhe organizuar mërgimtarët tanë dhe emigracionin politik që atëherë rritej me të madhe. Armiku kishte llogaritur se me vrasjen e tre veprimtarëve se jo vetëm do ta dëmtonte kreun e emigracionit politik, por do ta pengonte edhe bashkimin e grupeve dhe të organizatave politike në Kosovë dhe jashtë,* ***por për fat ata punën e kishin kryer****, bashkimi i grupeve u shpall vetëm pak ditë pas vrasjes së tyre."* (Si u krijua *Lëvizja Populllore për Republikën e Kosovës*, 'Zëri', 18 janar 1992, Prishtinë).

Berat Luzha: "*Shpërthimi i demonstratave në Kosovë dhe organizimi i demonstratave në mërgatë gjatë mars-prillit 1981 kanë bërë që të shpejtohet procesi i njohjes, i afrimit dhe i bashkimit të organizatave ilegale. Me propozimin e Jusuf Gërvallës ishte ndërprerë botimi i gazetës "Lajmëtari i lirisë", në mënyrë që të dilte vetëm një organ i përbashkët i OMLK-së dhe i LNÇKVSHJ-së, gazeta "Liria*". (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f.234)

Berat Luzha: "*Edhe pse Jusufi e Kadriu ishin në* ***lidhje të vazhdueshme*** *dhe në pajtueshmëri të plotë me tezat dhe me bashkimin e dy organizatave, Jusufit i duhej të merrte edhe mendimin dhe pëlqimin e Sabri Novosellës, lider i organizatës, i cili gjithashtu ishte arratisur nga Kosova dhe jetonte në Stamboll. Kështu u morën vesh që në Stamboll, për t'u takuar me Sabriun, në tetor të vitit 1981, të udhëtonin Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Në takimin e mbajtur, nuk u arrit pëlqimi për bashkim, sepse Sabriu nuk pajtohej që brenda Frontit të funksiononte edhe një bërthamë e brendshme me premisa ideologjike.*

Për t'u njoftuar me përfundimet e takimit të Stambollit, Komiteti Drejtues i OMLK-së, në tetor të vitit 1981, dërgoi në Zvicër te Kadri Zeka, Berat Luzhën. Kadriu e njoftoi detajisht Beratin për takimin dhe bisedën në Stamboll, posaçërisht për mosarritjen e pëlqimit për

bashkimin e organizatave. Kadriu e njoftoi edhe për qëndrimet personale të Jusuf Gërvallës, duke pohuar se me Jusufin nuk kishin asnjë kundërshtim për Tezat dhe as për bashkimin e organizatave. Madje, Kadriu ka thënë se me Jusufin tashmë janë të angazhuar edhe në një celulë të OMLK-së. Gjithashtu, ai ka thënë se pavarësisht qëndrimeve të shfaqura në takimin e Stambollit, Jusufi i kishte premtuar Kadriut se bashkimi i organizatave nuk do të ndërpritej, por do të vazhdojë deri në fund." (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f.237-238)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Berat Luzha: "*Megjithatë, Kadri Zeka, anëtar i Komitetit Drejtues, vazhdonte punën me ngulm në mërgatë, bashkë edhe me Saime Isufin, Hasan Malën e të tjerë.* ***Pas një ndërprerje të kontakteve mes Kadri Zekës e Jusuf Gërvallës, që zgjati dy-tre muaj, Kadriu dhe Jusufi arritën t'i tejkalojnë keqkuptimet që u erdhën nga jashtë*** *dhe vendosën të vazhdojnë veprimet në drejtim të bashkimit të grupeve. Kështu, më 17 janar 1982, në banesën e Jusuf Gërvallës në Untergrupenbah, afër Shtutgartit. Jusuf Gërvalla në emër të LNÇKVSHJ-së, Kadri Zeka në emër të OMKL-së dhe Ibrahim Kelmendi, në emër të Frontit të Kuq Populllor, shpallën bashkimin e organizatave. ...(* Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, *f.239-240)*

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT."(*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Berat Luzha: *"Mirëpo, dy nga protagonistët e këtij bashkimi të organizatave, Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla, u vranë nga sigurimi i shtetit jugosllav po atë ditë dhe kështu çështja ngeli në pikën zero. Pas vrasjes së Kadri Zekës e të vëllezërve Gërvalla, anëtarësia në mërgatë, e dëmtuar rëndë, po vazhdonte përpjekjet për riorganizim dhe bashkim të Lëvizjes Kombëtare.*

Në kryeqytetin turk, Ankara, më 17 shkurt 1982, takohen përfaqësuesit e dy organizatave të deriatëhershme, LNÇKVSHJ-së dhe PKLMSHJ-së, të kryesuara nga udhëheqësit e tyre, Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica. Në këtë takim u shtrua, u miratua dhe u shpall bashkimi i këtyre organizatave ilegale në një organizatë, me emrin "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi" (LRSSHJ).

*Në një takim, më 15 maj 1982, në qytetin Biel-Biene të Zvicrës, ku merrnin prej Xhafer Shatri e Hasan Malaj nga OMLK-ja dhe Osman Osmani e Xhafer Durmishi, nga LRSSHJ, u bë bashkimi (i tretë) i këtyre dy organizatave, apo si thotë Osman Osmani, OMLK-ja u bashkua pa kushte në LRSSHJ." (*Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, *f.240)*

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË"****.*

Berati vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica nuk është cicijash sikur Berati, Mirani dhe Mirjana. Pse AP nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet*. - S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të ***nevojshëm e aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

<u>Deri në çastin e vdekjes</u>

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-6. Gënjeshtrat e Mehmet Hajrizit dhe gazeta për të cilën e kanë dhënë jetën Jusuf e Bardhosh Gërvalla

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."*** (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Mehmet Hajrizi: *"Siç e thashë, bashkimi i të gjitha organizatave ilegale të asaj kohe ka qenë fusha kryesore e veprimtarisë së Kadriut. Ai i ka hyrë kësaj pune me të gjitha forcat dhe pasionin e tij. E ka bërë dendur këtë punë, sidomos me Jusuf Gërvallën, me të cilin më në fund, kanë arritur marrëveshjen e bashkimit të organizatave dhe të dy organeve të shtypit. Po për fat të keq, ata u vranë fill pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, prandaj bashkimi u vonua, por u arrit më vonë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, f. 183)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Ibrahim Kelmendi: " *Mirani... e* ***vuante përgjegjësinë për botim të Bashkimit****, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 288)

Fjalë të Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit të vendosura në gojën e Nuhi Sylejmanit. *"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Mehmeti vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica nuk është cicijash sikur Mehmeti, Mirani dhe Mirjana. Pse AP nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare. ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(*Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-7. Tri gënjeshtra të Mehmet Hajrizit për natën e 17 janarit 1982

Xhafer Shatri: *"Një parantezë. Në prag të vrasjes tragjike të shokëve tanë Jusufit e Bardhoshit (kanë qenë siç dihet anëtarë të ish Lëvizjes nacionalçlirimtare...) dhe Zeqës (anëtar i ish-Organizatës Marksiste-Leniniste...) janë zhvilluar bisedime për bashkim. Bisedimet kanë qenë të suksesshme dhe* ***sipas të gjitha gjasave natën e vrasjes (pra jo mëngjesin nga ora 03.00-05.00*** *siç thotë dëshmitari i Mehmet Hajrizit-shën i Xh. D.) ka ardhur gjer te bashkimi."* (Letër në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, 1983)

Jusuf Gërvalla*: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Mehmet Hajrizi: *"****Në natën*** *e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e* ***tri organizatave*** *çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Bedri Islami*: "Nëse nuk do të ishin fillesat e vitit 1980 dhe puna e Kadriut, Jusufit dhe Bardhit, si dhe* ***organizatës së krijuar prej tyre më 17 janar 1982****, Lëvizja Populllore për Republikën e Kosovës, nuk do të kishim pasur një diasporë si ajo që u shfaq madhërishëm në luftën e Kosovës".* (Marrë nga Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008 f. 293)

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të ***nevojshëm e aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta.* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Deri në çastin e vdekjes

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

9-8. SIPAS DËSHMISË SË BASHKËVEPRIMTARIT TË TYRE

Mehmet Hajrizi: *"Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (****sipas dëshmisë së bashkëveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit****) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008 f. 307)

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij....*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër dërguar **shokut të Organizatës së Kadri Zekës**, **bashkëveprimtarit të Kadri Zekës**, Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Cilat janë ato materiale që Jusufi pak i ka shpërnda tek shokët, e me të cilat bodrumi është plot. Fjala është për "Zëri i Kosovës", Nr.2 janar 1982.

Në galerinë e rrenave e falsifikimeve të shembura e shkatërruara nga Jusufi, kemi disa mospërputhje kardinale ashtu siç është rendi çdo herë kur kemi të bëjmë me gënjeshtra e rikonstruktime.

Taip Zeka flet vetëm për bashkim gazetash dhe për 'Lirinë'.

Saime Isufi nuk flet as për gazeta e as për organizata, por mjaftohet vetëm me thënien se "ai (Kadriu) është bashkuar me Vëllezërit Gërvalla".

Bedri Islami thotë krejt diçka tjetër. Ai nuk përmend as gazeta (për shkak se i din vuajtjet e I. Kelmendit për gazetën Bashkimi) dhe as organizata. Sipas tij, më 17 janar 1982, në shtëpinë historike të Jusufit është bërë **bashkimi e shkrirja e të gjitha** organizatave politike (por nuk lodhet me e përmend asnjë me emër, sigurisht për arsye se ato janë aq shumë sa është vështirë me i numërua të gjitha me emër).

Hydajet Hyseni nuk përmend fare organizata, por vetëm bashkimin e gazetave dhe "kërkesën e Jusufit që të mbetet Liria".

Brat Berat Luzha, apo lulja e kurora e gazetarisë së Kosovës, flet vetëm për Lirinë dhe bashkimin e grupeve pa e bërë as përcaktimin më të vogël, se për cilat është fjala.

Xhafer Shatri mendon se "sipas të gjitha gjasave" bashkimi është bërë vetëm në mes LNÇKVSHJ dhe OMLK-së, d.m.th. pa Frontin e krijuar nga UDB-a. Konkretizimi i tij shtrihet edhe më tej. Ai mendon se ky bashkim është bërë në mbrëmje, pa Ibrahim Kelmendin.

Siç do të ndalemi më gjatë I. Kelmendi, harron se çka ka shkrua me dorën e vetë në vitet 1983-1984, dhe thotë se bashkimi është bërë në mes tri organizatave-organizimeve (dhe jo dy) dhe jo në mbrëmje por në mëngjesin e orët e para të 17 janarit. Për mbrëmje ka mbetur të bëhet vetëm formulimi i vendimit me shkrim, të cilin I. Kelmendi nuk ka mundur ta pres sepse i kanë dalë punë më të rëndësishme.

Mehmet Hajrizi, në librin për Kadri Zekën të Apostol Dukës, flet për bashkimin e dy gazetave, e të organizatave, ndërsa në librin e vetë të cituar më lart, flet për bashkim të tri organizatave, pa i përmendur me asnjë fjalë se cilat ishin ato dhe si u quajt organizata që doli nga bashkimi. Pse vepron historiani Mehmet, i cili për garant të vërtetës së historisë se vetë e ka zgjedhur as më pak e as më shumë se vet Ciceronin. Këtë ai e bënë vetëm e vetëm sepse është një ideolog i thellë, zhiva enciklopedi, që i kupton gjërat në tërë kompleksitetin e vetë, dhe në fund të fundit është shumë i vetëdijshëm se kur nuk ke asgjë konkrete nuk mund të përdorësh emra konkret. Kur t'ia shtosh gjithë kësaj se ai përveç Ciceronit si dëshmitarë kryesor për fundin apo finalen e të vërtetës së Organizatës së vetë e ka zgjedhë edhe Ibrahim Kelmendin, atëherë na sqarohet e gjithë tablloja dhe ne e kuptojmë se këtu me të vërtetë kemi të bëjmë me një person e me një bimë tepër të rrallë që ka bi në bokrrinat e Strofcit, i cili të gjitha problemet i kupton me themel në tërë kompleksitetin e vetë dhe na i servon shumë të qarta e të thjeshta në formën e dokrrave.

Për mbylljen e këtij kapitulli nuk kam gjetë fjalë më të mira se ato të Jusufit nga romani Rrotull.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet*. - S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

10. Udhëtimi i Kadri Zekës nga Dusseldorfi në Shtutgart

Kadriu duhej që më 17 janar 1982 të ishte në shtëpinë e vetë 640 km në jug të Dusseldorfit.

Saime Isufi*: "**Më 12 janar 1982, Kadriu u nis në** Gjermani për të kontaktuar me veprimtarë. Ndër ta edhe me Vëllezërit Gërvalla**.** Me vete mori edhe materialet e numrit 6-të të 'Lirisë' për t'i botuar si dhe 'Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës'. Tezat do t'i konsultonte edhe me vëllezërit Gërvalla. Numri i 6-të i 'Lirisë' doli pas rënies së Kadriut. Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Ibrahim Kelmendi: "*Aty dhe në vizita të tjera takonim bashkatdhetarë veprimtarë. Kadriu kishte planifikuar ta kalonte atë fundjavë në Dyzeldorf. Aty kaluam natën ndërmjet të premtes e të shtunës së 16 janarit. Të shtunën para dite, ndoshta rreth orës 11.00, Mustafa na njoftoi se Jusufi kishte telefonuar dhe na kishte ftuar për të shkuar në mbrëmje në Bernhausen, qytezë afër Shtutgartit (Stuttgart), te bashkatdhetari Murat Kryeziu.*" (Bedri Islami, Lëvizja f.26)

Albana Krasniqi: *(Kadri Zeka) "Më 2 janar 1982 martohet me Saime Isufin, apo Bule Zekën, siç e njohin punëtorët bashkëluftëtaren e tij. Dasma qe tepër modeste. Krushq qenë mërgimtarët me mallin e pashuar për vendlindjen. Ishin mes shokëve dhe idealit të luftës edhe Jusufi e Bardhoshi, Hasani,* ***Fahredini*** *e shumë të tjerë. Disa ditë më pas udhëton për në*

Gjermani të takohet me vëllezërit Gërvalla. Kishte ardhur koha që grupet në mërgim të bashkohen në një, dhe vetëm ashtu të bashkuar mund t'i prinin luftës bijtë e Kastriotit." (Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002, faqe 36)

Fjalët e Saime Isufit dhe Albana Krasniqit edhe pse me gënjeshtra, e vërtetojnë se udhëtimi për në Gjermani, dhe udhëtimet brenda Gjermanisë janë bërë vetëm e vetëm me iniciativë të Kadri Zekës për punë të OMLK-së, Frontit të OMLK-së dhe aspak për shkak të ndonjë ftese nga Jusuf Gërvalla.

10-1. Retroaktivteti

Resul Bedo: "*Dy ditët e fundit të jetës së tij Kadri Zeka i kalon në Dyseldorf mes atdhetarëve dhe më 16 janar 1982, pasdite, udhëton për në rrethin e Shtutgartit,* ***ku është i ftuar*** *nga Jusuf e Bardhosh Gërvalla.*" (Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002, faqe 19; **Botimin e ndihmuan: Dardan S. Novosella**, Hamzi Rahimi dhe Sibush Haziri)

Me atentatin në Vëllezërit Gërvalla e Kadri Zekën rreth orës 22.15 më 17 janar 1982, krijohet prej atij momenti një ngjarje e jashtëzakonshme që vlen për kohën pas ngjarjes valët e së cilës janë të forta edhe në ditët tona. Por shumë veta, në mënyrën e vetë valët e efektin pas ngjarjes mundohen ta kthejnë edhe para ngjarjes, e kjo është praktikisht e pamundur në bazë të të gjitha ligjeve natyrore.

Si pasoj e këtij gabimi logjik, p.sh. Sabri Novosella, në intervista televizive deklaron; Sabri Novosella: "*Shkuarja e Kadri Zekës me Ibrahim Kelmendin tek Jusuf Gërvalla e Bardhosh Gërvalla për ne është e pasqarueshme. Ne nuk kemi pasë asnjë informatë. As nuk kam pas unë në Turqi as nuk ka pas Metush Krasniqi në Kosovë. Por shkuarja e tyre te Jusufi e kanë shpjeguar edhe shokët e edhe Suzana, për ta ka qenë e papritur." (*Kush e vrau Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën?, First Channel, 9 tetor 2014, YouTube)

Jusufi në asnjë rast të vetëm nuk i ka raportuar Sabri Novosellës, se sot e pata mysafir të rastit Kadri Zekën, sepse asnjë bisedë nuk ka pasur të bëjë për bashkim organizatash, apo me këtë apo atë datë kam planifikuar takim. Të shumtën e herave, kur Kadri Zeka ka ardhë për punë të revistës Liria, apo për organizim demonstratash, gojarisht e ka paralajmëruar Jusufin duke thirrë në zyrën e Bardhoshit, ditëve të punës, gjatë orarit të punës prej të hënës deri të premten. Pra takimet kanë qenë të planifikuara, të organizuara. Pas 17 tetorit 1981 e deri në vdekje, raporti i Jusufit me Kadriun ka ndryshua në themel. Ardhja e Kadri Zekës tek Jusufi, më 17 janar 1982 në ora 03.00 të natës nuk ka qenë e organizuar prej anës së Jusufit. Kur ka mbaruar shikimi i videofilmave tek Murat Kryeziu, Kadriu ka shpreh dëshirën dhe qëllimin e tij të shkoj tek Faridin Tafallari, së bashku me Ibrahim Kelmendin. Me këtë dua të them se pamvarësisht se a kanë qenë ardhjet e Kadri Zekës të organizuara apo spontane, Jusufi nuk e njofton Sabriun për asnjë rast të vetëm, duke i konsideruar vizitat si të zakonshme dhe jo për bashkim organizatash.

Ardhja e Kadri Zekës tek Jusufi, *vetëm pas atentatit*, fiton peshën e një rëndësie të jashtëzakonshme. Por është shumë gabim logjik që këtë peshë me u mundua me ia dhënë kësaj ardhje para atentatit. Para atentatit ajo ardhje nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, përveç ardhjes në ora 03.00 të natës. Ngjarjet në luftë, e vrasjet në pusi nuk mund të vendosen

peshore, kudo do të kërkohej ndonjë lloj ekuilibri derisa ana e majtë të barazohet me anën e djathtë. Po ta marrim seriozisht Sabri Novosellën në këtë pikë, atëherë ai nuk është dashtë me e financuar librin; *Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002,* në të cilin Resul Bedo riprodhon gënjeshtra që ia kanë servuar të tjerët, e kundër të cilave reagon Sabriu 12 vjet më vonë (nga 2002 në 2014). Nuk ekzistojnë rrena të vogla.

10-2. Të udhëtosh 420 km në drejtim të shtëpisë tënde duhet të kesh një shkak të madh

Lidhur me rrugën e Kadri Zekës dhe shokut të tij Ibrahim Kelmendit, nga Dusseldorfi për në Shtutgart, në pasditën e 16 janarit 1982, e kam dëgjuar edhe një arsyetim në këtë formë: Kadri Zeka dhe shoku i tij Ibrahim Kelmendi, të shtunën më 16 janar 1982 kanë qenë në Dusseldorf, 420 km larg prej Shtutgarti. 420 km rrugë nuk merren për ndonjë punë të vogël. Duhet të ketë ekzistua një arsye e fortë që Kadri Zeka e Ibrahim Kelmendi ta bëjnë këtë rrugë, e kjo arsye e fortë nuk është asgjë tjetër pos ftesa e Jusufit me qëllim të zhvillimit të bisedimeve për bashkim të organizatave. Ky është arsyetimi i njerëzve që nuk kanë idenë më të vogël për të vërtetën e asaj kohe.

Saime Isufi: *"Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Lexuesi duhet ta dij se Kadri Zeka ka banuar në Zvicër, në St. Gallen. Për në Dusseldorf Kadri Zeka ka udhëtuar të marten më 12 janar 1982. Në Dusseldorf qëndron nga 12 janari deri më 16 janar duke i organizuar aktivistët e Dusseldorfit në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës, të OMLK-së. Të shtunen, pasi konsideron se i ka krye të gjitha punët në Dusseldorf për 5 ditë, pasdite të shtunën, më 16 janar, nisen për në Shtutgart, pasi të hanen më 18 janar Kadri Zeka është dashur me shkua në punë në qytetin ku ka banuar, në St. Gallen të Zvicrës. Rruga më e shkurt nga Dusseldorfi për në St. Gallen kalon përmes Shtutgartit. Pasi Jusuf Gërvalla nuk i ka ftuar, Ibrahim Kelmendi, në një incizim nga një mbledhje më 3 mars 1984 në Gjenevë, tregon se janë nisur për tek Faridin Tafallari, që ka banuar në Nagold.

10-3. Skema e gënjeshtrave të Ibrahim Kelmendit prej 12 janarit deri më 17 janar 1982 Kadriu kishte planifikuar ta kalonte 17 janarin1982 në Dusseldorf, 640 km në veri nga vendbanimi i tij në St. Gallen të Zvicrës

Gënjeshtrat për qëndrimin e Kadri Zekës në Dusseldorf

Saime Isufi shkruan se Kadri Zeka është nisë për Gjermani më 12 janar 1982. Edhe pse ajo thotë se qëllimi kryesor i tij ka qenë të takohet me Jusufin e Bardhoshin, Kadriu i bien përmes Shtutgartit dhe shkon tek shoku i vetë Ibrahim Kelmendi në Dusseldorf, për propagandimin e Tezave të Frontit për Republikën e Kosovës, meqë mendonte se të gjithë aktivistët patriotë se shpejti duhej të përfshiheshin në këtë Front.

Ibrahim Kelmendi njëherë gënjen se Kadriun e takon të enjten më 14 janar dhe atë mbrëmje qëndron tek vëllau i tij Mustafa. Gënjeshtra tjetër është se Kadriun e takon vetëm të premten më 15 janar në banesën e Sylë Nuhajt. Gënjeshtër tjetër se Kadriu e ka ndërmend të qëndroj në Dusseldorf më 16 e **17 janar**.

Sipas kësaj Kadriu nuk ka plan me u takua fare me Jusufin e Bardhoshin por vetëm me Ibrahim Kelmendin, rrethin e tij në Dusseldorf.

10-4. Lutja marksiste-leniniste për Allahun
Insha-Allah Jusufi do të na thirrë mysafir

إن شاء الله

”*Jusufi e Kadriu e vazhdojnë bashkëpunimin dhe përpjekjen për bashkimin e organizatave të tyre. Më 16 janar pasdite, Kadri Zeka, pasi ishte ftuar nga Jusuf e Bardhosh Gërvalla për t'i vazhduar bisedimet për bashkimin e organizatave të tyre u nis për në qytezën Untergruppenbach afër Shtutgartit. Atje arriti rreth orës 03.00 pas mesnate*. (më 17 janar 1982-shën i Xh. D.) (Filmi dokumentar; Ç'ke bërë sot për Kosovën?, janar 1997, minuta 36-37)

Jusuf Gërvalla nuk e ka ftuar Kadri Zekën as për bisedime për bashkim dhe as për ndonjë motiv tjetër. Kadri Zeka ka ardhë tek Jusufi si i paftuar.

Nexhat Çoçaj: ”*Pasi ishte nisur Jusufi me Remziun (Ademin-shën i Xh. D.), ka ardhë Kadri Zeka me Ibrahim Kelmendin dhe një person tjetër në shtëpinë tonë (Habichthöhe 40, Untergruppenbach-shën i Xh.D.) dhe pasi u kam treguar se ku gjenden, ata kanë shkuar për t'iu bashkuar shokëve në Bernhausen-kujton Suzana Gërvalla.”* (Petriti i Shkrepave-*libër për Remzi Ademin*, I, faqe 112, referenca 190, Durrës 2011)

Dëshmia e Suzana Gërvallës i hedh poshtë të gjitha gënjeshtrat se Jusufi i ka ftuar Kadri Zekën dhe Ibrahim Kelmendin.

Ibrahim Kelmendi: "*Vesëmira shtroi mëngjesin rreth orës 10.30. Ajo e kishte përgatitur me përkushtim. Ndërkohë Muja, vëllai i Miranit, bëri telefonatë dhe njoftoi se Jusufi i kishte thirrur Kadriun e Miranin të shkonin sonte tek ai, por pikëtakimi ishte te Murtez Kryebardhi në Bernhausen, afër aeroportit të Stuttgartit. Në banesën e tij do të shfaqeshin filmat, meqë Jusufit tashmë i kishin arritur videokasetat nga Tirana. Në rreth të Stuttgartit akoma nuk ishte formuar klub shqiptarësh ku do të bëheshin aktivitete, siç ishte formuar në Dyzeldorf. Kadriu e Mirani po përgatiteshin të shkonin në stacion të trenit për t'i kapur lidhjet që do t'i çonin atje. Sulioti tha t'i voziste ai.*

Rreth orës 16.00 u nisën për rrugë që të tre. Arritën në mbrëmje te Murtez Kryebardhi, meqë Mirani e kishte adresën e tij. Aty gjeten Jusufin, Bardhin dhe mbi dhjetë veta, aktivisë që po prisnin Kadriun e Miranin." (Atentatet, faqe 316-317)

Nexhat Çoçaj: ”*Pasi ishte nisur Jusufi me Remziun (Ademin-shën i Xh. D.), ka ardhë Kadri Zeka me Ibrahim Kelmendin dhe një person tjetër në shtëpinë tonë (Habichthöhe 40, Untergruppenbach-shën i Xh.D.) dhe pasi u kam treguar se ku gjenden, ata kanë shkuar për t'iu bashkuar shokëve në Bernhausen-kujton Suzana Gërvalla.”* (Petriti i Shkrepave-*libër për Remzi Ademin*, I, faqe 112, referenca 190, Durrës 2011)

Dëshmia e Suzana Gërvallës i hedh poshtë të gjitha gënjeshtrat se Jusufi i ka ftuar Kadri Zekën dhe Ibrahim Kelmendin.

Ibrahim Kelmendi: "*Aty dhe në vizita të tjera takonim bashkatdhetarë veprimtarë. Kadriu kishte planifikuar ta kalonte atë fundjavë në Dyzeldorf. Aty kaluam natën ndërmjet të premtes e të shtunës së 16 janarit. Të shtunën para dite, ndoshta rreth orës 11.00, Mustafa na njoftoi se Jusufi kishte telefonuar dhe na kishte ftuar për të shkuar në mbrëmje në Bernhausen, qytezë afër Shtutgartit (Stuttgart), te bashkatdhetari Murat Kryeziu.*" (Bedri Islami, Lëvizja f.26)

Nexhat Çoçaj: ”*Pasi ishte nisur Jusufi me Remziun (Ademin-shën i Xh. D.), ka ardhë Kadri Zeka me Ibrahim Kelmendin dhe një person tjetër në shtëpinë tonë (Habichthöhe 40, Untergruppenbach-shën i Xh.D.) dhe pasi u kam treguar se ku gjenden, ata kanë shkuar për t'iu bashkuar shokëve në Bernhausen-kujton Suzana Gërvalla.”* (Petriti i Shkrepave-*libër për Remzi Ademin*, I, faqe 112, referenca 190, Durrës 2011)

Dëshmia e Suzana Gërvallës i hedh poshtë të gjitha gënjeshtrat se Jusufi i ka ftuar Kadri Zekën dhe Ibrahim Kelmendin.

Në librat e mi rrethanat e mëposhtme janë të shtjelluara gjerësisht me ndihmën e fakteve të lëna nga Jusuf Gërvalla. Me këtë kapitull e kam vetëm një qëllim. Ta vërtetoj (vetëm me fjalët e Ibrahim Kelmendit) se Jusuf Gërvalla, më 16 janar 1982 nuk i ka ftuar as Kadri Zekën e as Ibrahim Kelmendin për kurrfarë pune, që të vijnë nga Dusseldorfi në Shtutgart-Bernhausen apo nga Dusseldorfi në Shtutgart-Untergrupenbach.

Të shtunën, më 16 janar, në orët e mbrëmjes Kadri Zeka e Ibrahim Kelmendi, si të paftuar trokasin në derën e Jusufit në Untergruppenbach, pa e ditur se ai nuk është aty. Nga Suzana informohen se Jusufi me shokët e Shtutgartit është tek Murat Kryeziu, 70 km larg.

Kur mbaron shikimi i filmave tek Murat Kryeziut, Jusufi e fton Kadriun në banesën e vetë në Untergrupenbach, në derën derën e së cilës Kadriu ka trokitë vetëm para disa orësh si i paftuar. Edhe pasi Jusufi e bënë këtë, Kadri Zeka e Ibrahim Kelmendi më me dëshirë do shkonin tek Faridin Tafallari se sa tek Jusufi. Pse? Me Faridin Tafallarin mund të diskutojnë për punët e Frontit të OMLK-së e me Jusufin jo. Pse me Jusufin jo? Sepse Jusufi pas takimit me Kadri Zekën në panairin e librit në Frankfurt, Tezat e Frontit të OMLK-së i ka gjuajtur në shportën e mbeturinave. Nga ai moment, për te, ato Teza përjetësisht kanë qenë të vdekura.

Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi, më 16 janar 1982 janë nisur nga Dyseldorfi për në Shtutgart vetëm e vetëm sipas planeve të tyre dhe interesave të tyre, e pa asnjë planifikim dhe koordinim me Jusufin. Dy letrat e fundit të Jusufit të 15 janarit 1982, njëra për Kadri Zekën në Zvicër dhe tjetra për Ibrahim Kelmendin e vërtetojnë këtë shumë mirë.

Me propozim të Xhafer Shatrit, organi udhëheqës i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ) është quajtur Qendra Ekzekutive (QE). Qendra Ekzekutive ka vepruar prej mesit të janarit 1983 deri më 3 mars 1984. (Qendra Ekzekutive në mbledhjen e 3 marsit 1984 quhet Komitet Qendror me plan që të zgjerohet me anëtarë të rinj. Shtjellimi i kësaj çështje është jashtë kufijve të qëllimit të këtij punimi.) Anëtarë të saj kanë qenë Faridin Tafallari, Hasan Mala, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi.

Kjo Qendër, më 3 mars 1984 e ka mbajtur një mbledhje, (rrjedhat e ngjarjve kanë bërë që kjo të jetë edhe mbledhja e saj e fundit, në këtë përbërje) ku të pranishëm kanë qenë Faridin Tafallari, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi.

Diskutimet e kësaj mbledhjeje janë incizuar në magnetofon, në katër kaseta 90 minutash (2x45 min).

Në këtë mbledhje që ka zgjatur rreth gjashtë orë është diskutuar për 1) Aprovimin e një rregulloreje të punës së Organit udhëheqës të Lëvizjes; 2) Si dhe kur u themelua LRSSHJ (17 shkurt 1982 apo 15 maj 1982); 3) Analizë e punës së gjertanishme; 4) Detyrat në të ardhmen, dhe 5) Të ndryshme.

Pjesa e incizuar, pas leximit të hyrjes dhe të rendit të ditës nga Ibrahim Kelmendi, është pjesë e diskutimit të Ibrahim Kelmendit, ku ai, më 3 mars 1984, e përshkruan momentin e nisjes së tij me Kadri Zekën, nga Dusseldorfi për në Shtutgart më 16 janar 1982, pra një ditë para vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës.

Për shkaqe praktike, për publikim në internet-youtube, dy audiofile të shkurta janë bashkuar në një. Në fillim, nga Ibrahim Kelmendi lexohet hyrja-rendi i ditës -1 minutë e 7 sekonda- nga fillimi i kasetës së parë, pastaj vazhdon deri në fund diskutimi i Ibrahim Kelmendit për ngjarje të 16 janarit 1982, nga kaseta 2, pjesa e parë, minutat 9-12)

Nga incizimi, shihet qartë se Jusuf Gërvalla, më 16 janar 1982, nuk i ka ftuar për kurrfarë pune Kadri Zekën dhe as Ibrahim Kelmendin, që të vijnë nga Dusseldorfi në Shtutgart-Bernhausen dhe as nga Dusseldorfi në Shtutgart-Untergrupenbach.

Ibrahim Kelmendi: "*Incizim i takimit të mbajtur më 3 mars 1984 në Gjenevë. Në fillim të takimit u aprovua një dokument i cili nuk do të lexohet dhe u nënshkrua nga të pranishmit. Si rend të ditës u aprovuan këto pika: 1)Përpilimi i rregullores së punës së Komitetit Qendror, 2) Si dhe kur u themelua LRSHJ-ja, 3) Analizë e punës së gjertanishme, 4) Detyrat në të ardhshmen, 5) Të ndryshme."* (Përfundon leximi i hyrjes nga fillimi i kasetës 1; Diskutimi në vazhdim i Ibrahim Kelmendit është nga kaseta 2, pjesa e parë, minutat 9-12, kur ai përshkruan ngjarje të 16 janarit 1982)

Ibrahim Kelmendi*:* (Kaseta 2, pjesa e parë minuta, 09.00) "*Pikërisht prej Mërgimit (*Sabri Novosellës-shën. i Xh.D.) *a pat arsye njëmend në atë nivel me u çart ata në mes veti* (si pasoj e qëndrimit të Kadri Zekës në takimin e Stambollit me Sabri Novosellën, në mesin e tetorit 1981-shën i Xh. D.). *Ndërsa prapë po më intereson tjetra. Ku munden ato vendime me i ngarkue njerëzit me përgjegjësi ashtu ku me të vërtetë prej dasmës e mbrapa, edhe në dasmë prapë është insistue prapë me ia nisë që me i bind shokët brenda se pamvarësisht që nuk u murëm vesh aty duhet me i fillua bisedimet e me e bindë njëri tjetrin, me e sqarua njëri tjetrin e me ardhë prapë tek bashkimi. Bashkimit s'kemi kah i ikim.* (Në dasmën e Kadri Zekës, më 2 janar 1982 nuk është bërë kurrfarë insistimi për bashkim. Për dasmën shih filmin i dasmës dhe letrën e Jusufit për Ibrahim Kelmendin, më 15 janar 1982, do me thënë 13 ditë pas dasmës-shën i Xh. D.)

*E prandaj nuk ish fort e pëlqyeshme, s'mu ka dukur atëherë, s'ka me m'u dukur kurrnjëherë në jetën time, kam drejt me e mbajt atë qëndrim, me thënë po e ngarkojmë me përgjegjësi (*Jusufin-shën i Xh.D*.) pse e kanë pranuar mysafir* (Kadri Zekën-shën. i Xh.D.), *kur e din Ky* (Faridin Tafallari-shën. i Xh.D.) *e e dinë boll (ai) kallabllak, që kur janë çue prej odës* (së Murat Kryeziut, në Bernhausen, Nord-West-Ring 30, më 17 janar 1982 në ora 02.00-shën i Xh.D*.) ku jemi kanë duke i parë filmat, çfarë insistimi e këmbëngulje ka pasë Jusufi me e marrë mysafir* (Kadri Zekën-shën. i Xh.D*.). A ne gjatë rruge jemi nisë* (nga Dyseldorfi për në Shtutgart në pasditën e 16 janarit 1982-shën. i Xh. D.) *për me shkue mysafir* (të paftuar tek Jusuf Gërvalla-shën. i Xh. D.) *e kemi thënë që Insha Allah (*Jusufi-shën. i Xh. D*.) do të na thirrë mysafir se aty kanë qenë edhe qëllimet e fundit që prapë me u ulë, prapë me ba kompromise pamvarësisht që s'u muarën vesh se duhet me i vazhdua demonstratat duhet me e vazhdue aktivitetin. E kemi thënë Insha Allah* (Jusufi-shën. i Xh. D.) *na thirrë mysafir, ose ishalla, në fund tash kjo shprehja Insha Allah është pak fetare, po në fund kemi dëshirua që prapë me u ulë e me e bashkua në të njejtin nivel si përpara. E nëse nuk thirrë e kemi pasë bërë plan me shkua mysafir te Ky (*Faridin Tafallari-shën i Xh.D*.).*

Xhafer Durmishi: "*Po keni qenë edhe tek Ky (*Faridin Tafallari-shën. i Xh. D.) *Ti edhe Kadriu."*

Ibrahim Kelmendi: "*Kemi qenë. Edhe mundem me të tregua pikë për pikë se me çfarë qëllimi kemi shkuar, edhe çfarë relacioni kemi pasë. Kur jemi çue Ai* (Kadri Zeka-shën. i Xh. D*.) tha po shkoj tek Faridini.* (Jusufi-shën. i Xh. D.) *tha jo. Ky* (Faridin Tafallari-shën. i Xh. D.) *e din, e e dinë edhe të tjerët. Edhe Nuhiu (Sylejmani) e dinë nëse don ta pranon, se ka qenë aty."*

Faridin Tafallari: "*Në atë moment Nuhiu nuk ka qenë aty se ai ka dalë më herët. Përndryshe ai rregullisht ka dalë i fundit.* (Për ta thënë fjalët e fundit)*."* (Fjalë të incizuara në magnetofon nga Mbledhja e Qendrës Ekzekutive në Gjenevë, më 3 mars 1984, Kaseta 2, pjesa e parë, minutat 09.00-12.00)

Sheradin Berisha: "*Ibrahim Kelmendi - Më vjen keq, ky narracion i ndërtuar prej teje viteve të fundit dhe si të tillë të shkruar e botuar edhe ne librat: "Atntatet" dhe "Lëvizja e përgjakshme...", nuk janë të bazuar në zhvillimet reale të asaj kohe!*
Ngjarjet historike nëse zbukurohen ato demantohen nga dëshmitë arkivore!
Prandaj narracionin që ke ndertuar për dasmën e Kadriut dhe se gjoja jeni ftuar nga Jusufi me letrat e 15 janarit 1982, që të shkonit në shtëpinë e tij në Untergrupenbach, janë të zbukuruara, për të mos thënë janë të pavërteta!
Vetë letrat e Jusufit të shkruara me 15 janar 1982 për Ty dhe Kadriun e demantojnë këtë gënjeshtrën tuaj të thënë në libra dhe në komentin e mësipërm!
Kadri Zeka ne Dyseldorf te ti ka ardhur më 12 janar 1982, (3 dite para letrave te 15 janarit) dhe Jusufi nuk ka qenë në dijeni se Kadriu është në Gjermani. As Kadriu as ti nuk e keni njoftuar Jusufin se jeni bashke në Dyseldorf! Po ta dinte Jusufi se Kadriu është bashkë me ty në Dyseldorf, nuk kishte arsye t'ju shkruante letra me 15 janar, dhe aq me pak ka pas arsye t'ju shkruaj letra nëse ju të dy (ti dhe Kadriu) do të ishit te ftuar për daten 16 janar në takimin e Bernhsusenit (në shtëpinë e Murat Kryeziut).
Edhe fjalimi juaj i mbajtur me 3 mars 1984 ne Gjeneve, (shiko Youtuben) për këtë çështje Ju demanton!
Më 16 janar për në Shtutgart ju ka njoftuar dikush tjetër, jo Jusufi!
Prandaj i nderuar Ibro, nuk është mirë me shtrembu të vërtetën, sepse a e sheh ka ardhur momenti me dëshmi tuaja, veten me demantu!" (15 janar 2021)

Sheradin Berisha: "*Ibrahim Kelmendi, Këto dëshmi ta demantojnë komplet pjesën e parë të librit 'Lëvizja e përgjakshme', saktësisht narracionin tuaj për vitet 1981 - 1984! Si shkrimet tuaja lidhur me këtë temë, të botuar viteve të fundit!*" (15 janar 2021)

Faridin Tafallari: *"Ndejtëm aty deri vonë; nga mesnata u ndamë. Kur dolëm jashtë dhe po ndaheshim, unë i thash Kadriut që të vinte tek unë për të fjetur. Kadriu pranoi dhe i tha Jusufit: "Unë po shkoj te Faridini". Por Jusufi iu përgjigj: "Jo, sonte do të vish tek unë." Kadriu përsëri i tha: "Ti mund të kesh mysafirë në shtëpi dhe bëhemi shumë vetë; prandaj po shkoj te Faridini." Por Jusufi e mori me vete dhe për atë natë u ndamë pasi u përqafuam. Sikur ta dinim që ai do të ishte përqafimi i fundit.!!*
Nuk më kujtohet ai i thanë apo jo edhe Ibrahim Kelmendit që edhe ai të shkonte me ta, por di se Ibrahimi i tha: "Mua më duhet të udhëtoj për Dyseldorf, pasi edhe atje dua t'i tuboj bashkatdhetarët për të shfaqur këta filma." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 49)
Hasan Mala (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, f. 382)

Xhafer Shatri (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...".* (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, f. 382)

11. Rëndësia e shtëpisë së Jusuf Gërvallës

Emrush Xhemajli: "*Më 17 janar 1982 u mbajt takim në Helbron afër Shtutgartit, në mes të vëllezërve Gërvalla, Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit, ku temë kryesore, sipas Ibrahim Kelmendit, ishte bashkimi i organizatave, OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së. Edhe pse u arrit pajtueshmëri, ky bashkim nuk arriti të shpallet për shkak të vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, që ndodhi natën e 17 janarit.*

Pavarësisht se çka do të thonë materialet që u shkruan më 17 janar 1982 Nga Jusufi, Kadriu, Bardhoshi, e ato kanë për të thënë shumë, takimi i Untergrupenbahut do të mbetet momenti më i rëndësishëm në formimin e LPK-së". (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f. 249-250)

Untrergrupenbahu është baza më e rëndësishme e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës për shkak se aty kanë jetuar Jusufi dhe Bardhoshi, dhe jo për arsye të mysafirëve që i ka qitë rruga për interesa të veta.

Emrush Xhemajli: "*Debati për bashkimin e forcave nga Evropa Perëndimore u rikthye në Turqi. Këtë radhë në mes të LNÇKVSHJ-së dhe PKLMSHJ-së, OMLK-ja iu bashkua LRSHJ-së, më 15 maj 1982, pas takimit që u mbajt në afërsi të qyteti Biel të Zvicrës." (*Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, *f. 250)*

Emrush Xhemajli: "*Momenti i deklarimit të formuar të LRSSHJ-së, 17 shkurti 1982, ditë më ditë një muaj pas vrasjes së Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, më 17 janar 1982 në shumë qarqe u përjetua edhe emocionalisht si fitore e madhe për arritjen e një pritshmërie. Ndërsa përzgjedhja e datës së bashkimit 1 muaj pas vrasjes në Shtutgart, interpretohej si e zgjedhur me qëllim, si hakmarrje kundër terrorit të okupatorit*." (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f.250)

Emrush Xhemajli së bashku me rrethin e vetë, nga viti 1985, i kanë dënuar bashkimet e 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, me shpresën se vetë do të krijojnë ndonjë datë më të rëndësishme, e kanë riogranizuar OMLK-në e Kadri Zekës, me qëllim të **DOMINIMIT ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT** dhe e kanë udhëhequr deri në shembjen e Murit të Berlinit. Vetëm pas shembjes së Murit të Berlinit, falimentimit të etiketave marksiste-leniniste, pas 30 vitesh, riorganizuesit marksist-leninistë riorentohen e mundohen të tregojnë rëndësinë e shtëpisë së Jusuf Gërvallës dhe Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

12. DISA KURTHA LOGJIKE DHE SKEMA TË GABUARA

12-1. Vërtetimi i teoremave në Matematikë

Ekzistojnë metoda të ndryshme të vërtetimit të teoremave, ligjeve të matematikës. Një teoremë vlen vetëm e vetëm nëse është e sakët në të gjitha rastet, nëse nuk ka përjashtim për asnjë rast. Në matematikë dhe logjikë, si fjalë e kundërt me të vërtetën nuk përdoret shprehja gënjeshtër por vetëm fjalët, *True* or *false* (po i përdori termat në anglisht). Nëse ekziston vetëm një përjashtim në mesin e miliarda e miliarda rasteve teorema nuk vlen. Gjatë analizimit dhe vërtetimit të teoremave, në rastin e parë të hetimit të ekzistencës së përjashtimit procedura e vërtetimit ndërpritet menjëherë.

12-2. Sa kushton një gënjeshtër në vepra historike

Në aritmetikë vlera e numrit -2 kompensohet me vlerën e +2. Në ekonomi, nëse dikujt ia ke borxh 10 euro, lirimi prej atij borxhi të kushton vetëm 10 euro, me rentë apo pa rentë.

Në libra historik një gënjeshtër nuk të kushton vetëm një të vërtetë por gënjeshtra e infekton komplet tregimin e ngjarjes. Për me e demaskua një gënjeshtar, për njerëzit e arsyeshëm mjafton me dy-tri raste me e vërtetua se komplet tregimi është gënjeshtër.

12-3. Qeliza e fundit e kancerit një mjekësi

Për dallim nga matematika, ekonomia e historia, në mjekësi, mjekët kanë obligime krejt tjera. Kirurgët kur e bëjnë operacion dikend prej kancerit, luftojnë ta operojnë e ta gjejnë me ndihmën e mikroskopave elektronik edhe qelizën e fundit të kancerit.

12-4. Shkaku i vrasjes së Kadri Zekës sipas Apostol Dukës

Apostol Duka: *"Kadri Zeka u vra **SEPSE** në orët e vona të natës tragjike të 17 janarit shfaqi dëshirën po aq njerëzore të shkëmbente, përmes **telefonit që ndodhej rrugën matanë shtëpisë** së Jusuf e Bardhosh Gërvallës, dy fjalë zemre. Dhe luftëtarët profesionistë, njëlloj si aviatorët, marinarët dhe minatorët, gabojnë vetëm një herë në jetë."* (Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 392)

Pse u vra Kadri Zeka, sipas biografit të tij Apostol Duka?

Sepse ka dashtë të shkëmbente dy fjalë zemre. Pra sipas biografit Apostol Duka motivi politik bien në rend të dytë. Po të mos e kishte bërë atë gabim, të vetmin në jetë, Kadri Zeka nuk do të vritej dhe para një rreziku të tillë nuk do të ndodhej më në jetë. Po të mos e kishte bërë atë gabim Kadri Zeka, të vetmin në jetë, vrasësit që e kishin rrethuar shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla do të kthehesin nëpër shtëpitë e tyre, si gjahtarët kur kthehen në mbrëmje nëpër shtëpia dhe i ankohen njëri-tjetrit se sa për pak i ka shpëtua lepuri.

Vëllezërit Gërvalla nuk janë vra për shkak për punëve private e bisedave private, dhe as për shkak të aktivitetit politik të maskuar me ide komuniste, të Kadri Zekës, por vetëm e vetëm për shkak të luftës së tyre nacionalçlirimtare për popullin shqiptar nën Jugosllavi. Vrasësit e Serbisë e kanë rrethua shtëpinë e tyre sepse aty ka banuar Jusuf Gërvalla dhe jo për shkakun pse aty qenë mysafir rasti Kadri Zeka, i cili sipas Apostol Dukës dhe informatorëve të tij, ka ardhë gabimisht, ka ardhë për me gabua, ka ardhë për ta bërë të vetmin gabim në jetë.

12-5. Tri gënjeshtra historike për Kosovën

Mehmet Hajrizi: *"**Në natën** e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e **tri organizatave** çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)

Jusuf Gërvalla nuk e ka ftuar Kadri Zekën të vjen nga Dusseldorfi tek ai në Shtutgart. Kurrfarë bisedimesh për bashkim nuk janë bërë. Tezat e Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, Jusufi, pas kthimit nga panairi i librit në Frankfurt i ka hedhur në shportën e mbeturinave dhe për atë veprim kurrë nuk është pendua. Këtë e dëshmojnë të gjitha letrat e tij të shkruara pas dështimit të bisedimeve për bashkim në mes Kadri Zekës e Sabri Novosellës, në Stamboll, në mesin e tetorit 1981.

Jusuf e Bardhosh Gërvalla nuk janë vra pse kanë biseduar si me mysafir me Kadri Zekën, dhe as për veprimtarinë e OMLK-së, as për ideologjinë e maskuar e të rrejshme të revistës "Liria" të OMLK-së. Jusuf e Bardhosh Gërvalla nuk janë kurrfarë sendërtuesish të ndonjë bashkimi me Kadri Zekën. Jusuf e Bardhosh Gërvalla janë rrethuar nga UDB-ja jo pse e kanë pasë mysafir Kadri Zekën por vetëm e vetëm për shkak të luftës së tyre nacionalçlirimtare për popullin shqiptar nën Jugosllavi, për luftën e tyre të vërtetë, për ide të vërteta, janë vra si udhëheqës të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi.

OMLK-ja nuk ka pushua së vepruari më 17 janar 1982. Ajo ka vepruar deri në shembjen e murit të Berlinit. Vetëm pas shembjes së murit të Berlinit OMLK-ja e kupton se veprën e Jusuf Gërvallës nuk e tund asnjë tërmet. Vetëm atëherë e kuptojnë se tërmeti i Berlinit e ka lënë të paprekur shtëpinë e Jusuf Gërvallës, i kthehen asaj, gjithnjë me qëllimet më djallëzore.

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *(Zëri i Kosovës-shën i Xh.D.)* ***PËR TË CILËN E KA DHËNË JETËN BURRI DHE KUNATI IM*** *e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

12-6. Kadri Zekës i binte barra e realizimit të projektit të Frontit

1. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Ibrahim Kelmendit
2. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Fazli Veliut
3. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Abdullah Prapashticës
4. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Sabri Novosellës
5. Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Jusuf Gërvallës

Mehmet Hajrizi: *"Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (****sipas dëshmisë së bashkëveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit****) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008 f. 307)

Mehmet Hajrizi thotë se Kadri Zeka ka qenë udhëheqës i padiskutueshëm si brenda OMLK-së ashtu edhe i pranuar nga të gjithë aktivistët e organizatave tjera. Të gjitha rrymat kanë qenë të përçara në mes veti. Vetëm OMLK-së ka qenë në qendër dhe e papërçarë me askënd. Çdo kush që ka pas mosmarrëveshje a keqkuptime, mos-përputhje, është drejtuar me ankesën e vetë tek instanca më e lartë tek instanca supreme -gjykatësi, kadia - Kadri Zeka.

I. Kelmendi*: "Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende* ***nuk ke anëtarësuar njeri*** *vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni." (Atentatet, f.293)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

I. Kelmendi***: "OMLK-ja... Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës." (****Atentatet, f. 330)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

1.Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Ibrahim Kelmendit

”*Ky dokument ishte një bazë e mirë për t’u zhvilluar bisedime për themelimin e një fronti popullor, bashkim e centralizim të lëvizjes patriotike e komuniste të Kosovës. Për këto qëllime, në tetor të vitit 1981 Kadri Zeka me Bardhosh Gërvallën udhëtojnë në Turqi për bisedime që mundësisht të arrihej bashkimi në baza të ”Tezave…” në mes OMLK-së dhe LNÇKVSHJ,* ***pasi më parë ky bashkim ishte arritur me FKP*** (Frontin e Kuq Popullor-shën. ynë).” (Kadri Zeka, Vepra, Biblioteka ”Liria” Buchhandlung Badhausstr. 35, 2503 Biel-Bienne, Zvicër, korrik 1986, faqe 18)

Kadri Zeka është bashkuar me Ibrahim Kelmendin, **para** dështimit të bisedimeve me Sabri Novosellën në Stamboll, në mesin e tetorit 1981. Ibrahim Kelmendi së bashku me Kadri Zekën kanë bërë fushatë kundër Jusuf Gërvallës nëpër Gjermani e Zvicër. Pas vdekjes, 25 vjet pas vitit 1982, më 2007 Ibrahim Kelmendi e hedh poshtë rolin udhëheqës të Kadri Zekës dhe nuk e pranon si person qendror dhe e mohon se është bashkuar me te. Rolin e personit qendror Ibrahim Kelmendi e ka të rezervuar vetëm për veten. Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla sipas I. K. kanë qenë shumë të përçarë ndërsa ai ka pasur raporte shumë të mira si me njërin ashtu edhe tjetrin. Ibrahim Kelmendi, si refer e gjykatës qendror në dasmën e Kadri Zekës i ka pajtuar Jusufin e Kadriun. Edhe Jusufi edhe Kadriu, gjithnjë sipas I. K. E pranojnë Ibrahim Kelmendin si refer e gjykatës.

Sa i përket projektit të Frontit të Mehmet Hajrizit, Ibrahim Kelmendi thotë se Fronti Popullor për Republikën e Kosovës është sakrifikuar nga Kadri Zeka për mos e turpnue, e mos e skuqë Frontin e Kuq, Frontin e Tanjugut, për cilin Front Jusuf Gërvalla ka dyshuar se në qendër të tij qëndron UDB-a, dhe në bazë të atyre dyshimeve i ka ndërpre të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin, pas numrit të fundit të gazetës ”Bashkimi” në janar 1981.

Ibrahim Kelmendi: *”Emërtimi bazë i organizatës së re qe vendosur të ishte LËVIZJA, edhe për shkak se emërtimin FRONT e kishim konsumuar ne të Frontit të Kuq Popullor.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 183-184)

Ky pra është thelbi i kudretit të Kadri Zekës kundrejt Ibrahim Kelmendit.

2.Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Fazli Veliut

Fazli Veliu: ”*E shoh të arsyeshme të sqaroj se, ky bashkim është arritur më 1 e 2 janar të vitit 1982, në dasmën e Kadri Zekës, në Zvicër, kur të gjithë pjesëmarrësit, krushqit e dasmës ose të lirisë, pas fjalimit të Kadri Zekës, dhanë betimin për bashkim të radhëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo ngjarje e bashkimit shënohet pas rënies së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Badhosh Gërvallës, nga veprimtarët e të gjitha viseve të cilët çonin në vend mesazhet e të rënëve për liri, duke u betuar në veprën e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, në vazhdimin e luftës deri në fitore për çlirim e bashkim kombëtar. Për këto që përmendëm, kemi fakte, shënime drejtpërsëdrejti, incizime dhe filma, të cilët do t’i dorëzojmë te shtypshkronja, kur të botohet libri për këto.*

Autori i këtij punimi pati një bisedë të gjatë, kokë më kokë më shumë se katër orë, me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, më shumë se një orë me Bardhosh Gërvallën poashtu.” (Lëvizja; Themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë 17 shkurt 2017, f.199-200)

Fazli Veliu nuk e pranon rolin udhëheqës, rolin qendror të Kadri Zekës, rolin e padiskutueshëm as në dasmën e tij, ashtu si mundohet ta paraqes Mehmet Hajrizi. Rolin qendror, rolin e referit, rolin e gjykatësit neutral Fazli Veliu e ka të rezervuar vetëm për veten e tij. Në këtë rol të referit e të gjykatësit, ai ka biseduar e i ka saslushit kokë më kokë, Jusufin

e Kadriun katër orë, dhe me shumë se një orë me Bardhoshin. Ky pra është thelbi i kudretit të Kadri Zekës kundrejt Fazli Veliut.

3.Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Abdullah Prapashticës

Abdullah Prapashtica nuk e pranon rolin e Kadri Zekës si udhëheqës qendror, të gjykatësit neutral, për punët e bashkimit. Ai nuk e pranon atë rol, siç mundohet ta paraqes Mehmet Hajrizi. Pse? Sepse Abdullahu, rolin e ideologut largpamës e të padiskutueshëm, rolin e referit e të gjykatësit neutral e ka të rezervuar vetëm për veten e tij. Falë largpamësisë së tij, nën influencën e tij bien të gjithë dhe mezi presin të udhëhiqen nga ai. Me udhëzimet e tij shpjegohet se si duhet me ardhë deri tek për-puthja e të gjithëve nën pararojën e Partisë Komuniste. Fakti se Jusufi e Kadriu **për-puthen** plotësisht me Abdullah P., merret vesh nga UDB-a dhe ajo kryen atentat jo ndaj Abdullahut, por vetëm ndaj mashave të tij. Ky pra është thelbi i kudretit të Kadri Zekës kundrejt Abdullah Prapashticës.

4.Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Sabri Novosellës

Hasan Mala: *"Kur është kthye Kadriu prej mbledhjes (në Stamboll - shën i Xh. D.) që kanë pas, unë kam qenë në panairin e librit në Frankfurt. Ishte edhe Ismail Kadareja, ishte edhe Isufi aty. Pak a shumë u njifshim me Isufin, por jo sa duhet. Kisha një respekt ndaj tij, ishte njeri i afërt. Vjen Kadriu aq i lodhur e aq i mërzitur sa nuk mundet me u marrë me mend, dhe më kapi për krahu e u ulëm rreth një tavoline.*

- Çka u bë puna si kaluat atje?

- Kurrqysh hiq nuk kemi kalue!

- Si?

- Nuk kemi mund të bëjmë asgjë, por frikohem se është prishë puna edhe më shumë." (Marrë nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1997)

Saime Isufi: "*Më 18 tetor të vitit 1981, u nisa përsëri për në Zvicër. Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe* ***pastaj*** *kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën. Në banesën e tij na priti Hasan Malaj, mua dhe Berat Luzhën. Me Hasanin, që atë natë udhëtuam diku në Gjermani për të marrë Kadriun. U takuam me Kadriun. Dukej shumë i lodhur, i rraskapitur, por edhe i dëshpëruar nga takimi që kishte pasur me Sabri Novosellën.*

Ai nuk i kishte përfillur, bile i kishte fyer e poshtëruar atë dhe Bardhosh Gërvallën." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.98)

Ky pra është thelbi i kudretit të Kadri Zekës kundrejt Sabri Novosellës.

5.Kudreti i Kadri Zekës kundrejt Jusuf Gërvallës

Raportin e Kadri Zekës me Jusuf Gërvallën e kam shqyrtuar në hollësi në librin ”Lëvizja e Jusuf Gërvallës”, dhe në një pjesë të mirë në këtë punim, duke u bazuar 100% në faktet e lëna nga Jusuf Gërvalla. Prej kontakteve të para Jusufi i ofron çdo ndihmë Kadri Zekës e OMLK-së. Kjo ndihmë e pakursyer keqinterpretohet nga OMLK-ja dhe merret si dobësi e si dëshirë masoshiste e Jusufit për t’u dominuar nga Kadri Zeka dhe shokët e tij. Kjo lojë e OMLK-së me Jusuf Gërvallën dështon, merr fund përjetësisht më 15 tetor 1981 në Stamboll, gjatë takimit të Kadri Zekës me Sabri Novosellën e Bardhosh Gërvallën.

Sabri Novosella nuk i shkruan Jusufit për rrjedhën e bisedimeve në Stamboll. Pse? Sepse dëshmitar i bisedimeve ka qenë Bardhosh Gërvalla i cili e informon Jusufin për çdo fjalë që

është thënë. Jusufi informohet për bisedimet edhe nga Kadri Zeka në panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

Jusufi i shkruan Sabri Novosellës një letër më 5 nëntor 1981, ku e jep mendimin e vetë për dështimin e takimit të Stambollit. Fakti vendimtar për përdorjen e shprehjeve të ndryshme të Jusufit në këtë letër janë përshtypjet e këqija që i ka nga takimi e shpjegimet e Kadri Zekës në Frankfurt.

-Jusufi pajtohet tërësisht me qëndrimet e mbajtura nga Sabri Novosella në Stamboll,
-Qëndrimet e Kadri Zekës e OMLK-së për bashkimin i quan të çoroditura,
-Ato qëndrime të çoroditura Kadri Zeka as rastësisht nuk ka pasur guxim me ia shpreh Jusuf Gërvallës në Gjermani, por ka menduar se ato ide të çoroditura mund të shiten vetëm në pazaret e Turqisë
Jusufi i quan Kadri Zekën dhe shokët e tij:
-megaloman,
-arrivist të revolucionit (arrivizëm= synimi për të çarë përpara, për të arritur një vend më të lartë në shoqëri e për të bërë karrierë me çdo mjet, edhe me mënyra të pandershme.)
-njerëz me ndjenja të epërsisë boshe mbi të tjerët,
-njerëz që duan t'i dominojnë të tjerët me çdo kusht
-njerëz të pasinqertë,
-njerëz që nuk e kanë merituar ndihmën e tij,
-njerëz që kanë bërë lojë të pahijshme me personin e tij.

Me iniciativë të Kadri Zekës bëhet organizimi i festës së 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart, kur marrin pjesë vetëm aktivistët nga Zvicra dhe aktivistët nga rrethina e Shtutgartit. Po me iniciativë të Kadri Zekës vendoset që aktivistët e Gjermanisë veriore të mblidhen në Dusseldorf e të mos vijnë Shtutgart. Qëllimi i Kadri Zekës me festën në Shtutgart është përgatitja e terenit për një thirrje të rrejshme për një bashkim të rrejshëm, me titull "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!". Jusufi në festën e 28 Nëntorit nuk ka dijeni për ekzistencën e thirrjes "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"

Për këtë mbrëmje Jusufi e përgatitë fjalimin kryesor dhe e lexon, ku në mes tjerash u drejtohet të gjithë aktivistëve të Shtutgartit dhe Zvicrës, përfshi edhe Kadri Zekën:

Jusuf Gërvalla: "*Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike e revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj.* ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e "politikës së madhe", lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë****, dhe ato që janë organizuar prej elementësh të dyshimtë e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit, i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar."* (T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS)

Me fjalët "***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e "politikës së madhe", lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë"*** Jusufi e ka fjalën pikërisht për Kadri Zekën dhe OMLK-në.

Jusufi, në sallë në prani të 150 aktivistëve të Zvicrës dhe Kadri Zekës, e lexon fjalimin ku (në thelb) thotë:

(-OMLK-ja) është organizatë që bënë lojën e "politikës së madhe",
(-OMLK-ja) është organizatë që bënë lojën e arrivizmit revolucionar,
(-OMLK-ja) është organizatë që udhëhiqet nga karrieristë megalomanë.

Me fjalët "*dhe ato që janë organizuar prej elementësh të dyshimtë e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit"* Jusufi i ka parasysh veprimet e Abdullah Prapashticës. Jusufi i përdorë këto fjalë vetëm duke u bazuar në përmbajtjen e letrave personale që ia ka dërguar Sabri Novosella gjatë nëntorit 1981.

Rreth 7 dhjetorit 1981, Jusufit i vjen thirrja e rrejshme për bashkimin e rrejshëm me titull "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!". Jusufi në praninë time, brenda ditës ia kthen Kadri Zekës përgjigjen, ku në thelb i drejtohet:

-Përmbajtja e Thirrjes është e rrejshme,
-Thirrja nuk është taze, nuk është e freskët por është shkruar shumë më heret,
-Gënjeshtra nuk është taze, nuk është e freskët por është gatuar shumë më heret,
-Me këto gënjeshtra e manovrime keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer,
-Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e gënjeshtrave.

Pas këtyre fjalëve Kadri Zeka dhe OMLK-ja nuk kanë guxim me dalë publikisht me thirrjen e tyre të rrejshme: "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"

Në këtë lloj "afërsie" e "mirëkuptimi" e atmosfere është bërë dasma e Kadri Zekës me Saime Jusufin më 2 janar 1982. Ditët para e pas dasmës janë ditët e fushatës së Kadri Zekës e Ibrahim Kelmendit kundër Jusuf Gërvallës si person *që është i vetmi që ka dalë kundër bashkimit, në kohën kur të gjithë janë për bashkim.*

Letra e Jusuf Gërvallës dërguar Ibrahim Kelmendit më 15 janar 1982, vërteton se nuk ka ndryshim raportesh në mes Jusufit e Kadriut, për asnjë milimetër prej 17 tetorit 1981 e deri më 15 janar 1982. Letra e 15 janarit demaskon gënjeshtrat e Ibrahim Kelmendit për pajtim në dasmë dhe gënjeshtrat e Fazli Veliut për bashkim në dasmë.

Në letrën e 15 janarit, Jusufi, në thelb, shkruan:

-misioni i bashkimit është i shenjtë për ne,
-ky bashkim do të bëhet kur të vijë koha,
-ky bashkim do të bëhet nga njerëzit e vërtetë e punëve të vërteta
-ky bashkim nuk do të bëhet nga njerëzit që përhapin gënjeshtra e bazohen në gënjeshtra
-kush janë ata që përhapin gënjeshtra dhe bazohen në gënjeshtra më 15 janar 1982
-Janë askush tjetër pos Kadri Zeka dhe shoku i tij organizativ Ibrahim Kelmendi.

Fjalët që Jusuf Gërvalla ia thotë Kadri Zekës dhe OMLK-së në festën e 28 Nëntorit 1981, i boton në *Zërin e Kosovës* që ka dalë në janar 1982. Për këtë citat më poshtë është fjala dhe për të cilin shkruan Ibrahim Kelmendi në romanin *Atentatet*.

Jusuf Gërvalla: "*Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike e revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e* ***organizata****, që bëjnë*

-lojën e "politikës së madhe",
-lojën e arrivizmit revolucionar,
-të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë *(OMLK-shën i Xh.D.),*

dhe ato që
-janë organizuar prej elementësh të dyshimtë
-e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe
-sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit, (PKLMSHJ-shën. i Xh.D.) i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar."
(T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS**,** Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 1-2)

Ky pra është thelbi i kudretit të Kadri Zekës kundrejt Jusuf Gërvallës.

Kadri Zeka ka trokitur në derën e shtëpisë së Jusuf Gërvallës në *Habichthöhe 40, Untergruppenbach* të shtunën në mbrëmje më 16 janar 1982 si person i **paftuar**. Si i **paftuar** që ka qenë nuk e gjen Jusufin në shtëpi, pasi ai në atë moment është 70 km larg shtëpisë së tij.

12-7. Shkaku i vrasjes sipas Hasan Malës

*"Apostol Duka: -U arritë ky bashkim, ose shkrirja e **dy organizatave** në një të vetme, nëse mund të shprehemi kështu?*

***Hasan Mala:** - Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të **dyja organizatat** të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej 'Liria'. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e Frontit, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

Ibrahim Kelmendi: *"Emërtimi bazë i organizatës së re qe vendosur të ishte LËVIZJA, edhe për shkak se emërtimin FRONT e kishim konsumuar ne të Frontit të Kuq Popullor."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 183-184)

Sa i përket Frontit të Hasan Malës, Ibrahim Kelmendi, në librin *Gjurmë dhe fërkem* thotë se Fronti Popullor për Republikën e Kosovës i OMLK-së është sakrifikuar nga Kadri Zeka për mos e turpnue, e mos e skuqë Frontin e Kuq, Frontin e Tanjugut, për të cilin Front Jusuf Gërvalla ka dyshuar se në qendër të tij qëndron UDB-a, dhe në bazë të atyre dyshimeve i ka ndërpre të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin, pas numrit të fundit të gazetës "Bashkimi" në janar 1981.

12-8. Shkaku i vrasjes sipas Abdullah Prapashticës

Abdullah Prapashtica: *"Kështu Lëvizja për Pavarësinë e Kosovës në fazën e vet përfundimtare, u krijua me iniciativën e Partisë Komuniste MLSHJ e cila ju bëri thirrje për bisedime për bashkim LNÇKVSHJ dhe OMLK. Këto thirrje për bisedime me shkrim ju drejtuan Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës që gjendeshin në Evropë, përmes të Sabri Novosellës që në atë kohë gjendej në Adapazar të Turqisë. (...) Sipas të gjitha gjasave fillimi i këtyre bisedimeve për bashkim nuhatet nga regjimi titoist dhe për te e penguar realizimin e bashkimit ton, Beogradi zyrtar jep urdhër UDB për vrasjen e Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës ne Gjermani."* (DËSHMI E NJË NGJARJE HISTORIKE, 17 shkurt 2008, http://kosova.albemigrant.com)

Abdullah Prapashtica nuk e pranon rolin e Kadri Zekës si udhëheqës qendror, të gjykatësit neutral, për punët e bashkimit. Ai nuk e pranon atë rol, siç mundohet ta paraqes Mehmet Hajrizi. Pse? Sepse Abdullahu, rolin e ideologut largpamës e të padiskutueshëm, rolin e referit e të gjykatësit neutral e ka të rezervuar vetëm për veten e tij. Falë largpamësisë së tij, nën influencën e tij bien të gjithë dhe mezi presin të udhëhiqen nga ai. Me udhëzimet e tij shpjegohet se si duhet me ardhë deri tek për-puthja e të gjithëve nën pararojën e Partisë Komuniste të Abdullahut. Fakti se Jusufi e Kadriu për-puthen plotësisht me Abdullahun, merret vesh nga UDB-a dhe ajo kryen atentat jo ndaj AP, por vetëm ndaj mashave të tij.

12-9. Shkaku i vrasjes sipas Ibrahim Kelmendit në romanin *Atentatet* dhe librin *Lëvizja*

Ibrahim Kelmendi të gjitha gënjeshtrat rreth bashkimit dhe "*ftesës*" së Jusuf Gërvallës për gjoja bashkim me Frontin e Kuq të Tanjugut i ka demantua me gojën e vetë në një incizim magnetofonik, në një mbledhje të mbajtur në Gjenevë, më 3 mars 1984. Aty demaskohen të gjitha gënjeshtrat e veta të bëra në librin *Atentatet* dhe *Lëvizja* dhe vepra e tij prej detektivi.

12-10. Lidhja e shkakut të vrasjes së Jusuf Gërvallës me organizata të jashtme

Nga gënjeshtrat e Apostol Dukës, Mehmet Hajrizit, Hasan Malës, Abdullah Prapashticës, Ibrahim Kelmendit jepen arsyetime për vrasjen e Jusuf Gërvallës duke e lidhur me organizata të huaja, me organizata të jashtme, me gazeta të jashtme, ndaj të cilave Jusuf Gërvalla ka qenë i pavarur në tërë jetën e tij, dhe kurrë nuk ka pasur as obligimin më të vogël ndaj tyre. Ato i ka ndihmua vetëm i udhëhequr nga ndërgjegjja e pastër. I ka ndihmua deri sa e ka pa se nuk e meritojnë ndihmën e tij. Me Frontin e Kuq e me Ibrahim Kelmendin i ka ndërpre të gjitha marrëdhëniet pas rastit të dërgimit të Hysen Gegajt në duart e UDB-së serbe. Kadri Zekës dhe OMLK-së ia ka ndërpre të gjitha ndihmat (të cilat edhe ashtu, kurrë nuk ua ka pasë borxh) pas 17 tetorit 1981 deri në vdekje, do me thënë pas 17 tetorit 1981 e deri në përjetësi.

12-11. Paaftësia për punë të pavarur

Në bazë të pikës së mësipërme e gënjeshtrave të demaskuara, është qëllimi të krijohet përshtypja se Lëvizja e Jusuf Gërvallës nuk ka qenë në gjendje të bëjë punë të pavarur asnjëherë. Nga kjo duhet të nxirret ky rrjedhim:

-Vlera e Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e lidhur me Ibrahim Kelmendin,

-Vlera e Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e lidhur me Kadri Zekën,

-Vlera e Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e lidhur me Abdullah Prapashticën.

Është pikërisht e kundërta:

-Vlera e Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e pastruar nga gënjeshtrat e Ibrahim Kelmendit, e pastruar nga Fronti i Kuq i Tanjugut, për të cilin Jusuf Gërvalla me baza shumë të forta ka dyshuar se është krijesë e UDB-së dhe nën këtë dyshim i ka ndërpre të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin pas daljes së numrit të fundit të Bashkimit në janar 1981.

-Vlera e Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e pastruar nga gënjeshtrat, manipulimet, manovrimet, jo sinqeriteti, megalomania dhe idetë e çoroditura të OMLK-së; të Kadri Zekës, Mehmet Hajrizit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës, Hasan Malës e ndonjë tjetri. Me taktikat, me metodat dhe me praktikat e OMLK-së Jusuf Gërvalla është shkëputur përjetësisht më 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt.

-Vlera e Jusuf Gërvallës dhe e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si e pastruar nga gënjeshtrat, megalomania dhe idetë e çoroditura të Abdullah Prapashticës, i cili me Partinë e tij komuniste e ka pasë të njëjtën ëndërr sikurse OMLK-ja e Kadri Zekës, që nën

maskën e etiketave komuniste me qenë pararojë e dominuese e të tjerëve. E arritura më e madhe në karrierën e Abdullah Prapashticës është për-puthja me mulla Hamitin dhe mulla Izet Tashollin.

12-12. *Ftesat* nga pozita superiore, të barabarta apo inferiore

Një kurthë djallëzore për mendjet naive është zhurma rreth *ftesave*, kush po e fton kend. Ibrahim Kelmendi duke gënjyer ka bërë zhurmë të madhe se puna e parë që e ka bërë Jusuf Gërvalla pas arratisjes nga Kosova është se e ka thirr Ibrahim Kelmendin e iu ka lutur me ia shkrua përmbajtjen e *Bashkimit* të Frontit të Kuq. Puna e fundit në jetë e Jusufit është krejtësisht identike me punën e parë. I telefonon, indirekt, Ibrahim Kelmendit the e thërret për punë të *bashkimit*. Zhurmë dhe gënjeshtra për *ftesën* e fundit në jetë të Jusufit bëhet nga shokët e Kadri Zekës, dhe në filmin dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" të vitit 1997. Në mënyrë krejtësisht identike Abdullah Prapashtica gënjen se Sabri Novosella iu ka paraqitur dhe iu ka lutur të bisedoj me te për bashkimin por *molba* e tij nuk është aprovuar nga ish udbashi, sepse Sabriu nuk ka pas me vete *svedok*. Vetëm e vetëm për me e plotësua kushtin e ish udbashit, mu paska dashtë mua me udhëtua në Turqi, në shkurt të vitit 1982.

Njerëzit e painformuar dhe të padjallëzuar bien në këto kurtha djallëzore, duke i marrë këto djallëzi si komplimentin më të madh që i bëhet Jusuf Gërvallës.

-Jusuf Gërvalla është njeri i iniciativës,

-Jusuf Gërvalla është i vetmi që e di se çka duhet bërë,

-Jusuf Gërvalla me *ftesat* e tij ka treguar superioritetin e tij.

Djallëzitë mbesin vetëm djallëzi. Qëllimi i vërtetë me zhurmën e *ftesave* është të mbillet gënjeshtra dhe djallëzia e stilit:

-Jusuf Gërvalla e *fton* Ibrahim Kelmendin sepse nuk mund të bëjë asgjë pa Ibrahim Kelmendin. Ibrahim Kelmendi nuk ka asnjë nevojë për Jusuf Gërvallën, Jusuf Gërvalla ka çdo nevojë për Ibrahim Kelmendin.

Jusuf Gërvalla duke e ftuar Ibrahim Kelmendin për bisedime për bashkim i deklason e asgjëson të gjitha fjalët e veta me shkrim që i ka bërë për te, pas janarit 1981, pas rastit të Hysen Gegës me Sadik Blakajn dhe rolin e Ibrahim Kelmendit në te e deri në fjalët e veta të shkruara në letrën e 15 janarit 1982.

-Jusuf Gërvalla e *fton* Kadri Zekën sepse nuk mund të bëjë asgjë pa Kadri Zekën. Kadri Zeka nuk ka asnjë nevojë për Jusuf Gërvallën.

Jusuf Gërvalla, duke e ftuar Kadri Zekën për bisedime për bashkim, e deklason dhe asgjëson qëndrimin e Sabri Novosellës në Stamboll, i asgjëson fjalët e tij të shkruara në letra, të botuara në Zërin e Kosovës. Me një fjalë e deklason dhe asgjëson çdo punë që e ka bërë për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi.

Mos me pasë qenë *ftesa* e Jusufit, Kadri Zeka e kish kaluar 17 janarin 1982 në Dusseldorf, dhe ishte kthye në Zvicër pa e pasur as interesin më të vogël me e takua Jusuf Gërvallën.

-Djallëzitë rreth *ftesave* të Jusufit janë krejtësisht identike me djallëzitë e Abdullah Prapashticës në raport me Sabri Novosellën.

Po t'i mbledhim, kombinojmë parashtrimet naive dhe djallëzore, rrjedhin këto mundësi:

-Jusuf Gërvalla telefonon e bënë *ftesa* sepse është superior,

-Jusuf Gërvalla telefonon e bënë *ftesa* për shokët që i konsideron dhe e konsiderojnë si të barabartë,

-Jusuf Gërvalla telefonon e bënë *ftesa* si njeri i përkulur, dhe me *ftesat* e tij e vulosë përkuljen dhe inferioritetin e tij ndaj Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit.

Jusuf Gërvalla nuk ka bërë kurrfarë *ftesash* nga pozita superiore e si njeri i iniciativës. Jusuf Gërvalla kurrë në jetën e tij nuk e ka pasur në ëndërr me i dominua të tjerët.

Jusuf Gërvalla nuk ka bërë kurrfarë *ftesash* nga pozita e barabartë e për shokë të barabartë. Ai e ka të pamundur me bërë *ftesa* për shokë të barabartë, pasi Kadri Zeka më 1981 e 1982 dhe as shokët e tij as atëherë dhe as sot nuk e kanë konsideruar dhe nuk e konsiderojnë Jusufin shok të barabartë.

Jusuf Gërvalla nuk ka bërë kurrfarë *ftesash* nga pozita inferiore e përkulëse dhe nuk e zhvlerëson kurrë qëndrimin e Sabri Novosellës në Turqi, nuk e zhvlerëson e nuk pendohet kurrë në jetën e tij për asnjë fjalë të shkruar në letra private apo të botuara në gazetë. Vlera e fjalëve të Jusuf Gërvallës është e përjetshme dhe nuk mund ta zhvlerësoj askush pasi ai vetë nuk e ka zhvlerësuar por e ka dhënë jetën vetëm e vetëm për fjalët e tij të shkruara e të vërteta.

Me e pranua dikend mysafir, me i thënë rrimë një natë,

-nuk do të thotë se e ke bërë shtëpinë hotel me dhoma ekskluzive,

-nuk do të thotë se e ke bërë dikend ortak për edukimin e fëmijëve,

-nuk do të thotë se e mohon krejt veprimtarinë tënde më të ndritshme, më të pastër e më të kthjellët në shërbim të popullit,

-nuk do të thotë se ke hy në shërbim të personave me ide të çoroditura që kanë mohuar, zhvlerësuar e çoroditur çdo germë e çdo fjalë të së kaluarës së tyre.

Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi kanë trokitur në derën e shtëpisë së Jusuf Gërvallës në *Habichthöhe 40, Untergruppenbach* të shtunën në mbrëmje më 16 janar 1982 si persona **të paftuar**. Si të **paftuar** që kanë qenë nuk e gjejnë Jusufin në shtëpi, pasi ai në atë moment është 70 km larg shtëpisë së tij.

Kjo është pra anatomia e zhurmës djallëzore për *ftesat* e Jusuf Gërvallës.

12-13. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij vetëm si pjesë në periferi

Nga kurthat e djallëzive të shumta bëhet përpjekja që krijohet një përshtypje se:

-Jusuf Gërvalla ka qenë në qendër të vëmendjes e në shënjestër të UDB-së dhe është vra për të vetmin shkak se ka qenë një bisht në periferinë e Frontit të Kuq të Tanjugut, të Ibrahim Kelmendit,

-Jusuf Gërvalla ka qenë në qendër të vëmendjes e në shënjestër të UDB-së për të vetmin shkak se ka qenë një bisht në periferinë e Kadri Zekës e OMLK-së,

-Jusuf Gërvalla ka qenë në qendër të vëmendjes e në shënjestër të UDB-së për të vetmin shkak se ka qenë një bisht në periferinë e Abdullah Prapashticës.

-Jusuf Gërvalla nuk ka qenë as bisht, as qendër e as jatak i Frontit të Kuq.
Jusuf Gërvalla me baza shumë të forta ka dyshuar se qendra e Frontit të Kuq është UDB-ja.

-Jusuf Gërvalla nuk ka qenë bisht i OMLK-së, celulë e OMLK-së, kandidat i OMLK-së, kandidat për Frontin e OMLK-së. Nga kjo rrjedhë se vrasja e tij nga UDB-ja serbe nuk është bërë për fajin e Saime Isufit siç kanë shkruar Ibrahim Kelmendi dhe Apostol Duka - biografisti i Kadri Zekës.

-Vrasja e Jusuf Gërvallës nuk ka asnjë lidhje të vetme me gënjeshtrat, manipulimet, manovrimet, josinqeritetin, megalomaninë dhe idetë e çoroditura

të OMLK-së; me Frontin e OMLK-së, me Tezat për Front të OMLK-së, të Kadri Zekës, Mehmet Hajrizit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës, Hasan Malës e ndonjë tjetri. Me taktikat, me metodat dhe me praktikat e OMLK-së Jusuf Gërvalla është shkëputur përjetëshit më 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt.

-Jusuf Gërvalla nuk ka qenë bisht e praparojë e Prapashticës, e Abdullah Prapashticës. Nga kjo rrjedhë se Abdullah Prapashtica nuk ka asnjë arsye me e marrë "*fajin"* mbi vete, me e marrë mbi vete veprën e ish kolegëve të vetë. I vetmi shpëtim për pastrimin e fajeve të tij, të shpresojmë se është lidhja në namaz pas mulla Hamitit dhe mulla Izet Tashollit.

12-14. Kurtha e zhurmës për bashkim

Zhurma për bashkim është një kurthë për shumë njerëz të painformuar e që nuk duan të lodhen me mendime. Nga zhurma e shumë gënjeshtarëve për bashkim përpiqet të mbillet djallëzia se në janar të vitit 1982, pothuajse të gjitha rrugët e veprimit, në Gjermani, në toka shqiptare nën Jugosllavi, e në këtë botë për Jusuf Gërvallën dhe Lëvizjen e tij përfundimisht janë mbyllur. (Këtu nuk po e marrë parasysh rrjedhën e operacionin sekret të UDB-së por vetëm raportet nga horizontet ndërshqiptare).

E vetmja rrugë që i ka mbetur e hapur, e vetmja derë që i ka mbetur e hapur është dera e Frontit të Kuq, është dera e OMLK-së, dera e Kadri Zekës, është dera e Partisë komuniste e Abdullah Prapashticës.

Përgjigje se si duhet shpëtuar nga kjo djallëzi dhe nga kjo zhurmë është sqarimi:

-Rrugët për veprim të Ibrahim Kelmendit, në janar të vitit 1982 kanë qenë të pakufishme, pa asnjë lidhje organizative me Jusuf Gërvallën e me Lëvizjen e Jusuf Gërvallës,

-Rrugët për veprim të Kadri Zekës dhe OMLK-së, në janar të vitit 1982 kanë qenë të pakufishme dhe pa asnjë lidhje organizative me Jusuf Gërvallën e me Lëvizjen e Jusuf Gërvallës,

-Rrugët për veprim të Abdullah Prapashticës dhe Partisë së tij komuniste, në janar të vitit 1982 kanë qenë të pakufishme dhe pa asnjë lidhje organizative me Jusuf Gërvallën dhe Lëvizjen e Jusuf Gërvallës.

Nga këto tri premisa vjen shpëtimi prej zhurmës djallëzore rreth bashkimit se:

-Rrugët për veprim, rrugët për veprimtari politike, në Gjermani, në toka shqiptare nën Jugosllavi, dhe kudo në botën Perëndimore, rrugët e Jusuf Gërvallës dhe Lëvizjes së Jusuf Gërvallës kanë qenë të pakufishme, të hapura dhe pa asnjë lidhje organizative me Ibrahim Kelmendin, pa asnjë lidhje organizative me Kadri Zekën dhe OMLK-në dhe pa asnjë lidhje organizative me Partinë komuniste të Abdullah Prapashticës.

Vrasjen e Vëllezërve Gërvalla, Lëvizja e Jusuf Gërvallës përjetësisht e ka përballua.

Pikërisht pse ka qenë kështu, Kadri Zeka ka ardhë në Gjermani më 12 janar 1982, vetëm e vetëm për interesa të OMLK-së e të Frontit të OMLK-së pas asnjë konsultim dhe pa asnjë obligim ndaj Jusuf Gërvallës.

Pikërisht pse ka qenë kështu, Jusuf Gërvalla është marrë me veprimtari organizative për Lëvizjen e tij, gazetën e tij, pa i marrë kurrë leje Kadri Zekës dhe pa asnjë obligim ndaj tij dhe pa i dërguar asnjë *ftesë*.

Kadri Zeka, të shtunën në mbrëmje, më 16 janar 1982, ka trokitur në derën e shtëpisë së Jusuf Gërvallës *Habichthöhe 40, Untergruppenbach* si person i paftuar.

12-15. Pse u vra Jusuf Gërvalla?

Jusuf Gërvalla është vra nga UDB-a serbe për shkak të punës së pandërprerë prej momentit kur ka mbërri në Gjermani, për gjithë punën gjatë vitit 1980, e për punën kryesore gjatë vitit 1981. Në mungesë të fakteve, nuk mund ta dimë se në cilën datë mund të jetë marrë vendimi për vrasje, në cilin muaj është përgatitë ekipi vrastar por për këtë është dashur shumë kohë dhe shumë përgatitje. Kjo përgatitje është bërë të paktën me javë të tëra, do të thotë shumë më heret se 12 janari 1982, do të thotë shumë më heret se dita e udhëtimit të Kadri Zekës në Dusseldorf.

Ekzistojnë tri segmente të motivit për vrasje:

-Vrasja është bërë si hakmarrje për gjithë punën që e ka bërë, që e ka kryer Jusuf Gërvalla.

-Vrasja është bërë si masë për ta ndërpre (dhe ky është segmenti kryesor) atë punë e veprimtari, pasi ka qenë e pamundur për UDB-në ta ndërprej me metoda tjera. Në bazë të punës së Jusuf Gërvallës gjatë viteve 1980 e 1981, UDB-ja e ka shumë të qartë se çfarë pune mund të pritet prej tij në të ardhmen. Punën e veprimtarëve brenda territorit të RSFJ, atë që ka mund ta zbuloj e ka ndërpre, në përqindjen më të madhe, me burgje.

-Vrasja është bërë me qëllim të kërcënimit e frikësimit të të tjerëve, për t'u treguar se çfarë mund t'i pret ata që e vazhdojnë atë rrugë.

Vrasjen e Vëllezërve Gërvalla, Lëvizja e Jusuf Gërvallës përjetësisht e ka përballua.

12-16. Pse UDB-ja e ka rrethua shtëpinë së Jusuf Gërvallës

Shtëpia e Jusuf Gërvallës është rrethuar nga UDB-ja serbe për një shkak të vetëm dhe asnjë tjetër, e ai shkak është se në te ka jetuar e ka vepruar, e ka ligjëruar me Zërin e tij Jusuf Gërvalla.

Shtëpia e Jusuf Gërvallës nuk është rrethuar pse aty ka jetuar dhe vepruar Bardhosh Gërvalla.

Shtëpia e Jusuf Gërvallës nuk është rrethuar për shkakun se aty ka qenë mysafir i rastit Kadri Zeka.

Rrethimi i shtëpisë së Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm nga prizmi i luftës serbomadhe kundër ekzistencës së popullit shqiptar.

Rrethimi i shtëpisë së Jusuf Gërvallës, (po të shprehemi me etiketat e OMLK-së), nuk është rezultat i luftës së komunistëve të vërtetë të UDB-së serbe me komunistët e rrejshëm të OMLK-së për hegjemoni, e për çështje ideologjike se a është më i mirë sistemi socialist apo kapitalist.

Nga kjo rrjedhë se:

-Vrasja e Jusuf Gërvallës nuk ka asnjë lidhje të vetme me gënjeshtrat, manipulimet, manovrimet, josinqeritetin, megalomaninë dhe idetë e çoroditura të OMLK-së; me Frontin e OMLK-së, me Tezat për Front të OMLK-së, të Kadri Zekës, Mehmet Hajrizit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës, Hasan Malës e ndonjë tjetri. Me taktikat, me metodat dhe me praktikat e OMLK-së Jusuf Gërvalla është shkëputur përjetësisht më 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt.

12-17. Parazitizmi patriotik

Një skemë e gabuar mendimi:

Akti i atentatit është numerikisht një (1) akt. Pasi akti serbomadh është vetëm një akt edhe Jusufi e Kadriu e kanë bërë vetëm një akt.

Cili është ai akt?

Ata e kanë bërë bashkimin.

Prandaj sa herë të pyet dikush pse u vra Jusuf Gërvalla? përgjigja mund të jipet vetëm në një fjali të thjeshtë: Sepse e ka bërë bashkimin!

Kjo logjikë sa duket e thjeshtë edhe primitive, është kriminale dhe e ndyrë pasi, një jetë e tërë përgatitjeje e veprimi në shërbim të popullit tentohet të thjeshtohet e komprimohet në një fjali, dhe atë të rrejshme. Pra një jetë e tërë përgatitje e veprim për popullin për të cilin e jep jetën, komprimohet në një fjali të thjeshtë, të rrejshme, në një gënjeshtër të "pafajshme", në një gënjeshtër të bardhë, në një gënjeshtër *që nuk e dëmton askend.*

Është e pamundur të mos shtrojmë pyetjen: Të gjithë ata që duan ta thjeshtojnë jetën e të tjerëve në një fjali të rrejshme, si do të ndiheshin parazitët sikur dikush t'ua thjeshtonte jetën e tyre prej paraziti e shushunje në një fjali të vetme, në një gënjeshtër.

12-18. E zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja

Një skemë e gabuar mendimi:

Ngjarja, akti i vrasjes është akt i jashtëzakonshëm.

Çka rrjedh nga kjo?

Se Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka kanë qenë të angazhuar duke bërë një punë të jashtëzakonshme.

Ky është një gabim logjik, një gënjeshtër për vetveten.

Çka ka të jashtëzakonshme me pritë mysafirë në shtëpinë tënde. Gjëja më e zakonshme në botë është me pritë mysafir edhe nëse janë të paftuar.

12-19. Pasivja dhe aktivja

Një skemë e gabuar mendimi:

Akti i atentatit të UDB-së serbe është një akt aktiv. Edhe vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka nuk kanë bërë sehir. Edhe ata i janë kundërpërgjigjur aktit aktiv me aktivitet duke e bërë bashkimin.

Kjo nuk ka bëjë me realitetin, kjo logjikë është e mbështetur vetëm në dëshira.

12-20. Lufta dhe paqja

Akti i UDB-së është një akt lufte i Serbisë kundër popullit shqiptar. Aktit luftarak me plumba të Serbisë, i janë përgjigj me luftë duke e bërë bashkimin. Jeta në paqe në Gjermani do të ishte e barabartë me një jetë në gjumë.

Jusuf e Bardhosh Gërvalla kanë jetuar një jetë në paqe në Gjermani, por jo në gjumë. Vëllezërit Gërvalla nuk kanë bërë asnjëherë ndonjë vepër në kundërshtim me ligjet në Gjermani. Puna politike, veprimtaria politike përmes gazetave, e krijimit të opinioneve në Perëndim çmohet shumë dhe ndihmohet financiarisht nga shteti, pasi konsiderohet si gurthemeli i ekzistencës së shtetit.

Puna e Jusuf Gërvallës sipas ligjeve të Jugosllavisë ka qenë e ndalueshme, por ligjet e Jugosllavisë nuk kanë vlejt në Gjermani. Ky dallim dhe kjo ndeshje në mes sistemeve të

ndryshme, dhe përdorimi i armëve të zjarrit kundër personave të paarmatosur që jetojnë në paqe në shtëpinë e vetë me familjen e vetë e me mysafirët e vet është një akt kriminal i atij karakteri që vazhdimisht do të tërheq vëmendje.

Filma të bazuar në romanin e Leo Tolstoit, Lufta dhe Paqja, dhe vetë romani ku përshkruhen luftërat e Napoleonit në Rusi, lexohen me respekt si në Rusi ashtu edhe në Francë, Gjermani e në gjithë botën, sepse ekziston një ekuilibër, njerëzit veprojnë nga kushte të barabarta e me armë të ngjashme. Ky libër në Francë, i përkthyer në frëngjisht, i lexuar me zë të lartë (audio) nga aktorët më të mirë të Francës është dhjetë herë më i shtrenjtë sesa origjinali në rusisht, i lexuar nga aktorët më të mirë të Rusisë.

Vrasja e personave paqësor, vrasja e Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, në shtëpitë e familjet e tyre ka qenë akt kriminal kundër themeleve të civilizimit Perëndimor, i dënueshëm dhe i cili prishë të gjithë kufijtë në mes luftës e paqes.

Në vazhdim të kësaj, më kujtohet shumë mirë një ngjarje në vitet 1970-të, kur Titoja gjatë një vizite në Britaninë e Madhe ka kërkuar të bëjë presion për ndalimin e revistave e aktiviteteve politike kroate. Britanikët iu kanë përgjigj:

Ne nuk i ndalojmë, përderisa i respektojnë ligjet tona. Kjo është liria dhe burimi i jetës sonë si njerëz të lirë. Këtu në Londër, në pjesën kryesore të veprimtarisë, i ndjekur nga gjithë Evropa ka vepruar Karl Marksi dhe atë nuk e kemi ndaluar. Sikur ta kishim ndjekur këtë logjikën tënde e plotësuar kërkesën tënde me i kufizua liritë e atyre që me forcën e penës krijojnë opinione, sistemi yt politik sot nuk kish ekzistua.

12-21. E organizuara dhe spontania

Një skemë e gabuar mendimi:

Vrasja nga UDB-a serbe është një punë shumë e organizuar e nivelit më të lartë shtetëror. Por as Jusufi e as Kadriu nuk i kanë mbetë borxh UDB-së se edhe ata janë marrë me organizim në nivelin më të lartë.

Sa i përket pjesës së UDB-së fjalët e mësipërme janë të vërteta. Sa i përket pjesës së dytë, Jusufit e Kadriut janë të pavërteta, janë dëshira e zbukurime për me e gënjye vetveten.

Kadri Zeka ka bërë punë të organizuar vetëm e vetëm për OMLK-në dhe Frontin Popullor për Republikën e Kosovës. Për këtë qëllim është nisë nga Zvicra për Dusseldorf më 12 janar 1982, dhe vetëm për punë të OMLK-së e të Frontit ka ardhë në Shtutgart, i paftuar nga Jusuf Gërvalla, dhe pa asnjë koordinim me Jusuf Gërvallën dhe pa i marrë leje Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla, pas 17 tetorit 1981 është marrë me organizim, vetëm e vetëm për Lëvizjen e tij Nacionalçlirimtare, pa i marrë kurrë leje Kadri Zekës e OMLK-së. Edhe tubimin që e ka bërë në Shtutgart me 20 punëtor më aktiv të Shtutgartit, në mbrëmjen e 16 janarit 1982, e ka bërë pa i marrë leje Kadri Zekës. Kjo do të thotë se ka pasur aktivitet të organizuar vetëm **brenda organizatave** por nuk ka pas aktivitet e unitet në mes Lëvizjes së Jusuf Gërvallës dhe OMLK-së së Kadri Zekës. Manifestimi i përbashkët i 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart nuk ka qenë shembull uniteti e bashkimi por pjesë e përgatitjes së një skenari të planifikuar prej OMLK-së për me e vendosë Jusuf Gërvallën dhe Lëvizjen e tij para një akti të kryer, përmes thirrjes: ”Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!”

12-22. Humbja-Hakmarrja-Fitorja

Një skemë e gabuar mendimi:

Akti i atentatit është një fitore për shovinizmin serb. Por edhe Jusufi e Kadriu nuk kanë ndejt duarkryq. Ata e kanë bërë bashkimin në momentin e fundit dhe kështu fitoren e

shovinistëve e kanë shndërruar në humbje, e humbjen në dukje shqiptare e kanë shndërrua në fitore.

Vrasja e 17 janarit 1982 është humbje e madhe për popullin shqiptar. Në ceremoninë e pritjeve për ngushëllime një nga ata që kishin ardhë në Untergruppenbach, me një rast tha: Pushkë të madhe ka qitë Serbia!

Politizimi, aktivizimi e revolta e popullit tonë, pas kësaj ngjarjeje, nëpër të gjitha vendet është një temë tjetër.

Resul Bedo mund të themi se është njeri neutral dhe i paimplikuar në rivalitete politike. Megjithate fjalët për *ftesën* e Jusufit e Bardhoshit, janë fjalë që i ka ndëgjuar prej të tjerëve. Ato shprehin dëshirë naive, dëshirë për hakmarrje ndaj Serbisë por nuk paraqesin realitetin.

Resul Bedo: "*Dy ditët e fundit të jetës së tij Kadri Zeka i kalon në Dyseldorf mes atdhetarëve dhe më 16 janar 1982, pasdite, udhëton për në rrethin e Shtutgartit,* ***ku është i ftuar*** *nga Jusuf e Bardhosh Gërvalla.*" (Pishtarët e lirisë, Editor Begzat Baliu, Shtëpia botuese ERA, Prishtinë, 2002, faqe 19; **Botimin e ndihmuan: Dardan S. Novosella**, Hamzi Rahimi dhe Sibush Haziri)

Sabri Hamiti në dramën *Misioni* mund të thuhet se nuk është neutral si Resul Bedo por ia mban anën më shumë Suzanës e Jusufit se sa të tjerëve. Por shprehja e tij

"Nuk është mirë të ndahemi pa marrëveshje*",*

është e gabuar pasi skema e pikënisja është e gabuar, e cila ka në bazë mëllefin kundër Serbisë, dhe dëshirën për një nivel më të lartë organizimi. Ajo paraqet një dëshirë por jo një realitet.

Sabri Hamiti: "*ISA (Jusuf Gërvalla), paqetësisht.*
Jemi me nerva. Le të kalojmë si njerëz të pjekur mbi këto fjalë e zjarmi. Ne na bashkon diçka më e madhe se jemi vetë. ***Nuk është mirë të ndahemi pa marrëveshje****.*

KEQA (Ibrahim Kelmendi)
S'ka vend për shqetësim, Isë. Ne në fakt u morëm vesh. Ne u njohëm më mirë se kurrë. Është me rëndësi që këtu nuk ka njeri të parë, të dytë, a të tretë. Të gjithë jemi ushtarë të një beteje të madhe, në të cilën ndoshta do të biem. Është e qartë që unë do të bart edhe më tutje flamurin nëpër sheshe, e ti do të shkruash proceset publike e letrare të kauzës sonë, kurse Luli me Lulën e vet e lulët e tjerë do ta hedhin krahërorin përpara në betejat që na presin. Ngrihet në këmbë. Tani po nisem. Kam një punë që nuk pret.

ISA, mëdyshtas.
Nuk prita se do të mbaronte kështu... Kam në vete një zbrazëti.

LULI (Kadri Zeka), ia shtrin dorën Keqës.
Mirupafshim." (Misioni, Rilindja, Prishtinë 1997, faqe 48)

Të gjitha fjalët e përdorura për Resul Bedon e Sabri Hamitin, vlejnë edhe për Avni Klinakun.

Avni Klinaku "*Ranë, pasi e vulosën dokumentin e bashkimit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. LAVDI*!" (facebook, 17 janar 2013)

12-23. Jeta me mision të kryer dhe jeta me mision të pakryer

Një skemë e gabuar mendimi:
-Jeta me mision të kryer ka vlerë
-Jeta me mision të pakryer nuk e ka asnjë vlerë

Do të nevoitej një zgjerim tejmase dhe jashtë kufijve të këtij libri me e definua misionin në jetë dhe me treguar se kur është kryer ai mision dhe kur nuk është kryer. Kjo temë është bosht i gjithë letërsisë botërore dhe aktivitetit njerëzor dhe askush nuk guxon me thënë se ai e ka përgjigjen për këto çështje.

Për mos me u thellua më shumë dhe për me e thjeshtue këtë problematikë tej mase e për të qëndruar në temën e këtij libri, ndeshen thëniet gojore e edhe me shkrim që mund të kuptohen e nënkuptohen se:

-Kadri Zeka më 17 janar 1982 në shtëpinë e Jusuf Gërvallës e ka krye misionin e tij për të cilin paska lindë në këtë jetë,

-Jusuf Gërvalla më 17 janar 1982 në shtëpinë e vetë e ka krye misionin për të cilin ka lindur në këtë jetë, për të cilin e ka edukua Nëna dhe vendi ku është rritur.

Këto skema siç e kam vërtetuar bazohen në gënjeshtra dhe vetëm gënjeshtra, por që e kanë këtë domethënie:

-Misioni dhe ëndrra e Kadri Zekës në këtë jetë paska qenë me e ruajt rolin hegjemon dhe me e dominua Jusuf Gërvallën në shtëpinë tij (Jusufit). Vetëm pse ia ka arritur këtij qëllimi jeta e tij ka vlerë. Në të kundërtën nuk do të kishte asnjë vlerë.

-Misioni dhe ëndrra e Jusuf Gërvallës paska qenë me u dominua nga një person e Organizatë, të cilët Jusufi me gojë dhe me shkrim, qëndrimet e tyre i quan:

-të çoroditura,
-organizatë e udhëhequr prej karrieristësh megalomanë,
-organizatë që bënë lojën e ”politikës së madhe”
-organizatë që bënë lojën e arrivizmit revolucionar,
-njerëz me ndjenja të epërsisë boshe mbi të tjerët,
-njerëz që duan t’i dominojnë të tjerët me çdo kusht
-njerëz të pasinqertë,
-njerëz që nuk e kanë merituar ndihmën e tij,
-njerëz që kanë bërë lojë të pahijshme me personin e tij,
-njerëz që kanë bërë lojë të pahijshme me organizatën e tij,
-njerëz të gënjeshtrave,
-njerëz që me manovrime e gënjeshtra bëjnë përpjekje për ta vënë Lëvizjen e tij para një akti të kryer,
-njerëz të punëve të pavërteta.

Unë nuk e përkufizoj misionin e Kadri Zekës në jetë ashtu siç kanë bërë shokët e tij apo si mund të nënkuptohet nga gënjeshtrat e tyre. Ta marrim se ky paska qenë misioni për të cilin paska lindur. Në atë mision ka dështuar tërësisht e përjetësisht si ai si shokët e tij. Dështimin e tij të plotë e vërtetojnë të gjitha fjalët me shkrim të Jusuf Gërvallës, të cilat tërësisht janë përfshi në këtë punim.

Jusuf Gërvalla kurrë në jetën e tij nuk ka ëndërrua me e dominua ndokend dhe as nuk e ka lejua askend ta dominoj atë. Qëllimin e tij në këtë jetë, misionin e tij në jetë në të cilën ka lindur e e ka edukua Nëna, fatin e tij në këtë jetë kurrë nuk e ka lidhë me Kadri Zekën e me OMLK-në.

-Misioni i Jusuf Gërvallës mund të kuptohet vetëm si i pastruar nga gënjeshtrat, manipulimet, manovrimet, jo sinqeriteti, megalomania dhe idetë e çoroditura të OMLK-së; të Kadri Zekës, Mehmet Hajrizit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës, Hasan Malës e ndonjë tjetri. Me taktikat, me metodat dhe me praktikat e OMLK-së Jusuf Gërvalla është shkëputur përjetëshit më 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt.

Jusuf Gërvalla ka vdekur i padominuar nga Kadri Zeka e OMLK-ja, por kjo nuk do të thotë aspak se ka vdekur me mision të kryer. Jusuf Gërvalla ka pasë horizonte jetësore të pakufishme, dhe Kadri Zeka e OMLK-ja janë vetëm një episod në serinë ditëve të jetës së tij. Jusuf Gërvalla është vra në fillet e fazës më të rëndësishme të jetës së tij.

Është shumë normale që në jetën njerëzore të mbesin gjëra të papërfunduara, të mbesin gjëra të pakryera, edhe për ata që jetojnë 100 vjet. Është ligj themelor i natyrës me iu mbetur njerëzve gjëra të papërfunduara, dhe kjo rrethanë nuk e bënë jetën më pak të vlefshme e më pak interesante.

Do të ishte mirë nëse çdo gjeneratë e kryen obligimin e vetë ndaj gjeneratës pasardhëse, duke zgjedhur sa më shumë probleme e duke lënë sa më pak gjëra të mjegulluara. Përkundër të gjitha përpjekjeve për sqarime, e për lehtësimin e strukturalizimin e jetës njerëzore, ligji i entropisë vepron fuqishëm në natyrë, dhe përkundër dëshirës sonë, ka shumë mundësi që secila gjeneratë pasardhëse të ballafaqohet me një realitet më kompleks, pikërisht si shkak i rritjes së entropisë.

Unë jam mundua që shumë gjëra komplekse t'i sqaroj me dy sharte: *Shartin e parë të turqnisë* dhe *Shartin e parë të shkinisë*. Për gjeneratat e ardhme këto dy sharte janë të pamjaftueshme, pasi ato do të duhen të ballafaqohen edhe me shumë variabla tjera.

Nisja e një rruge që mbeti në fillimet e saj

Ismail Kadare: "*Terrori i përditshëm, sistematik, monoton ishte shumë më i keq se dhuna spektakolare. Ishte dispozita e veçantë e komunizmit. I krahasuar, për shembull, me terrorin fashist, terrori komunist ishte shumë më diskret, i fshehtë, i heshtur dhe i maskuar"*.

Ismail Kadare: "Në mbarim të vitit 1981 në panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt të Gjermanisë Perëndimore, pata rastin të takoj për herë të parë e të fundit shkrimtarin, gazetarin dhe personalitetin e shquar të Kosovës, Jusuf Gërvallën. Erdhi te stenda e librit shqiptar së bashku me të vëllanë një ditë shiu, pa rënë fare në sy, midis dhjetëra vizitorëve. Trupmesatar, gjysmëbiond ai kishte në tërë qenien e tij atë lloj thjeshtësie dhe paraqitjeje të zakonshme, pas të cilës ndihet menjëherë thellësia dhe e pazakonshmja.

Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht.

Pak kohë më vonë, në natën e errët të 17 janarit 1982, ai bashkë me të vëllanë u vranë në Untergrupenbah në afërsi të Shtutgartit të Gjermanisë Perëndimore nga plumbat e armiqve të kombit shqiptar, duke shtuar kështu numrin e martirëve të këtij kombi. **Vrasja e Jusuf Gërvallës ndërpreu, veç të tjerash, një nga krijimtaritë më origjinale e me kolorit të letrave shqipe.**

Romani "Rrotull" që lexuesi ynë e merr në dorë sot, është përpjekja e parë e Jusuf Gërvallës në prozën e gjatë. I shkruar në traditën e rrëfimit popullor dhe duke shfrytëzuar arketipat e letërsisë orale shqiptare, ky roman është **nisja e një rruge që mbeti, në fillimet e saj**." (Pjesë nga parathënia e romanit "Rrotull" të Jusuf Gërvallës, Tiranë 1983)

12-24. Kurtha logjike - Mendimi i shumicës

Mendimi i shumicës për një çështje në një moment të caktuar nuk është garancion për të vërtetën faktike. Me mija vjet shumica e njerëzve kanë menduar se toka është e rrafshtë si tepsi por nuk është ashtu. Kisha, me shumicën në anën e vetë, e ka gjykuar Gjordano Brunon dhe Galilein. Dhe në të dyja rastet kisha, me shumicën në anën e vetë, del fajtore.

Përsëritja e gënjeshtrave me shpresë se mund të shumohen, dhe si të shumuara, të mirren si të vërteta është taktikë hitleriane.

12-25. Kurtha logjike - roli i autoriteteve

Referimi tek autoriteti i shtetit shqiptar nga Abdullah Prapashtica

Abdullah Prapashtica nuk ka marrë mundin me e shkrua historinë e Partisë së tij komuniste dhe me i analizua shkaqet e mos përputhjes së ideologjisë me organizata tjera komuniste, por është mundua që duke u fshehur pas Nuhi Sylejmanit ta shkruaj historinë e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, me librin *Vrasja e trefishtë*. Në atë libër Abdullah Prapashtica thotë se:

-Lëvizja e Jusuf Gërvallës emrin e saj e ka marrë nga Shqipëria,

-Lëvizja e Jusuf Gërvallës emrin e gazetës së saj e ka marrë nga Shqipëria.

Nga kjo nxirren dy përfundime:

-Në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës nuk ka asgjë origjinale dhe

-Lëshimet që i kemi bërë për këtë Lëvizje janë bërë për hir origjinës nga Shqipëria dhe jo për hir të mulla Hamitit dhe mulla Izet Tashollit.

Analizën e plotë për librin *Vrasja e trefishtë* e kamë bërë në librin *Lëvizja e Jusuf Gërvallës* dhe nuk e kam ndërmend të zgjatem më shumë këtu.

Referimi tek autoriteti i shtetit shqiptar nga Emrush Xhemaili

Emrush Xhemaili, në shkrimin e tij të vitit 2002 për historinë Lëvizjes – LPK shkruan se:

> "17 shkurt 1982 në Turqi, përfaqësues të dy grupimeve patriotike të fshehta, Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica (të arratisur politik nga Kosova), në prezencë edhe të ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, z. Bujar Hoxha shpallin të formuar Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ)."

Citati i mësipërm i Emrushit përmban dy të pavërteta:

-Bujar Hoxha nuk kanë qenë i pranishëm dhe

-Bujar Hoxha nuk ka qenë ambasador i Shqipërisë në Turqi.

Nga referimi tek autoriteti i shtetit shqiptar, Emrushi don me thënë se ai dhe shokët e tij i referohen 17 shkurtit 1982 vetëm për hir të shtetit shqiptar dhe jo për shkak të Sabri Novosellës e Abdullah Prapashticës.

Referimi tek Autoriteti i Institutit të turqnisë të Prof. Dr. Abdyl Kadollit

Instituti i turqnisë i Prof. Dr. Abdyl Kadollit përdoret për shumë aktivitete e simpoziume të ndryshme shkencore me kusht që veprat të jenë të bazuara vetëm në *Shartin e parë të turqnisë* dhe jo në *Shartin e parë të shkinisë.* Ideja është që Instituti i Prof. Dr. Abdyl Kadollit garanton se do të respektohet ky princip.

Referimi tek autoriteti i binomit Mojsiu-Golemi dhe Beratit

Më 17 janar 2017 është mbajt një Simpozium shkencor, në Institutin e Prof. Dr. Abdyl Kadollit, kushtuar Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, 17 janarit 1982, ku kanë marrë pjesë autoritete të ndryshme nga tokat shqiptare.

Në mes tyre kanë qenë, Berat Luzha, Alfred Mojsiu dhe Shpëtim Golemi. Alfred Mojsiu dhe Shpëtim Golemi në popull janë të njohur më tepër si binomi Mojsiu-Golemi. Prania e binomit Mojsiu-Golemi dhe Beratit është një nder i madh për Institutin e turqnisë dhe për Shartin e parë të turqnisë.

Tentativa e fshehjes pas autoriteteve, me qëllim të plasimit dhe mbulimit të gënjeshtrave, në logjikë konsiderohet krejtësisht e pavlerë.

12-26. Motivi i *dashurisë*

Një djallëzi e thellë për gënjeshtrat e zhurmën rreth bashkimit është edhe motivi i "dashurisë".

Skema e këtij mendimi duket në këtë formë:

Ai që e don Jusufin, Bardhoshin e Kadriun thotë se bashkimi është bërë më 17 janar,

Ai që e don Sabriun e Abdullahun thotë se bashkimi është bërë më 17 shkurt.

Urdhëroni, i keni vetëm dy mundësi me zgjedhë:

A meriton me u dashtë më shumë Jusuf Gërvalla apo Sabri Novosella?

A meriton me u dashtë më shumë Jusuf Gërvalla apo Abdullah Prapashtica?

Krejt punës së pastër e të vërtetë të Jusuf Gërvallës do t'i hynte kanceri i gënjeshtrës, sikur të pranohej me ra në këto djallëzi, dhe vepra e tij do të shembej.

Amicus Plato, sed magis amica veritas.

12-27. Motivi i higjienës gjenetike

Skema e motivit të higjienës gjenetike:

Është shumë me rëndësi që Gjeneza e bashkimit të jetë pikërisht në ditën e Gjenazeve.

Kodi racial e politik i Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit është më i mirë se kodi politik i Sabri Novosellës e Abdullah Prapashticës. Në këtë kodin e pastër racial të Kadri Zekës e Ibrahim Kelmendit, bëhet djallëzia të përzihet edhe kodi politik i Jusuf Gërvallës.

Ideja e racës së veçantë politike, e racës së zgjedhur politike, nuk është e re. Ajo ka ekzistua në vitin 1981 e 1982.

Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës dhe Kadri Zeka kanë mbajtur qëndrime të fëshehura raciste - deri në mesin e tetorit 1981, dhe qëndrime të hapura raciste - pas tetorit 1981 e gjer në vdekje, kundër Jusuf Gërvallës, të shprehura me qëndrimin se:

> -Askush tjetër nuk mund të jetë komunist jashtë Organizatës së tyre e vendimeve të tyre. Kadri Zeka e ka bërë këtë me qëllim të **DOMINIMIT ME ÇDO KUSHT mbi Jusuf Gërvallën,** me shpresën se secila rrugë të drejton në OMLK e në Partinë Komuniste që do të formohej nga OMLK.

Ideja raciste e higjienës gjenetike është përdorur dhe ka qenë gjallë prej 1985 deri në shembjen e murit të Berlinit.

Të gjithë ata që luftojnë për të treguar se e kanë prejardhjen nga kodi i pastër racial i Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit kanë të drejtë ta bëjnë, por në atë rast ata mund të flasin vetëm për OMLK-në, Frontin e OMLK-së dhe Frontin e Kuq.

Kodi politik i Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe i Untergruppenbachut ka qenë i papërzieshëm dhe i paintegrueshëm me racën politike të OMLK-së, të Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit më 1981 e 1982.

Kodi politik i Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe i Untergruppenbachut është i papërzieshëm dhe i paintegrueshëm me racën politike të OMLK-së, të Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit në ditët e sotme.

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë*." (Bota Sot, 14 shtator 2009)

Kovosaprees: "*Në punimet e sotme të Konventës së VI-të të PDK-së është diskutuar edhe rreth profilit të partisë, me ç'rast delegatët janë përcaktuar për profilizimin si parti e qendrës së djathtë*." (PDK profilizohet si parti e qendrës së djathtë, wwww.kosovapress.com, 27 janar 2013)

12-28. SHPIRTI I VETËMOHIMIT I MEGALOMANËVE

Bashkimi duhet të kontrollohet në bazë të fakteve dhe nuk është çështje e përcaktimeve. Pamvarësisht numrit të atyre që përsërisin gënjeshtra, gënjeshtra mbetet gënjeshtër.

Jusuf Gërvalla ka merita të veta personale për të bërë histori dhe nuk ka nevojë t'ia vjedhë meritat Sabri Novosellës e Abdullah Prapashticës. Vetëm e vetëm për meritat e tij UDB-a i ka zënë pritë në derën e shtëpisë së tij.

Nëse Kadri Zeka, si komunist ka nevojë me bërë histori me meritat e një komunisti me të cilin nuk i për-puthet ideologjia, ajo është çështje që duhet të shqyrtohet vetëm brenda komunistëve dhe nuk më takon të përzihem, pasi e di se komunistët i karakterizon shpirti i VETËMOHIMIT. Virtyti më i madh i komunistëve të paepur është VETMOHIMI.

Jusuf Gërvalla nuk ka nevojë me ua vjedhë meritat të tjerëve, me bërë histori me merita të vjedhura. Jusuf Gërvalla nuk ka nevojë për dhurata të vjedhura, për dhurata nga persona modelet e rrejshme ideore të të cilëve kanë falimentuar. Nëse të tjerët kanë nevojë për dhurata e për merita të vjedhura është problem vetëm për ta dhe hajnitë e tyre historike nuk mund të përzihen e integrohen me të vërtetën e Jusuf Gërvallës.

12-29. Fjala e fundit është për idiotët që nuk kanë thënë mjaft

Skema e dëshirës për ta thënë fjalën e fundit.

Në shtete të ndryshme ku ekziston dënimi me vdekje, në burgje të ndryshme, të burgosurit njoftohen me kohë, paraprakisht, për datën dhe orën e ekzekutimit. Shumë të dënuar mbajnë shënime në çastet e fundit. Më vonë këto fletore mblidhen nga drejtoria e burgjeve, dhe fjalët e shumë të burgosurve që duken më interesante mblidhen në përmbledhje e botohen si kuriozitete. Një analogji e tillë nuk mund të bëhet këtu, pasi vrasësit e UDB-së nuk i kanë pyet Jusufin, Bardhoshin e Kadriun se cila është dëshira e tyre e fundit dhe se pa e thënë dëshirën e fjalën e fundit nuk do ta kryejnë vrasjen.

Përveç të dënuarve me vdekje, edhe të sëmurët, nga sëmundjet e ndryshme apo nga gjendja natyrale e moshës së shkuar, që e kanë vdekjen afër, shpesh pyeten se cila do të ishte porosia e tyre e fundit, fjala e fundit. Për këtë lloj fenomeni e mençurie, kur është pyetur në formë të ngjashme,

Karl Marx është përgjegj: "Fjala e fundit është për idiotët që nuk kanë thënë mjaft."

12-30. Kurtha e stilit – *ose je me mua ose je kundër meje*

Një taktikë për ta vendosur veten në qendër është që të tjerët të kesh fuqi t'i vendosësh në udhëkryqe, të kesh fuqi dhe t'i detyrosh të zgjedhin vetëm dy rrugë: të jenë me ty ose kundër teje. Fraza: *Ai që nuk është me mua është kundër meje*, - është e vjetër që është përdorur para mija vjetësh, e prej miliona njerëzish, por sado që triku të duket interesant, shkenca e logjikës e konsideron të pavlerë. Thelbi i kësaj taktike qëndron pas zhurmës së atyre që i luftojnë *komplotet*, dhe që i quajnë *komplote* të gjitha punët nga të cilat të tjerët i kanë përjashtuar dhe nuk ua kanë treguar as emrin e vetë të vërtetë, duke i konsideruar si persona të pabesë gjer në fund.

13. Gjuha e vërtetë e varreve dhe gënjeshtrat e kufomave të gjalla

Më ka rënë të lexoj shkrime të Lëvizjes Kaçake Kosovës duke thënë se bashkimin që e kanë bërë Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka është shembull për gjeneratat e tjera. Sipas kaçakëve të cilët i kuptojnë gjërat në tërë kompleksitetin e vetë, Jusufi e Kadriu tregojnë se si duhet bërë "bashkimi".

Si e tregojnë ata rrugën e këtij "bashkimi"?

Vetëm kur ta shohin vdekjen, si të vdekur janë dakord me u bashkua, ndërsa për së gjalli kurrë. Kjo logjikë mund t'i përshtatet Kadri Zekës dhe shokëve të tij, luftës së tyre për **DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT,** por kurrë Jusuf Gërvallës, që ka luftuar për **barazi** me të tjerët. Sipas kësaj Kadri Zeka dhe Jusufi paskan qenë për bashkim vetëm kur e shohin fundin, janë për bashkim kufomash. Kjo logjikë mund t'i përshtatet komunistëve hegjemon. Jusuf Gërvalla ka dhënë shembuj me vite se ka qenë për bashkim të njerëzve të gjallë dhe jo për bashkim kufomash.

Më 17 Janar 1982 nuk është bërë bashkimi i programeve e as i kufomave, siç kanë gënjyer kufomat e gjalla. Kadri Zeka nga riorganizuesit e OMLK-së është varros, sipas **PROGRAMIT të OMLK**-së, si komunist i paepur. Jusuf Gërvalla është varros në krahun e Badhoshit, sipas **PROGRAMIT të Lëvizjes Nacionalçlirimtare** - si Yll i pashuar i qiellit shqiptar.

Gënjeshtrat mbesin gënjeshtra. Jusuf Gërvalla nuk ka bërë kurrfarë bashkimi për së gjalli, prej ditës që ka dalë në Gjermani deri në shtratin e vdekjes në spital kur e ka dhënë deklaratën e fundit.

Në mënyrë të njerëzishme e me naivitet të papërmirësueshëm, ne rrethi i Jusuf Gërvallës, kemi menduar se vdekja e përbashkët, pa harrime e falsifikime, megjithate deri në një masë, do të duhej t'i lej divergjencat nën hije. Në këtë mënyrë familjet e Vëllezërve Gërvalla dhe shokët e tyre i kanë pritë nga pozita të barabarta të gjithë ata që kanë ardhur pas vrasjes për ngushëllime dhe u kanë treguar respektin më të madh. Pothuajse të gjithë kanë ardhur si të barabartë dhe pa qëllime për me e marrë kalanë nga brenda, me ndonjë përjashtim. Është vërtetuar nga shkrimet e OMLK-së dhe Ibrahim Kelmendit, se Saime Isufi paska ardhë në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla, jo si e barabartë, por së bashku me Ibrahim Kelmendin të kontrollojnë se kujt i ka mbetur zotshpillaku, kush e ka uzurpuar zotshpillakun dhe prej kujt e ka bërë atë uzurpim.

Jeta e njerëzve të gjallë është e ndryshme. Vdekja e njerëzve është e ndryshme. Njerëzit lindin si origjinal, jetojnë si origjinal dhe vdesin si origjinal. Kujtimi i tyre pas vdekjes është i ndryshëm, është origjinal, pasi kujtimi i tyre bazohet në veprën e tyre origjinale.

Vdekja e tyre e përbashkët nuk ka pasur asnjë ndikim tek shokët e Kadri Zekës, në etjen e tyre për dominim me çdo kusht prej vdekjes e deri sot. Qëndrimet e tyre gjenden në libra që

nuk mund të ndryshohen. Në natyrën e raporteve shoqërore ndodhin vetëm procese të pakthyeshme.

Për ta ruajtur pavarësinë e tij, dinjitetin, dijen e tij, nga çdo lloj dominimi e manipulimi, në varrezat e Shtutgartit, më 5 shkurt1982 Jusuf Gërvalla, nga familja e tij, është varrosë, si yll shqiptar, në krahun e Bardhosh Gërvallës dhe jo të Kadri Zekës.

Tek gënjeshtrat dhe fushatat e shpifjeve kundër Jusuf Gërvallës për së gjalli, e mosbashkimit për së gjalli, luftës për **DOMINIM ME ÇDO KUSHT kundër tij, me ndjenjën e epërsisë boshe,** qëndron baza e mosbashkimit të eshtrave, e varrimit të Jusufit e Bardhoshit nga familjet e tyre në fshatin e tyre të lindjes, më 2002.

14. Tërmeti i Berlinit dhe Kështjella e Jusuf Gërvallës
(OMLK-ja e Pararojave-Pllakave dhe Plakave)

OMLK-ja e Pararojave

Mehmet Hajrizi: *"**Në natën** e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e **tri organizatave** çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)



Xhafer Shatri: *"Teoritë me pararojë janë përralla ideologjike."* (pashtriku.org, 14 prill 2024)

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë.*" (Bota Sot, 14 shtator 2009)

Fjalë të Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit

"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Rrëzimi i murit të Berlinit ishte një gabim fatal që i kushtoi shumë shtrenjtë veprimtarisë kaçake, veçmas organizatave *komuniste* që vepronin në atë kohë!

Tërmeti i Berlinit e la të paprekur Kështjellën e Jusuf Gërvallës.

OMLK-ja e Pllakave

Mehmet Hajrizi: *"**Në natën** e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e **tri organizatave** çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)

Fjalë të Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit

"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Rrëzimi i murit të Berlinit ishte një gabim fatal që i kushtoi shumë shtrenjtë veprimtarisë kaçake, veçmas organizatave *komuniste* që vepronin në atë kohë!

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë*." (Bota Sot, 14 shtator 2009)

Tërmeti i Berlinit e la të paprekur Kështjellën e Jusuf Gërvallës.

Qamile Zhitia-Nëna e Heroit të Kombit Afrim Zhitia

OMLK-ja e Plakave

Ismet Sylejmani: *"Nëna Qamile e Udhëheqësit të LPK-së, Sekretarit Organizativ të Komitetit Drejtues të OMLK-së, Heroit të Kombit Afrim Zhitia, sot më 5 Janar 2023, i mbushë 81 vite!"* (Epoka e re, 5 janar 2023)

Afrim Zhitia është vra më 2 nëntor 1989. Tërmeti i Berlinit ka ndodhë më 9 nëntor 1989. Kjo do të thotë se **Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës**, **OMLK**, (e pushuar së vepruari më 17 janar 1982) është riorganizuar, dhe ka ekzistuar të paktën deri një javë para rrëzimit të murit të Berlinit.

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë*." (Bota Sot, 14 shtator 2009)

15. Çështje të brendshme të Ibrahim Kelmendit dhe Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK)

15-1.Portreti i babait
15-2.Portreti i birit
15-2-1. Ti nuk e ke asnjë anëtar
15-2-2. Besimi dhe mosbesimi për të pabesin
-Të pabesit gjer në fund i besoi qysh në takimin e parë
-Për të pabesin gjer në fund tregoi mosbesim të pafund
15-3.Portreti i Frontit
15-4.Portreti i shokut
15-5. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xh.D.)
15-6. Portreti i gruas
15-7. Portreti i vjehrrës
15-8. Portreti i vëllaut me krejt çka ka
15-9. I nderuari, i përshëndeturi dhe i respektuari Xhafer Durmishi-Skenderi
15-10.Trishtimi i avokatit
15-11.Trishtimi i UDB-ës për fatin e Frontit të Kuq

15-1.Portreti i babait

Ibrahim Kelmendi: *"Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*
– Isha fare i panjohur,– tha ai kur i kërkuan të fliste.– Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe

do t'ia kisha lënë fajin UDB-së...
Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga inati." (Atentatet, f.350)

Saime Isufi*:* "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë*." *(*Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

Avni Dehari: "*I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB-së, ndër të tjera thoshte: 'Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë (mveshë-shën im) fajin UDB-së.'*

Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen..." (www.pashtriku.org, Gazeta Focus, 2 mars 2007)

15-2. Portreti i birit

15-2-1. Ti nuk e ke asnjë anëtar
15-2-2. Besimi dhe mosbesimi për të pabesin
-Të pabesit gjer në fund i besoi qysh në takimin e parë
-Për të pabesin gjer në fund tregoi mosbesim të pafund

I. Kelmendi*:* "*Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende* ***nuk ke anëtarësuar njeri*** *vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni." (Atentatet, f.293)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

Kadri Zeka

Adem Gashi (redaktor i romanit *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit): *"Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë* ***mistreci komunist****, pranë urtisë popullore sloganet e zvjerdhura të*

moralit të shpëlarë, pranë dijes së orakullit fodullëku i të parit të mëhallës." (Më 5 shkurt 2007, Hotel Viktoria)

Adem Gashi me fokusimin tek termi komunist i ofendon komunistët kudoqofshin ata. Idetë kanë forcë më të madhe se çdo bombë, janë ekplozive dhe godasin më së shumti atë që i keqpërdor.

I. Kelmendi***: "OMLK-ja kishte përcaktim komunist. Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës (****Atentatet, f. 330)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

15-2-2. Besimi dhe mosbesimi për të pabesin

-Të pabesit gjer në fund i besoi qysh në takimin e parë

Xhafer Shatri: "*Me Ilazin (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) mendoj se duhet ta lëmë kështu njëherë të mos i bëjmë zë fare, por ai njeri nuk guxon më kurrë të jetë aty ku e kemi zgjedhur, ai është njeri i papërgjegjësi dhe gjer në fund i pabesë."* (Letër Xhafer Durmishit, Faridin Tafallarit, Hasan Malës, si anëtar të Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

Ibrahim Kelmendi: *"– Kam ardhur të enjtën. – filloi Mirani. – Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë kaq dramatike e alarmante. Ai më tha se duhet të bisedojmë me shokët e Lirisë, që të koordinohen aktivitetet në të gjitha shtetet ku gjendet emigracioni ynë.Erdha t'ju kontaktoj dhe të bisedojmë se cili është mendimi juaj?*
– Unë t'u prezantova në prani të Benediktit me emrin Zeqë, por unë në të vërtetë e kam emrin e mbiemrin Kadri Zeka. Jam nga Gjilani, i strehuar politik këtu në Zvicër. Je ndër pak veta që po ta tregoj emrin e vërtetë, por të lutem mos më dekonspiro!" (Atentatet, Prishtinë, 2007, faqe 238-239)

-Për të pabesin gjer në fund tregoi mosbesim të pafund

Xhafer Shatri: "*Me Ilazin (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) mendoj se duhet ta lëmë kështu njëherë të mos i bëjmë zë fare, por ai njeri nuk guxon më kurrë të jetë aty ku e kemi zgjedhur, ai është njeri i papërgjegjësi dhe gjer në fund i pabesë."* (Letër Xhafer Durmishit, Faridin Tafallarit, Hasan Malës, si anëtar të Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

Ibrahim Kelmendi: "*Pastaj i dhashë të drejtë vetes të informoja Jusufin për bisedat që kishim pasur dy ditët e fundit me bashkatdhetarë në Duzeldorf e rrethina, - se ju ka folur kryesisht shoku Zeqë - (meqë emrin e vërtetë, Kadri, nuk ia dija), se çdo bashkatdhetar po pret të ndodhë bashkimi konkret, madje po kushtëzojnë angazhimin e tyre me bashkim, përndryshe do të pasivizohen, se u kishim premtuar që bashkimi do të ndodhte shumë shpejt, etj."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, faqe 58-59)

15-3.Portreti i Frontit

Hasan Mala***:*** *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që*

*botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej **'Liria'**. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e **Frontit**, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 256-257)

Ibrahim Kelmendi: ”*Fronti ishte më shumë, do të thosha, frymë sesa organizatë me strukturë të centralizuar, të përpiktë e klandestine, siç ishte praktikë e kohës.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 27)

Mehmet Hajrizi-Gani Sylaj: “*Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës”* (Titull libri, Prishtinë 2014)

Ibrahim Kelmendi: ”*Emërtimi bazë i organizatës së re qe vendosur të ishte LËVIZJA, edhe për shkak se emërtimin FRONT e kishim konsumuar ne të Frontit të Kuq Popullor.*” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 183-184)

Jusuf Gërvalla*: ”Sa për organizatën e bashkuar rreth organit ”Bashkimi”, më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e “Bashkimit” në Kosovë. **Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë),** njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të “Bashkimit”(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.” (*Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

15-4.Portreti i shokut

Saime Isufi: ”*Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.*” (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

Hasan Mala: ”*Kur është kthye Kadriu prej mbledhjes (në Stamboll - shën i Xh. D.) që kanë pas, unë kam qenë në panairin e librit në Frankfurt. Ishte edhe Ismail Kadareja, ishte edhe Isufi aty. Pak a shumë u njifshim me Isufin, por jo sa duhet. Kisha një respekt ndaj tij, ishte njeri i afërt. Vjen Kadriu aq i lodhur e aq i mërzitur sa nuk mundet me u marrë me mend, dhe më kapi për krahu e u ulëm rreth një tavoline.*

- Çka u bë puna si kaluat atje?

- Kurrqysh hiq nuk kemi kalue!

- Si?

- Nuk kemi mund të bëjmë asgjë, por frikohem se është prishë puna edhe më shumë.

- Po Bardhi si mendon?

- Bardhi nuk mendon keq, Bardhi, por megjithatë, kur ishte ndikimi i tij (Sabri Novosellës - shën im), para tij nuk e thoshte ndoshta edhe atë çka e mendonte, se Sabriu

kishte më kompetencë. Por Isufi më la përshtypje të mirë, - se i ka folë Isufit aty.

Isufi i ka thënë se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Isufi e ka pritë me rezervë, domethënë pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë." (Marrë nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1997)

Ibrahim Kelmendi: ”*Informim interesant nga Hasani fatkeq! Gjithë kohën edhe Hydajeti, edhe Kadriu e shfrytëzonin atë kryesisht si shofer. Nuk i jepnin mundësi të bëhej anëtar i OMLK-së, sepse kishin një stazh që duhej absolvuar, që do të thotë, duhej të dëshmohet si “kandidat” se është komunist i devotshëm. Ndërsa pas vrasjeve të kobshme edhe atij i erdhën tre ditë që të bluajë, si Nuhi Sulejmanit, Suzana Gërvallës, Xhafer Durmishit. Pra ai tashmë po përfaqësonte OMLK-në dhe ishte ai, Hasan mjeran, që ia dha “autorizimin” Xhafer Shatrit që t’ia bashkëngjis OMLK-në “bashkimit” të sajuar më 17 shkurt 1982, nga SN, Abdullah Prapashtica & Co*.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 151-152)

Saime Isufi: ”*Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.”* (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

S.Isufi: “KA QENE, ËSHTË DHE MBETET”



Saime Isufi: ”***Hasan Mala***, *siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh,* ***ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër*** *dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.”*

Ibrahim Kelmendi: *”Hasan Mala. Edhe ai do të faktorizohet, meqë edhe atij, (ish-traktoristit dhe gjysmanalfabetit), i rastisi të gjendej emigrant në Zvicër. Atje Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e ndonjë tjetër e kishin afruar që të kishin tek ai bazë strehuese dhe mundësi të transportit me makinë. Për këtë gatishmëri e angazhim udhëheqësit e OMLK-së e kishin shpërblyer me dhënie të statusit të “kandidatit” të OMLK-së. Ai dhe, në këtë rast, edhe vëllai i Kadri Zekës, rrëfejnë, por duke mos u mbështetur në dëshmitarin e Bashkimit (që kishte rastisur të isha unë), siç u ka treguar, por “filozofojnë”, sikur janë dëshmitarë.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 302)

Ibrahim Kelmendi: ”*Shefkatja dhe Nexhmiu patën dhuruar 50.000 korona suedeze (rreth 8 mijë Euro) për veprimtari dhe secilit nga ne treve nga 10.000 Korona ndihmë ”private”. Ato 50.000 SEK i kanë bërë bauk, meqë Hasani ka rrëfyer në Këshill të Përgjithshëm (pasrendësja e Qendrës Ekzekutive) të LR(S)SHJ në vitin 1985, se nuk i kam dorëzuar. Tashmë Hasani ishte infektuar nga renegati Nuhi Sylejmani, prandaj i ishte mbushur mendja se është trashëgimtar politik dhe organizativ i Kadri Zekës, si Nuhiu i Jusuf Gërvallës. Fatkeqësisht e respektoja më shumë se e meritonte, prandaj edhe më kishte keqkuptuar se i isha subordinuar që të më sundonte, siç e kishte pas fatkeqësinë Saimja dhe ca ish- ”kandidatë” të Kadriut.*

Deri më 16 maj 1982 nuk dinim gjë për komplotet që po i bënin Sabri Novosella, Abdullah Prapashtica e Xhafer Shatri. Ky i fundit qe imponuar si përfaqësues i OMLK-së (inekzistente), duke u thirr në autorizimin që ia kishte dhënë ”traktoristi” Hasan, siç ishte afirmuar në Kosovë duke shitë zall në pazar të Gjilanit me traktorin e tij. Pra, kujt duhej t’ia dorëzoja ato 50 mij SEK, që na i ishin dhuruar për veprimtari? Me cilat mjete financuam demonstratën e 3 prillit 1982 dhe të 24 prillit 1982 në Vjenë dhe veprimtaritë tjera, deri edhe shkuarjen time në USA në qershor deri në dhjetor 1982 dhe angazhimet atje? Matufi Hasan me tifozët e tij nuk ishin mbet ”as për peng as për dorëzan”. Bile nga ato mjete është dashtë të paguhet edhe dhoma e konviktit në Bohum, të cilën ma pati lënë një koleg turk, sepse Saime Isufi pati shpreh interesim të vazhdonte studimet në Bohum, meqë Gjermania ishte më liberale për studentë të huaj. Mendoja se Saimja sapo të regjistrohet në Bohum të kishte dhomën e saj. Bile, kur u kthyem nga Suedia ndaluam në Bohum për ta vizituar Universitetin dhe Bibliotekën e Albanologjisë. (...)

Fatkeqësisht Hasani i qe bërë padron Saimes duke ia privuar lirinë të vetëvendoste.” (*Zjarr dhe acar*, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe f.66-67)

15-5.Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xhafer Durmishit)

Osman Osmani

*"**<u>Në këtë pozitë inferiore</u>** nga ana e „zëvendësit“ (Xhafer Durmishit-shën. im), ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Nga aktakuza e mësipërme rrjedh se sikur Ibrahim Kelmendi ta kishte poseduar superioritetin e Abdullah Prapashticës, superioritetin e Osman Osmanit e superioritetin e Nuhi Sylejmanit, ishin plotësuar kushtet për largimin e *zëvendësit* dhe *uzurpatorit* nga *Froni*.

***

15-6.Portreti i gruas

Ibrahim Kelmendi: *"Mirani mori frymë thellë për të pritur reagimin. Kishte frikë mos po e humbiste durimin, pasi ishte bindur se shtabi i UDB-së që kishte urdhëruar atentatet, tani kishte dhënë urdhër që të provokohej Mirani për të bërë ndonjë hata ndaj provokuesve.*

– Jo vetëm ti, por as ajo kurva, që ju po i thoni Bule, nuk jeni të dëshiruar të qëndroni më këtu, – foli Xhafari.

Të gjithë të pranishmit hapen sytë në drejtim të Xhafarit, pos Nuriut që vazhdonte të mbante kokën ulur, pothuajse midis këmbëve. Sikur pjesëmarrësit nuk po u zënin besë veshëve çfarë dëgjuan.

– Përse është kurvë bashkëshortja e nderuar e Kadriut? – ia drejtoi Mirani Xhafarit, duke ruajtur qetësinë e jashtme, të cilën përbrenda pothuajse e kishte humbur. Sa s'po eksplodonte.

– Ajo kurvë e dërguar nga UDB-ja i ka qitur shokët në pritë, – u përgjigj Xhafari, që po ngjante me shumë në një kërmë se sa në njeri.

– Pa na e zbërthe edhe këtë komplot, se si i keni sajuar detajet!?

– Nuk jam këtu para UDB-së që të përgjigjem në pyetjet e tua, – tha Xhafari.

– Mor kriminel i dërguar, do të sqarosh apo do të ta dredh qafën si të gjelit!? – e kërcënoi Mirani, i cili po shtrëngohej për t'ia mbërthyer fytin. Tashmë Mirani kishte fituar siguri se pos ndërhyrjes për t'i ndarë nuk do t'i hidheshin të tjerët.



Saime Isufi

– Dihet, – nisi të përgjigjet Xhafari, që kishte humbur davanë, – Kadriu ka lënë orarin kur do t'i telefonojë kurvës së tij. Ajo ka informuar vrasësit për orar dhe pastaj vrasësit kanë zënë pritë." (Atentatet, f. 363-364)

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

Trishtimi i avokatit

Ibrahim Kelmendi: ”*Po më vështirësohet formulimi i komentimeve, sepse **secilën herë po trishtohem më shumë** për shpërdorimin që ua ka bërë dhe po ua bën Sabri Novosella Jusufit, Xhaferit, Shefqetit, Metushit, etj.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 157)

Pse trishtohet avokati?

Sensi i drejtësisë e bënë avokatin të **trishtohet** sa herë ta humbë dikush davanë.

Post hoc ergo propter hoc

Post hoc ergo propter hoc (nga latinishtja "Pas kësaj, domethënë për shkak të kësaj") paraqet një gabim logjik, një konkluzion të gabuar, një kurthë logjike, kur një ngjarje e parë pasohet nga ngjarja e dytë supozohet se ngjarja 2 ndodh vetëm e vetëm si shkak i ngjarjes 1.

Shembull: -Ngjarja 1.UDB-a e ka rrethuar shtëpinë e Jusuf Gërvallës.

-Ngjarja 2.Kadri Zeka don me i telefonua Saime Isufit.

Përfundimi: Kadri Zeka don me i telefonua Saime Isufit për shkakun se shtëpia e Jusuf Gërvallës është e rrethuar nga UDB-a. Sikur shtëpia e Jusuf Gërvallës të mos kishte qenë e rrethuar nga UDB-a, Kadri Zeka nuk kish pasur asnjë arsye për me i telefonua Saime Isufit.

I mbështetur në këtë kurthë logjike Ibrahim Kelmendi, artistikisht, ashtu si ka dëshirë, e portretizon Saime Isufin dhe nderin e karakterin e saj, dhe njëkohësisht mundohet ta luaj rolin e avokatit ashtu siç është munduar ta luaj rolin e avokatit të trishtuar për mua Xhafer Durmishin-Skenderin.

U këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia

Suzana Gërvalla: ”*Kur policia gjermane merrte punëtorët në pyetje, Ibrahimi porosit njërin prej tyre që para policisë gjermane të thotë se "Ibrahim Kelmendi, atë natë kur u vra Jusufi, ka qenë tek shtëpia ime." Dyshimi tjetër është se pas vrasjes së Jusufit, Ibrahimi ndejti disa ditë në shtëpinë tonë, ku dhe ishin shumë kosovar të tjerë. Gjestet e tij në familjen tonë nuk kanë qenë të mira, ai deshti të marrë në duar frenat e familjes tonë, kështu që u këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia."* (Deklaratë në policinë e Tiranës, 5 prill 1982; Jusuf Gërvalla në dosjet e Sigurimit; ABC Story; youtube, 3 prill 2023, , min 30-32)

15-6. Portreti i vjehrrës ″Njoftim

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ

"Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën ynë) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer (Shatri-shën ynë) në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë

I. Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë pesëdhjetë mijë korona suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)

luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë."

"Kështuqë KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.
10 shkurt 1985 Zvicër
KQ i LRSSHJ" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

Dëshmitare kur Ibrahim Kelmendit i janë dhënë 50 mijë korona suedeze nga Nexhmi e Shefkate Sherolli është Saime Isufi. Anëtare e Komitetit Qendror të LRSSHJ në Zvicër, i cili më 10 shkurt 1985 e përjashton Ibrahim Kelmendin për hajni është Saime Isufi.

Ibrahim Kelmendi*: Afishuar me: 23.03.2007 21:18 "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje."* (www.kosova.de)

Nga citati i mësipërm Ibrahim Kelmendi jo vetëm që tregon se kush është Saime Isufi por tregon se kush është edhe nëna Saime Isufit.

15-8.Portreti i vëllaut me krejt çka ka

Dehari: "*I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB-së, ndër të tjera thoshte: 'Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë (mveshë-shën im) fajin UDB-së.'*

